Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (85). MAJ 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

VËZHGIM

Dikur ushqente Stambollin, sot as veten

Nga **REXHEP TORTE** - FAQE 8

VEPRIMTARI

Nderi i Kombit për Elez Isufin

'Hasan Leka', emri i ri i shkollës

FAQE 9,11

SPORT

Merita & Bashkim Lala: Një jetë me volejbollin

Nga **HASAN LLESHI** - FAQE 17

KUJTESË

Myslim Koka, miku i të gjithëve

Nga **SHAQIR SKARRA** - FAQE 23

Fillon fushata, partitë premtojnë Rrugën

Dy partitë kryesore politike dhe aleatët e tyre premtojnë përfundimin e Rrugës në katër vitet e ardhshme. Iniciuesi i peticionit i shkruan Presidentit të Republikës, Kryetares së Kuvendit, si dhe kryetarëve të partive parlamentare: Dëshmoni publikisht mbështetjen për Rrugën e Arbërit.



SPECIALE NË FAQET 2 - 8

Tuneli në Qafën e Tujanit. Foto: © Bujar Karoshi

EDITORIAL

Peticioni, partitë, publiku

Nga **BUJAR KAROSHI**

Peticioni për Rrugën e Arbërit ka mbi dy muaj që është bërë publik. Deri më tani ka marrë një numër të konsiderueshëm nënshkrimesh. Megjithatë, krahas përkrahjes mediatike dhe popullore që ka marrë, tek-tuk shfaqen edhe dyshime mbi qëllimin final të peticionit dhe arsyet se pse ai nisi para zgjedhjeve.

Por çfarë është ky peticion? Çfarë qëllimesh ka? Është apo jo politik? Kush fshihet pas tij? Pse tani u hartua dhe jo pas zgjedhjeve? A do të ketë rezultat apo jo? Dhe pyetje të tilla, herë dyshuese e herë informuese, kanë mbushur forumet sociale dhe atmosferën paraelektorale, sa mendoj se duan një përgjigje serioze, sa vetë serioziteti i peticionit.

PAK HISTORI

Viti 2013 janë zgjedhjet e treta për deputetë në parlament, ku kandidatët "korrin" votat e tyre me premtimin për Rrugën e Arbërit, duke marrë parasysh edhe faktin se katër ditë para zgjedhjeve të 3 korrikut 2005, ish kryeministri Fatos Nano kishte prerë shirin e fillimit të punimeve në vendin e quajtur Gurët e Skëndërbeut.

Tenderi i parë për fillimin e punimeve në tre lotet e para të Rrugës së Arbërit është zhvilluar në Tetor 2007 dhe në fund të këtij viti kanë filluar punimet në Gotvi, pjesë e segmentit Bulqizë – Ura e Çerenecit.

(Vijon në faqen 2)

INTERVISTË

Erisa Saraçi: Zëri i vajzave dhe grave për kauzën e Rrugës së Arbërit

FAQE 7

OPINIONE

Rruga është e nevojshme dhe e domosdoshme.Jo vetëm për dibranët, por për të gjithë Shqipërinë.

FAQE 5-6

NJOFTIM

Mbi modalitetet e nënshkrimit të peticionit online për Rrugën e Arbërit

Shumë qytetarë në Shqipëri dhe në vende të tjera kanë komunikuar me redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit" dhe hartuesin e peticionit për të konfirmuar se e kanë nënshkruar atë si dhe për tu interesuar nëse nënshkrimet e tyre janë regjistruar.

Pavarësisht ftesave të ripërsëritura për ta firmosur peticionin, njoftojmë se vetëm nënshkrimet që përmbushin kriteret e rrepta të transparencës të përcaktuara që kur filloi peticioni, do të përfshihen në dokumentin zyrtar që do t'i dorëzohet qeverisë pas 23 qershorit.

Ju rikujtojmë se kush e ka nënshkruar peticionin online, nuk duhet ta firmosë për së dyti, si dhe nuk ka të drejtë ta nënshkruajë atë në letër.

Lista e plotë e nënshkrimeve dhe komentet e bëra online do të jenë dokumente publike.

Dëshirojmë të theksojmë përsëri se peticioni nuk përfundon më 23 qershor; ky peticion do të mbyllet vetëm kur të inaugurohet rruga Tiranë-Dibër.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj!

cyan magenta yellow black 1

Peticioni kërkon të lidhë njëherë e mirë një marrëdhënie të ndërsjellë publik – të zgjedhur, duke dëshmuar një standard të ri të komunikimit në një shtet demokratik. Në këtë mënyrë do t'i detyrojmë kandidatët që të ruajnë edhe një lidhje direkte me votuesit e tyre, një komunikim ky i domosdoshëm, i cili është këputur me sistemin e ri elektoral.

editorial

Peticioni, partitë, publiku

Partitë politike të premtojnë çfarë të duan, por politika e vetme e peticioni është Rruga dhe vetëm Rruga!



(Vijon nga faqja 1)

Prej asaj kohe, më optimistët parashikonin përfundimin e rrugës në trasenë e plotë brenda katër viteve. Kryeministri Berisha gjatë fushatës së vitit 2009 premtonte përfundimin e saj në vitin 2011, ndërsa në planin strategjik të rrugëve të qeverisë shqiptare, shkruhej se përfundimi i saj do të ishte në vitin 2013.

Por, ndërsa jemi në mes të vitit 2013, janë akoma 34 km rrugë pa u tenderuar dhe, ndërkohë, segmentet që duhet të kishin përfunduar, ose janë në mes të punimeve, ose ndërtimi ka përfunduar pa standarde.

Në këto kushte, nevoja për një sensibilizim të ri të shoqërisë civile, për domosdoshmërinë e përfundimit të punimeve në Rrugën e Arbërit, është më se aktuale, për të mos thënë që ka ikur koha më kohë.

PETICIONI

Peticioni vjen pas gati dy dekadave përpjekje të shoqërisë civile për sensibilizim për përfundimin e rrugës. Pavarësisht zgjedhjeve në prag, hartuesi i peticionit online, Dr. Gëzim Alpion, ka bërë të qartë qysh në fillim se peticioni do t'i drejtohet qeverisë që do të dalë nga zgjedhjet e 23 qershorit dhe se "qëllimi i peticionit është që t'ia bëjë të qartë qeverisë së re... se Dibra do ta kërkojë me ngulm përfundimin e Rrugës së Arbërit." Madje, ai shkon më tej, kur thekson se "peticioni nuk do të mbyllet në qershor; qershori do të jetë, në fakt, koha kur ky peticion do të fillojë në kuptimin e vërtetë të fjalës". Peticioni do të vazhdojë, sipas tij, derisa të inaugurohet rruga Peshkopi-Tiranë. "Në këtë drejtim nuk do të ketë kompromis. Ky është edhe mendimi i dhjetëra e qindra dibranëve që unë njoh personalisht apo që nuk i kam takuar ndonjëherë, të cilët më shkruajnë çdo ditë për të ndarë mendimet e tyre me mua", - thekson ai.

Dr. Alpion e bën të qartë se "Peticioni nuk ka natyrë politike. Peticioni nuk do të përdoret nga asnjë forcë politike. Se si do të votojnë dibranët në qershor, ajo është mes tyre dhe ndërgjegjes së tyre".

LEXIMI POLITIK

Me gjithë natyrën apolitike të peticionit, dua të theksoj se nuk mund të ndalohet leximi politik i saj. Partitë politike, ashtu si deri më tani, do ta sulmojnë, do ta mbështesin apo do të tregojnë indiferentin ndaj peticionit, sipas interesave të tyre elektorale. Por kjo nuk është çështja e atyre që e kanë hartuar dhe e mbështesin peticionin. Peticioni është një kërkesë e popullit, që nuk ka filluar sot, as me këtë peticion, por ka mbi 20 vjet që thuhet vazhdimisht. Janë organizuar takime, konferenca shkencore, janë organizuar festa, janë prerë shirita inaugurimesh, por rezultatet tregojnë se deri më tani është bërë pak, shumë më pak se sa ishte premtuar dhe shumë e shumë më pak se e kemi merituar.

Partitë politike të premtojnë çfarë të duan, por politika e vetme e peticionit është Rruga dhe vetëm Rruga!

KOORDINIMI

Unë, si një mbështetës i peticionit, nuk kam iluzione që ai do të ketë efekt direkt te vendimmarrësit në Shqipëri, por besoj se dalëngadalë do të gjejmë mënyrat dhe mundësitë ta arrijmë këtë. Dhe njëra nga përpjekjet në këtë drejtim, është koordinimi me deputetët e nesërm të Dibrës dhe jo vetëm, të të gjitha partive politike, që, duke filluar që sot, të hartojmë një program të përbashkët, t'i vendosim vetes qëllime të përbashkëta dhe ta afrojmë ditën e përfundimit të rrugës.

Dibranët janë të zhgënjyer nga vendimmarrja e deritanishme për sa i përket Rrugës së Arbërit, prandaj duhet të kërkojmë një koordinim të ri, në mënyrë që të mos ndodhë kjo që ndodh tani. Është koha që ne të mos biem në "kurthin" paraelektoral me peticionin, por t'ia bëjmë të qartë çdo partie që kërkon vota në Dibër e Mat, pse jo edhe në Tiranë e kudo ku kandidojnë deputetë që e duan vendin, me emrin e Rrugës së Arbërit t'i bëjnë mirë llogaritë.

Ne duhet ta printojmë formularin e peticionit dhe, kur kandidatët për deputetë ta premtojnë rrugën, t'u kërkojmë atyre ta firmosin publikisht atë. Dhe një gjë të tillë ta bëjnë jo vetëm për rrugën, por për çdo problem që shqetëson rajonin. Janë tri fushata të kaluara që kandidatët për deputetë kanë premtuar rrugën, por gjithmonë ata janë rikthyer atje po me premtimet për rrugën, pa pasur asnjëherë dëshirën për të shpjeguar se pse ata nuk e kanë mbajtur premtimin.

Peticioni kërkon të lidhë njëherë e mirë një marrëdhënie të ndërsjellë publik – të zgjedhur, duke dëshmuar një standard të ri të komunikimit në një shtet demokratik. Në këtë mënyrë do t'i detyrojmë kandidatët që të ruajnë edhe një lidhje direkte me votuesit e tyre, një komunikim ky i domosdoshëm, i cili është këputur me sistemin e ri elektoral.

Ka disa prej atyre që thonë se ne nuk mund t'i bëjmë presion qeverisë në këtë drejtim, pasi qeveria ka mijëra halle e probleme që presin zgjidhje prej saj. Por ne nuk i zgjedhim qeveritarët dhe deputetët t'u qajmë hallin atyre, por ata të zgjidhin problemet tona. Dhe problemi ynë i shpejtë është Rruga dhe vetëm Rruga.

QËLLIMI

Një koordinim i mirë dhe mirëkuptim i ndërsjellë duhet të shoqërohet edhe më premtime afatshkurtra. Një prej të cilave është përqendrimi i punimeve në rrugë në dalje të Tiranës drejt Dibrës, si dhe fillimin e punimeve nga Ura e Çerenecit, në drejtim të Dibrës së Madhe. Ne do t'i kërkojmë qeverisë shqiptarë që të hyjë në negociata sa më parë me qeverinë maqedonase për të gjetur modalitete bashkëpunimi, që rruga të mos përfundojë në Bllatë, por të vazhdojë dhe të lidhet me autostradën Gostivar-Tetovë. Këto përpjekje që po bëhen në Shqipëri nga shoqëria civile duhet të shqetësojë edhe shoqërinë civile në Maqedoni. Në qoftë se Shqipëria dhe Maqedonia do të shfaqin shenja bashkëpunimi në këtë proces, atëherë dy shtetet kanë mundësi të gjejnë edhe mbështetje nga fondet e Bashkimit Europian, si nevojë e përmirësimit të infrastrukturës në Ballkan.

Gjithashtu, njëri nga qëllimet e peticionit është kërkesa për një përmirësim të standardeve të rrugës. Nuk duhet ta shohim rrugën si një lidhje të Tiranës me Dibrën, qoftë edhe me atë Dibrën e Madhe, por si një arterie e rëndësishme e infrastrukturës së Shqipërisë në Europë.

VOTIMI

Më 23 qershor janë votimet parlamentare. Partitë politike i kanë shprehur qëndrimet e tyre mbi rrugën dhe problemet e tjera të Dibrës. Peticioni nuk u bën thirrje qytetarëve të votojnë për "x" apo "y" parti, por kërkon t'i bashkojë njerëzit në një synim të përbashkët: Rrugën.

Nuk po kërkojmë një gjë të pamundur. Nuk po kërkojmë "trille inxhinierike". Nuk po kërkojmë të mbyllim një rrugë e të hapim të Arbërit. Po kërkojmë një gjë që ka 16 vjet që na e kanë premtuar; as më pak e as më shumë, por një rrugë.

Unë nuk jam prej atyre që besoj se me ndërtimin e Rrugës të gjitha problemet e Dibrës do të zgjidhen menjëherë. Por besoj se Rruga do t'i kthejë njerëzit pranë vendlindjeve të tyre, do të investojnë atje, do të punojnë atje, do të jetojnë atje.

Te ky peticion qëndron energjia dhe dëshirat e popullit. E njerëzve të thjeshtë, bujqve, blegtorëve, minatorëve, studentëve. Është zëri dhe dëshira e prindërve tanë që po ngrysin vitet me ëndrrat e rrugës, por edhe dëshira e fëmijëve, që rriten me ëndrrat për një rrugë.

Ndaj është koha që secili ta dëshmojë tani vullnetin e tij. Ta firmosë peticionin publikisht, duke dëshmuar vullnetin e popullit në breza. Mos humb kohë! Vepro tani!

NDIQ HAPAT E MËPOSHTËME PËR TË FIRMOSUR SAKTË:

1 - KLIKO NË FAQEN E WEB SI MË POSHTË:

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

2- Lart, djathtas shfaqen kuadratet bosh.
Shkruaj Emrin, Mbiemrin, Adresën e emailit dhe Qytetin tuaj.
Pastaj klikon "**Sign**". Pas kësaj, ju do të merrni një mesazh falënderimi dhe konfirmimi që emri juaj u regjistrua.


Për të gjithë miqtë tuaj që nuk kanë mundësi hyrje në web, sharko formularin dhe plotësoje me dorë.
Për hollësi mund të vizitoni faqen e gazetës
në Web: <**www.rrugaearberit.com**>
ose në Facebook <**facebook.com/gezim.alpion**>
ose <**facebook.com/rruga.arberit**>

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 5 (85). 1 - 31 Maj 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë, Haki Pernezha, Abdurahim Ashiku, Mustafa Tola, Islam Çenga, Dali Tërshalla, se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Gëzim ALPION
Mirela SULA
Erisa SARAÇI
Rexhep TORTE
Abdurahim ASHIKU
Nuri ABDIU
Shefqet HOXHA
Beqir SHEHU
Afrim KAROSHI
Ilmi DERVISHI
Viktor GJIKOLA
Hasan LLESHI
Bardhyl MARKU
Selman MZIU
Destan RAMA
Rruzhdi BITRI
Mevlud BUCI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

aktualitet

Iniciatori i peticionit për Rrugën e Arbërit, akademiku dibran Dr. Gëzim Alpion, takime në Tiranë për koordinimin e punëve në lobimin për Rrugën e Arbërit



Tuneli në Qafën e Tujanit. Foto: © Bujar Karoshi

Rrugën ta ndërtojmë fillimisht në mendjen tonë. Dibrën do ta zgjojnë dibranët.

Dibra kuvendon

Në fillim të majit, iniciatori i peticionit për Rrugën e Arbërit, akademiku dibran Dr. Gëzim Alpion, ishte për një vizitë në Shqipëri i ftuar në konferencën ndërkombëtare për nacionalizmin, organizuar në Tiranë nga Instituti Kanadez i Teknologjisë në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Studimeve Angleze.

Gjatë qëndrimit në Shqipëri, Dr. Alpion pati mundësinë të shikojë vetë edhe një herë nga afër se në çfarë faze janë punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Ndërsa në Peshkopi ai zhvilloi një intervistë të shkurtër me korrespondentët e Dibrës të medieve si Top Channel, Ora News TV, Vizioni+ dhe Klan TV. Në këtë intervistë Dr.Alpion rithekso i se peticioni online nuk ka nota politike.

Gjatë ditëve të qëndrimit në Tiranë, Dr.Alpion shfrytëzoi kohën për tu takuar me disa përfaqësues të shoqatave kulturore dibrane në Tiranë, si dhe me personalitete te kulturës, politikës dhe mediave.

Në takimin që Dr Alpion pati me disa përfaqësues të kryesisë së Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, me kryetar Prof. Dr. Nuri Abdiu, u diskutua mbi gjetjen e mënyrave të bashkëpunimit për ta finalizuar peticionin me rezultat për Rrugën e Arbërit.

Prof. Abdiu, e njohu Dr Alpion me veprimtarinë e shoqatës LID në përgjithësi, dhe veçmas për problemin e Rrugës së Arbërit. "Ne kemi organizuar në maj 2007, tha Prof Abdiu, bashkë me disa shoqata të tjera dibrane një Kuvend Tekniko-Shkencor për Rrugën, ku janë marrë në analizë shkencore gjithë problematika, që nga projektet dhe variantet shoqëruese, deri te efektet e saj në gjithë fushat e ekonomisë, që nga ajo minerare, bujqësore, energjetike dhe turistike". "Megjithatë, - shtoi Prof Abdiu, - ne jemi treguar të gatshëm dhe do vazhdojmë të jemi, për të lobuar edhe në të ardhmen, në mënyrë që Rruga e Arbërit të përfundojë sa më shpejt".

Mendime në këtë takim për një punë efikase dhe për modalitetet e rritjes së përkrahjes, dhanë edhe zotërinjtë Musa Riçku, nënkryetar i shoqatës LID, Demir Osmani, anëtar i kryesisë, diplomati i mirënjohur ambasadori Sulejman Tomçini, dhe pedagogu i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Iliria, z. Hysen Uka.

Në Tiranë Dr.Alpion u takua edhe me Kryetarin e Bashkësisë Dibrane, Dr. Faruk Borova. Ambasador Borova e njohu Dr Alpion mbi veprimtarinë e shoqatës së tij dhe konkretisht për komitetin e krijuar vitin e kaluar për sensibilizimin e opinionit për ndërtimin e Rrugës së Arbërit.

Edhe në takimet e tjera në Tiranë me disa personalitete të kulturës, politikës dhe medieve, ai shfrytëzoi momentin për të diskutuar mbi problematikën që është shfaqur mbi përfundimin e Rrugës së Arbërit si dhe nevojën për një lobim sa më të gjerë.

Në Tiranë, Alpion pati edhe takime me një bisedë të hapur me shkrimtarin dhe poetin e mirënjohur Agron Tufa si dhe redaktorin e gazetës 'Rruga e Arbërit' Bujar Karoshi. Biseda e tyre u përqendrua kryesisht në çështjen e Rrugës së Arbërit dhe u rrahën mendime se si mund të kishin efekt veprimet e shoqërisë civile pas zgjedhjeve lidhur me peticionin.

Po nga Tirana, Dr.Alpion u shkroi një Letër te Hapur Presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani, Kryetares së Parlamentit znj. Jozefina Topalli, si dhe kryetarëve të partive politike që kanë përfaqësim në Parlament, z. Sali Berisha, Kryetar i Partisë Demokratike, z. Edi Rama, Kryetar i Partisë Socialiste, z. Ilir Meta, Kryetar i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Z. Shpëtim Idrizi, Kryetar i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, z.. Bamir Topi Kryetar i Partisë Fryma e Re Demokratike, dhe z. Fatmir Mediu, Kryetar i Partisë Republikane.

Në Letrën e Hapur, ndër të tjera, ai thekson se e nisi peticionin online me 18 Mars 2013 "i shqetësuar për prapambetjen e krahinës së Dibrës, prapambetje që ka si burim edhe rrugën aktuale torturuese Tiranë – Dibër".

Nëpërmjet këtij peticioni, që mund të nënshkruhet edhe në formular, përgatitur në përputhje me ligjet e shtetit shqiptar, për ata që nuk kanë mundësi ta bëjnë këtë gjë online, do t'i kërkohet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që do të dalë nga zgjedhjet e qershorit 2013, përfundimi i Rrugës së Arbërit sa më shpejt dhe me cilësi, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.

Pasi përmend në Letër një gjeografi të mediave dhe njerëzve që e kanë përkrahur peticionin, Dr Alpion i garanton drejtuesit e shtetit dhe politikës në Shqipëri për natyrën jopartiak të peticionit

"Unë nuk jam njeri 'politik', por si intelektual nuk jam 'apolitik'", shkruan Dr.Alpion në Letër. "Përkundrazi, unë mendoj se intelektualët duhet të bashkëpunojnë në mënyrë transparente dhe konstruktive me qeveri që rezultojnë nga zgjedhje demokratike apo forca politike, që, për qëllim parësor, kanë mbrojtjen e interesave të vendit dhe zhvillimin e tij."

Më pas, duke shprehur bindjen se çdo drejtues i lartë i shtetit dhe çdo kryetar partie e përkrah ndërtimin e Rrugës së Arbërit, Dr.Alpion shpreson se "ashtu si nënshkruesit e shumtë shqiptarë dhe të huaj nga të katër anët e globit", edhe ata do ta dëshmojnë këtë përkrahje publikisht, duke e firmosur personalisht peticionin.

Peticioni për Rrugën e Arbërit ka marrë deri më tani mbi 2500 firma. Disa deputete dhe kandidatë për deputetë nga forca të ndryshme politike - PD, PS, FRD etj., - e kanë nënshkruar peticionin dhe janë angazhuar në të ardhmen për lobimin në këtë proces.

Pyetjes se a ka pasur reagime nga drejtues të partive politike mbi letrën e hapur, Dr.Alpion i tha gazetës se "ka marrë mesazhe personale nga përfaqësues të partive të ndryshme për të konfirmuar marrjen e Letrës së Hapur dhe për ta siguruar atë se ajo do të trajtohet.

Por, siç kemi theksuar edhe më parë, tha ai, ne nuk do ti bëjmë publike mesazhet para zgjedhjeve, por menjëherë pas votimeve në Shqipëri, nëpërmjet gazetës tuaj, ne do do t'i njoftojmë lexuesit për reagimet.

Pavarësisht nga peticioni, partitë politike e kanë kthyer çështjen e ndërtimit të Rrugës së Arbërit në një çështje të rëndësishme të fushatës elektorale në qarkun e Dibrës.

Korresp. "Rruga e Arbërit"

Prof. Abdiu e njohu Dr.Alpion me veprimtarinë e shoqatës LID në përgjithësi, dhe veçmas për problemin e Rrugës së Arbërit. "Ne kemi organizuar në maj 2007, tha Prof Abdiu, bashkë me disa shoqata të tjera dibrane, një Kuvend Tekniko-Shkencor për Rrugën, ku janë marrë në analizë shkencore gjithë problematika, që nga projektet dhe variantet shoqëruese, deri te efektet e saj në gjithë fushat e ekonomisë, që nga ajo minerare, bujqësore, energjetike dhe turistike".



Një takim me disa përfaqësues të Shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë.
Nga e djathta në të majtë: Sulejman Tomçini, Musa Riçku, Demir Osmani, Gëzim Alpion, Nuri Abdiu, Flutura Osmani dhe Hysen Uka. © Foto: Bujar Karoshi

Rruga e Arbërit nr. 85
letra



Dëshmoni publikisht mbështetjen për Rrugën e Arbërit

Z. BUJAR NISHANI
Presidenti i Republikës së Shqipërisë

I nderur Z. Nishani,

Mua më quajnë Gëzim Alpion. Po ju shkruaj si një dibran i thjeshtë, për të kërkuar ndihmën tuaj për sa vijon.

I shqetësuar për prapambetjen e krahinës së Dibrës, prapambetje që ka si burim edhe rrugën aktuale torturuese Tiranë - Dibër, më 18 Mars 2013 nisa një peticion online. Peticioni mund të nënshkruhet edhe në formular, përgatitur në përputhje me ligjet e shtetit shqiptar, për ata që nuk kanë mundësi ta bëjnë këtë gjë online.

Nëpërmjet këtij peticionit do t'i kërkohet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që do të dalë nga zgjedhjet e qershorit 2013, përfundimi i Rrugës së Arbërit sa më shpejt dhe me cilësi, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.

Deri tani peticioni online është nënshkruar nga mbi 2000 vetë dhe është përkrahur apo përcjellë gjerësisht nga mediat në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe Diasporë: Angli, SHBA, Kanada, Zvicër, Itali, Greqi dhe Rumani. Më shumë informacion në lidhje me peticionin dhe përkrahjen e tij deri tani, mund të gjeni në fund të kësaj letre.

Unë nuk jam njeri 'politik', por si intelektual nuk jam 'apolitik'. Përkundrazi, unë mendoj se intelektualët duhet të bashkëpunojnë në mënyrë transparente dhe konstruktive me qeveri që rezultojnë nga zgjedhje demokratike apo forca politike, që, për qëllim parësor, kanë mbrojtjen e interesave të vendit dhe zhvillimin e tij.

Shpreh bindjen se Ju gjithmonë e keni përkrahur ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Megjithatë, nëpërmjet kësaj letre të hapur do t'ju lutesha që, ashtu si nënshkruesit e shumtë shqiptarë dhe të huaj nga të katër anët e globit, edhe Ju ta dëshmoni këtë përkrahje publikisht, duke e firmosur personalisht peticionin.

Po kështu, jam i bindur se Ju e kuptoni domosdoshmërinë e përfundimit të këtij projekti jo vetëm në kuadrin e rolit pozitiv që do të ketë për Dibrën dhe dibranët, por edhe për kontributin e madh që Rruga e Arbërit, kjo nyje e rëndësishme infrastrukturore në Ballkan, do të luajë për të sjellë shqiptarët më pranë jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me popujt dhe vendet fqinje. Rruga e Arbërit është një investim i pallogaritshëm për integrimin e mëtejshëm të Shqipërisë dhe Ballkanit në Evropë.

Peticioni nuk ka karakter politik dhe Ju siguroj se nuk do të përdoret nga asnjë institucion shtetëror apo forcë politike para dhe pas zgjedhjeve të qershorit.

Unë do t'ju jem mirënjohës për çdo përkrahje që mund t'i jepni peticionit, i cili do të mbyllet vetëm kur të inaugurohet rruga Tiranë - Dibër.

Me shpresë se do të më mirëkuptoni dhe do ta përkrahni peticionin,

Miqësisht,
Gëzim Alpion (Dr)
Birmingham, Angli
gezim.alpion@hotmail.co.uk

SHËNIM

Iniciuesi i peticionit për Rrugën e Arbërit i shkruan Presidentit të Republikës z. Bujar Nishani.
E njëjta letër u është dërguar edhe Kryetares së Kuvendit znj. Jozefina Topalli, si dhe kryetarëve të partive parlamentare, z. Sali Berisha, z. Edi Rama, z. Ilir Meta, z. Shpëtim Idrizi, z. Fatmir Mediu dhe z. Bamir Topi.

Kjo letër do t'u përcillet edhe mediave në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Diasporë.

MEDIAT QË KANË PËRKRAHUR DHE PËRCJELLË PETICIONIN:

GAZETA

Gazeta Ditore, Kosovë
Dielli, Sh.B.A.
Shekulli, Tiranë
Panorama, Tiranë
Gazeta Shqiptare, Tiranë
77 News, Tiranë
Nacional Albania,
Gazeta "Rrënjët", Romë
Gazeta Ekonomia, Tiranë
Gazeta "Epoka e Re", Prishtinë
Gazeta e Athinës, Greqi

REVISTA

Albanian Women, Londër
Java, Tiranë

GAZETA ONLINE:
www.fjalaelire.com
www.voal-online.ch
www.thealbanian.co.uk
www.revistajava.al
www.hermesnews.org
www.balkanweb.com
www.lajme.shqiperia.com
www.sq.kurir.mk
www.gazetatribuna.com
www.fjala.info
revistahaemus.blogspot.co.uk
www. tribunashqiptare.net

Si dhe SBS Radio – Melbourne, Australia; Radio Kosova dhe shume rrjete sociale të individëve dhe kontributorëve të ndryshëm, mes te cilave faqja ne Facebook <Peshkopi, Diber, Albania>, <Ma ktheni Peshkopinë time>.

FORMULARI I PETICIONIT NË LETËR

Peticion drejtuar Qeverisë Shqiptare pas zgjedhjeve të 2013-ës
NDËRTONI SA MË SHPEJT DHE ME STANDARDE RRUGËN E ARBËRIT

Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Petitioning The Albanian Government after 2013 general elections
COMPLETE THE CONSTRUCTION OF THE ARBËRI ROAD

Dibra is one of the most underdeveloped regions in Albania. The Arbëri Road will connect Dibra with the rest of the country giving a much needed boost to the local economy. The road will also become a new vital route between Tirana and Macedonia thus improving considerably the infrastructure in this part of the Balkans.

Nr.	Emri	Mbiemri	Qyteti	Shteti	Adresa e Emailit / Tel.	Firma

Petition by
GËZIM ALPION
Birmingham, United Kingdom
www.change.org

Shënim: Ata që e kanë firmosur peticionin ONLINE ne change.org, NUK DUHET ta nenshkruajnë atë në letër!

Pas plotësimit, peticionin mund ta postoni me postë në adresën:
Gazeta "Rruga e Arbërit", Rr. "Zenel Baboci", Pall. "Ferar", Tirana- Albania.
Ata që banojnë në Tiranë mund ta sjellin dorazi në redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit", çdo ditë nga e hëna deri të shtunën nga ora 9:00 deri 14:00
Për komente ose pyetje shkruani në email: **<gezim.alpion@hotmail.co.uk>** ose **<rrugaearberit@gmail.com>**
Për hollësi mund të konsultoheni me faqen e internetit **www.rrugaearberit.com**
Tel: **069** 20 68 603 / **067** 30 73 265 / **068** 65 08 441

Kjo pjesë plotësohet nga stafi i peticonit:

Nr. Prot. _____ Data e mbërritjes së formularit. _____. Nr. i faqes pas protokollimit _____ Fillon me nr. rendor ____ Mbaron me Nr. rendor. ____

Formulari zyrtar që po firmoset lidhur me peticionin për Rrugën e Arbërit.
Formularin mund ta merrni nga faqja e internetit e gazetës www.rrugaearberit.com ose pranë redaksisë së gazetës. Pasi ta plotësoni, qoftë edhe me një firmë të vetme, mund ta nisni në adresën e gazetës.

opinione

"I lidh trojet shqiptare në të dy anët" **Akademik Ali Aliu**, Prishtinë

Rruga është e nevojshme dhe e domosdoshme. Jo vetëm për dibranët, por për të gjithë Shqipërinë.

Arminda Gjika ANJOU(QC), CANADA: Për një të ardhme sa më të mirë për Shqipërinë tonë!

Gentjan Spahiu, OXFORD, UNITED KINGDOM: Rrugët janë zhvillim kudo, qoftë edhe në Shqipëri. Rruga e Arbwrit për mua ka rëndësi se vij nga ajo zonë.

Gramoz Keshi, TIRANA, ALBANIA: Më afron më afër me vendlindjen time

Rudina Bebej, TIRANA, ALBANIA: Sepse jam dibrane dhe atje kam mall të shkoj se rruga është skandaloze...

Artid Alla, DISTRETTO DI TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbërit është arteria kryesore që lidh Shqipërinë me një trevë po aq të rëndësishme shqiptare jashtë trojeve tona siç është Shkupi, e cila është një qendër po aq e rëndësishme sa dhe Prishtina. Mendoj se qeveria dhe vendi i detyrohet shume Dibrës të cilës vetëm i ka marrë gjithçka, si dijen, kulturën, bukurinë, pasurinë dhe në këmbim nuk i ka dhënë asgjë, dhe këtë rrugë të kërkuar prej kohësh nuk është veçse një kthim të rrugës që heroi jonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu kishte më shumë vizion se gjithë drejtuesit e këtij vendi që me siguri e përshkonte rrugën nga Dibra për në Krujë për të njëjtën kohë sa ç'e bëjnë dhe politikanet tanë sot edhe pse ai udhëtonte me kalë dhe jo me makina super luksoze. Ju pershendes për iniciativën.

Ilir Alimehmeti, TIRANA, ALBANIA: Rrugë = Zhvillim

Ornela Çerpja, TIRANA, ALBANIA: Për turizmin

Ledia Maleçka, PESHKOPI, ALBANIA: Për ta bërë Dibrën një qytet të rëndësishëm.

Shpëtim Gorenca, DEBAR, MACEDONIA: Sepse është pjesë e jetës tonë

Esmerina Doku, TIRANA, ALBANIA: Ndërtimi i rrugës së Arbërit është i rëndësishëm për zhvillimin e zonës së Dibrës

Stela Manushi, TIRANA, ALBANIA: Rruga Arbërit, rreze drite për dibranët.

Rudina Licaj, SARANDË, ALBANIA: Për të lidhur Shqipërinë me Maqedoninë dhe Dibrën me krahinat e tjera shqiptare sepse dihet ku ka rrugë ka zhvillim

Ejona Kılıç, ANKARA, TURKEY: Kjo nuk është e rëndësishme vetëm për krahinën e Dibrës por edhe më gjerë. Është një pikë lidhëse dhe strategjike për Maqedoninë dhe krahinat përreth. Nuk mund të them se është pika e vetme lidhëse po është më e shkurtra dhe do të ketë një rritje ekonomie dhe në pjesën verilindore të vendit. U jep akses dhe kësaj zonë duke patur prodhime bujqësore karakteristike dhe cilësore. Nuk është përfitimi veç i zonës së verilindjes por dhe e popullatës që do të kenë mundësi konsumi të këtyre prodhimeve. Uroj dhe shpresoj që kërkesa jonë do të realizohet.

Arber Totraku, TIRANA, ALBANIA: Kam nevojë të shkoj më shpejt dhe me më siguri në vendin tim, të gjithë kanë nevojë për të njëjtën gjë...

Marc Fischer, GERMANY: E gjithë bota, duhet të përpiqet për cilësi më të mirë gjithandej.

Mariglen Pjetri, BULQIZË, ALBANIA: Është shumë e domosdoshme për rrethin e Dibrës sepse shkurton udhëtimin që lidhet me kryeqytetin tonë

Bajram Mustafi, ITALY: Sepse e përdor këtë rrugë kur shkoj në Maqedoni.

Behar Kadrija, KUKËS, ALBANIA: Të bëhet se është turp që nuk është bërë gjer tani pasi është një rrugë shumë e rëndësishme për këtë zonë.

Mjaft qytetarë që kanë firmosur peticionin për rrugën e Arbërit, kanë nënshkruar edhe mendimet e tyre se pse ndërtimi i saj është i rëndësishëm për ta. Opinionet janë të hapura në faqen e web "change.org" dhe shumë prej tyre janë në gjuhën angleze. Opinionet do të bëhen publike numër pas numri, duke mbledhur kështu argumentet që do të botohen në një botim të posaçëm, që do t'i bashkëngjitet peticionit.

Redaksia nuk boton opinionet e shprehura në faqen e FB të gazetës apo rrjetet e tjera sociale, përveç rasteve kur ato përcillen me email për botim në adresën e gazetës.

Redaksia do të mirëpresë në vazhdim edhe opinione e studime specialistësh, me argumente të tjera "pro" ndërtimit të rrugës dhe avantazhet që ajo sjell për ekonominë kombëtare.

Letër nga Shkupi për Gëzim Alpion

Përshëndetje z.Gëzim,

Ku mund të gjejmë më shumë informata rreth peticionit dhe mënyrës se si duhet nënshkruar? Babai ynë i ndjerë, Shehat Marku, gjykatës në Dibrën e Madhe, Rrugën e Arbërit e kishte njërën nga ëndrrat e veta të mëdha dhe e shihte si një ndër vegimet e bashkimit kombëtar duke e promovuar ndërtimin e saj përmes shoqatës Votra dibrane që e udhëhiqte (aktive në Dibër dhe Tiranë), në bashkëpunim të ngushtë me projektuesin Faruk Kaba. E kemi pikësëpari për respekt të kujtimit te tij, motra Adelina, vëllau Parimi dhe unë, të lindur dhe rritur në Dibër dhe me vendbanim në Shkup, që të nënshkruajmë të njëjtën.

Ne nuk ju njohim personalisht, por cv-ja juaj tregon gjithçka dhe nuk ngurrojmë t'i bashkangjitemi iniciativës fisnike tuaj, edhe pse jemi të tre, ashtu si edhe shumica e shqiptarëve, të zhgënjyer në vendimmarrësit politike në të gjithë trojet shqiptare dhe rrjedhimisht mbetemi pa shpresa të mëdha për efektin imediat të saj. Na lejoni t'ju përkujtojmë se edhe Dibra jonë këndej po tkurret, ekonomikisht, demografikisht dhe ne çdo aspekt tjetër zhvillimor dhe kulturor, por brezi ynë, edhe pse në masë të larguar nga vendlindja mbetet jetësisht e interesuar për të.

Qëllimisht nuk përdora frazën 'fatin e saj' sepse shumë nga ne edhe me fjalët që përdorim përpiqemi t'i ikim fatalitetit si kategori sociale aq dominuese ndër shqiptare.

Të shfrytëzojë rastin t'ju informoj se dibranët e kësaj ane momentalisht i mundon edhe fakti se po planifikohet ndërtimi i hidrocentralit të Urës së Boshkut, i cili sipas ekologëve, do shkatërrojë ekosistemin e kësaj ane, ngjashëm siç bëri ndërtimi i hidrocentralit të Shpiles 40 e sa vjet më parë dhe këtë çështje përpiqen ta ngrenë si problem nëpër rrjetet sociale.

Sa do arrijmë është pikëpyetje e madhe dhe a duhet mjaftuar me kaq, nuk jam i aftë të them gjë, të njëjtat dilema besoj që i keni edhe ju, por diçka duhet bërë sëpaku për të mos humbur tërësisht besimin.

Me nderime,
Fisnik Marku

www.rrugaearberit.com
e-mail: rrugaearberit@gmail.com

Rifat Elezi, DIBËR, ALBANIA: Duhet bërë sa më shpejt se rrit zhvillimin ekonomik, kulturor të kësaj zone.

Gleni Albania CROYDON, ECUADOR: Si gjithë të tjerët, më pëlqen ideja edhe pse nuk jam andej tani. Është vendi ku jam rritur, me ato malet e bukura të Dibrës... Shumë fat e bukuri për atë vend. Sepse dua paqe për Shqipërinë.

Agim Murtezani, VELES, MACEDONIA: Sepse njerëzit duhen lidhur

Illi Cami, BROOKLYN, NY: Ju lutem ndërtojeni këtë rrugë... Koha e udhëtimit nga Rinas në Kërçishtë të Dibrës është e gjatë dhe e rrezikshme... Do të jetë më e lehtë për të shkuar në Dibër. Faleminderit.

Xaku Cibaku, DIBRA ALBANIA, ALBANIA: Dibra e para.

Urian Bardulla, TIRANA, ALBANIA: Dibra është një nga rajonet më pak të zhvilluara të Shqipërisë. Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit duke i dhënë një shtysë zhvillimit të ekonomisë lokale.

Rruga gjithashtu do të jetë një arterie vitale për lidhjen mes Tiranës dhe Maqedonisë, duke përmirësuar kështu në mënyrë të konsiderueshme infrastrukturën e kësaj pjese të Ballkanit.

Ndricim Duda, PESHKOPI, ALBANIA: Rruga e Arbërit duhet të përfundojë sa më shpejt sepse gjendja e rrugës tjetër ku udhëtojmë është shumë e gjatë dhe e lodhshme

Mitat Fida, PORTSMOUTH, UNITED KINGDOM: Dibra është një nga rajonet më pak të zhvilluara të Shqipërisë. Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit duke i dhënë një shtysë zhvillimit të ekonomisë lokale. Rruga gjithashtu do të jetë një arterie vitale për lidhjen mes Tiranës dhe Maqedonisë, duke përmirësuar kështu në mënyrë të konsiderueshme infrastrukturën e kësaj pjese të Ballkanit.

Julian Sefullaj, ALBANIA: Nuk është thjesht e nevojshme por e domosdoshme dhe jo vetëm për dibranët por për të gjithë Shqipërinë.

Luljeta Shehu, DURRËS, ALBANIA: Infrastruktura është hapi i parë në zhvillimin e një vendi. Mjaft kemi humbur kohë!

Flamur Dardeshi, TIRANA, ALBANIA: Sepse jetoj aty.

Spartak Xharri, IMPERIA, ITALY: kontribut për vendin tim të lindjes

Saje Franku, ALBANIA: Është e rëndësishme për të gjithë qytetarët e Dibrës.

Altjon Skura, PESHKOPI, GREECE: Sepse jetoj aty.

Anjeza Skura, Επισκοπή, ALBANIA: Sepse jetoj aty.

Armand Tanushi, PESHKOPI, ALBANIA: Të rregullohet rruga e "ARBËRIT"

Denis Horeshka, PESHKOPI, ALBANIA: Bën të mundur zhvillimin e aktivitetit ekonomik në vendin tonë dhe mbarë Shqipërinë

Albana Xhediku, PESHKOPI, ALBANIA: Fëmijët kanë fobi nga udhëtimi 4-5 orësh.

Andi Xhari, TIRANA, ALBANIA: Për një udhëtim më të mirë.

Jeff Owsley,
ALAMOSA, U.S.A.

Kam jetuar në Dibër për pothuajse 5 vite dhe e di se sa kritike është ajo rrugë jo vetëm për njerëzit që jetojnë aty, por për gjithë Ballkanin.

Besim Bajrami, TETOVO, MACEDONIA: Do të ketë përfitime ekonomike për ata që jetojnë aty, dhe shkurton largësinë mes Italisë dhe vendeve të Azisë së vogël (Europë, Azi). Ka shumë përfitime, dhe nuk shikoj asnjë arsye pse të mos realizohet, përveç bllokadës politike ndaj njerëzve të kësaj krahine. Kjo rrugë ishte e rëndësishme që nga lashtësia, dhe nevojat e sotme janë të shumëfishta.

Brikenj Kica, DIBRA, ALBANIA: Sepse jam nga Dibra.

Denis Melani, PESHKOPI, ALBANIA: Jam banor i Dibrës dhe nuk mund të ketë një opsion më të mirë për mua dhe familjen time që jetoj në Dibër. Është një ëndërr një distancë e tillë me Tiranën.

Alkid Ndreu, TIRANË, ALBANIA: Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Flamur Bara, MALMÖ, SWDEN: Dibra është vendlindja ime,aty ku kam shpirtin dhe mendjen time. Unë vetë jetoj në Suedi dhe gjithçka e kam të plotësuar, por kur shikoj që vendi im nuk plotëson kushtet minimale të jetesës më vjen shumë keq. Rruga e Arbërit është një domosdoshmëri për të vazhduar me plotësimin e kërkesave tjera. Kjo rrugë do të ndërtohet!

Esmeralda Kryemadhi, TIRANA, ALBANIA: Sepse prindërit e mi jetojnë aty, në Peshkopi.

Shaban Tahiraj, HELSINGBORG, SËDEN: Të ndërtohet rruga e Arbërit e cila lidh Dibrën me rajonet tjera

Majlinda Hoxha, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse krijon mundësi zhvillimi për rajonin dhe ndihmon njerëzit të jetojnë si të tillë në vendlindjen e tyre.

Klodiana Kuka, TIRANA, ALBANIA: Të kërkosh një rrugë është e drejtë e taksapaguesve të çdo zonë, të kërkosh rrugën e Arbërit do të thotë të sjellësh zhvillim jo vetëm për zonën verilindore, por për të gjithë Shqipërinë.....Faleminderit z.Gëzim për iniciativën. Në dibranët, të jemi shumë mirënjohës.

Gesti Alia, DIBER,ALBANIA, ALBANIA: SEPSE DUHET

Orgesa Cela, PESHKOPI, ALBANIA: Dibra është e pazhvilluar dhe normal që do të na ndihmojë shumë kjo rrugë e cila shpresojmë që të bëhet sa më shpejt, gjërat pozitive që do na sjellë kjo rrugë i keni shkruar ju me sipër.

Elham Jashari, TIRANE, ALBANIA: Sepse e duam.

(Vijon në faqen 6)

Rruga do të lidhë edhe Tiranën me Maqedoninë, duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

opinione

Rruga është e nevojshme dhe e domosdoshme. Jo vetëm për dibranët, por për të gjithë Shqipërinë.

(Vijon nga faqja 5)



Rruga e Arbërit luginës së Tujanit. Foto: Bujar Karoshi

Marie-Louise Ewert, SUNDSVALL, SËDEN: Do të jetë më e lehtë dhe më e shpejtë rruga për te të afërmit e mi.

Briselda Zhuzhi, TIRANE, ALBANIA: Dua të shkoj në vendlindjen time, në vendin ku lindi dhe u rrit babi im

Zyhdi Xholi, ITALY: Duhet të ndërtohet sa më shpejt. Në të gjitha shtetet e civilizuar, qytetarët paguajnë taksat dhe kanë të drejtë të kenë kushte të barabarta jetese pavarësisht ku jetojnë, në kryeqytet, jug, veri apo në majë të malit. Qytetari duhet të jetë i lirë të zgjedhë ku do të jetojë. I takon shtetit taksambledhës t'ia lehtësojë jetesën qytetarit. Përshëndetje të gjithë dibranëve kudo ku ndodhen

Xhevdet Fetahaj, PRISHTINE, ALBANIA: Sepse do të jetë edhe një arterie shtesë për lidhjen e kombit tonë!

Arjan Koka, ATHINE, GREECE: Nuk ka rëndësi kush vjen në pushtet - duam Rrugën e Arbërit prioritet të qeverisë pas 23 Qershorit!

Erisa Kulemani, TIRANA, ALBANIA: Do të rrisë ekonominë lokale, dhe do të kem më shumë mundësi të udhëtoj në vendlindjen time sepse nuk do të marrë aq shumë kohë.

Mikel Mata, PESHKOPI, ALBANIA: Për zhvillimin e rrethit Dibër

Drilon Murra, ITALY: E rëndësishme është të përfundohet rruga e Arbërit pasi kanë kohë që e kanë nisur dhe kurrë nuk po e përfundojnë. Po lënë pas dore një ndër krahinat më të bukura të Shqipërisë. Përfundimi i kësaj rrugë do t'i jepte përparësi dhe zhvillim jo vetëm Dibrës por edhe shumë shteteve të huaja dhe do të ishte një nga pikat kyçe të zhvillimit të turizmit. Shpresojmë që këtij peticioni t'i bashkangjiten jo 2 mijë persona që janë tani por të arrijë në 200 mijë dhe më shumë. Faleminderit për mirëkuptimin...

Alban Stari, LONDON, UNITED KINGDOM: Do ishte puna më e mirë për Dibrën po të bëhej, prandaj ajo duhet përfunduar, respekte nga Londra and Shkodra

Alban Stari, LONDON, UNITED KINGDOM: Rruga Arberit është një rrugë shumë e rëndësishme për të gjithë shqiptarët, sepse ajo rrugë lidh gjysmën e Shqipërisë, me të vërtetë do ishte puna me e mirë e gjithë këtyre viteve po të mbaronte ajo rruge, rruga Arbërit, respekte nga Londra and Shkodra,

Ildi Lala, BULQIZE, MACEDONIA: Rrugë.

Bledar Iskurti, GREECE: Jam nga Dibra.

Andi Bica, TIRANA, ALBANIA: Sepse është pjesë e historisë urbane të Dibrës.

Ornela Gaçi, TIRANA, ALBANIA: Dua që Dibra të jetë afër Tiranës, e jo të pres gjashtë orë për ta parë.

Tarzan Halili, TIRANA, ALBANIA: Na ndihmon të shkojmë më shpejt në vendlindje si dhe na jep mundësinë të takojmë më shpesh të afërmit tanë. Kjo na ndihmon gjithashtu edhe për afrimin me Maqedoninë për të importuar dhe Eksportuar mallrat."I AM PROUD TO BE DIBRAN"

Marjonela Dani, TIRANA, ALBANIA: Dibra ka nevojë urgjente për zhvillim e përparim, Dibra ime e dashur ka nevojë të shfaqë vlerat e saj, Dibra ka nevojë të shpejtë për Rrugën e Arbrit. Nuk na intereson që rruga të bëhet plaçkë zgjedhjesh e fushatash të ndryshme e duam atë konkrete dhe jo abstrakte, kemi nevojë për të në realitet dhe jo në letra që flaken nga njëra zyrë në tjetrën. Respekte M. D.

Vjosa Ferizi, GOLEM, ALBANIA: Udhëtoj shpesh në atë rrugë.

Kastriot Veselaj, KOSOVO, ALBANIA: Skënderbeu.

Edi Sara, TIRANA, ALBANIA: Jam dakord me propozimin e Dr. Alpion, që kjo rrugë është një qendër nevralgjike për të hapur një rrugë të re zhvillimi për ekonominë dhe sektorin e turizmit.

Aida Hasanpapa, TIRANA, ALBANIA: Për arsyet që janë përmendur më parë.

Arnold Meta, ITALY: Është rruga ime. Kam nevojë për të.

Fari Plaku, TIRANA, ALBANIA: Të ndërtohet sa me shpejt dhe mirë rruga që bashkon Tiranën me Peshkopinë

Amarildo Prifti, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse do të sjellë zhvillimin e të gjithë vendit. Është një qytet i pazhvilluar, ndaj me prekjen e duhur mund të bëhet një qendër e re bujqësie, përveç mundësive të tjera të shumëllojta për të sjellë gjallëri në ekonominë e sotme.

Argetim Muça, DIBER, MACEDONIA: Ndërtimi sa më i shpejtë i rrugës së Arbrit

Melsen Nela, PESHKOPI, ALBANIA: Ndërtimi i rrugës do të zhvillojë qytetin tonë.

Altin Sherifi, TIRANA, ALBANIA: Të takoj miqtë sa me shpesh

Albana Myftari, TIRANA, ALBANIA: Është një segment rrugor shumë i rëndësishëm dhe do të përmirësojë jetën e dibranëve.

Liman Alku, TIRANA, ALBANIA: Komunikimi përmes rrugëve të mira është e të njëjtit nivel me zhvillimin e ekonomisë lokale, do të ndalojë migrimin e popullsisë së Dibrës drejt qendrës dhe perëndimit të Shqipërisë.

Ramadan Shehu, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse jam Dibran

Drilona Ibrahimi, TIRANA, ALBANIA: Sepse kur zoti krijoi malet i bëri me qëllimin që njërëzit të shohin fushat

Erjon Piperku, TIRANA, ALBANIA: Sepse jam nga Dibra.

Erjon Erjon, TIRANë, ALBANIA: Jam pro rrugës së Arbërit dhe jap firmën time për këtë vepër madhore

Shpetim Lugja, TIRANA, ALBANIA: Ndërtoni sa më shpejt dhe me standarde Rrugën e Arbërit

Dritan Nesimi, BULQIZë, ALBANIA: Zona e Dibrës duhet të jetë në vëmendje për gjate 4-vjeçarit të një pushteti edhe jo vetëm në kohën e fushatës.

Nertila Beqiri, TIRANA, ALBANIA: Ndërtimi i rrugës së Arbërit

Fisnik Tola, TIRANË, ALBANIA: Të bëhet sa me shpejt stop premtimeve elektorale nga kushdo parti mos lejoni ta përdorin si premtim për zgjedhje ajo duhet bërë

Edmond Mulaj, TIRANE, ALBANIA: Është e rëndësishme sepse kjo rrugë lidh Shqipërinë me Maqedoninë.

Ervin Carka, TIRANA, ALBANIA: Rruga sjell zhvillim

Nertila Hoxha, LUSHNJë, ALBANIA: Sepse kemi nevojë të zhvillohemi sa më shumë që të jetë e mundur.

Islam Shehu, PESHKOPI, ALBANIA: Rruga e Arbërit

Kledi Xhaxhiu, TIRANA, ALBANIA: Për shmangien e vazhdueshme të lëvizjes demografike të shtetasve nga krahina verilindore e Dibrës drejt Tiranës dhe qyteteve qëndrore për një jete më të mirë si edhe për t'u dhënë këtyre bashkëkombasve një shans për zhvillim të qëndrueshëm e mbështës fuqishëm këtë peticion.

Mehmet Gjeta, BRESCIA, ITALY: Mbarimi i rrugës së Arbrit .

Nertila Reçi, TIRANA, ALBANIA: Të lidhë Dibrën me vendet e rajonit më të zhvilluar, të shtojë numrin e vizitorëve se është një vend që ja vlen të vizitohet, jo vetëm për bukuritë natyrore por dhe për arsye kurative "ujrat termale të Peshkopisë" që kanë treguar që janë më kurative. Në rast se më duhet të flas për arsyet e ndërtimit të rrugës së Arbrit janë të pafundme si personale ashtu dhe sociale. Uroj që kjo nisme të realizohet sa më shpejt.

Vjollca Horeshka, PESHKOPI, ALBANIA: Është e rëndësishme sepse ndikon në zhvillimin ekonomik të zonës dhe të vendit në përgjithësi.

Indrit Nushi, TIRANA, ALBANIA: Zhvillon vendin tim.

Donat Mustafa, PRISHTINA, KOSOVO: Kombi

Mario Kapa, NOTTINGHAM, UNITED KINGDOM: Rruga sjell zhvillim.

Klajdi Dinoshi, DURRES, ALBANIA: Rruga e Arbërit të nisë e të mbarojë një sahat e më parë, e ky peticion duhej bërë më përpara.

Blerim Vrenezi, TIRANA, ALBANIA: Sepse kjo rrugë më lidh me familjen time.

Elton Gazidedja, TIRANA, ALBANIA: Sepse shkoj shpesh e Dibër..

Oelda Spahiu, TIRANE, ALBANIA: Sepse është thelbësore për Dibrën që të zhvillohet.

Romir Spahiu, NEW YORK, NY: Jam lindur në atë qytet.

Andrea Miha, BULQIZë, ALBANIA: Sepse krijohen mundësi më të mira jetese. Për të mirën e qytetarëve dibranë

Erblin Çemalli, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse jam nga Dibra

Osman Osmani, TIRANA, ALBANIA: Dua që Dibra të jetë më pranë qyteteve të mëdha si Tirana apo Durrësi, pra që lëvizja nga një qytet në tjetrin të mos jetë kaq i gjatë dhe i bezdisshëm.

Erblina Shubleka, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse kështu mund të vizitoj prindërit më shpesh.

Maliq Fisniku, TIRANA, ALBANIA: Është vendlindja ime e shtrenjtë

Ujkan Frangu, DEBAR, MACEDONIA: Bashkimin e shqiptarëve

Bisha Net, DURRES, ALBANIA: Sepse Peshkopia është vendlindja ime, me këtë rrugë që është tani më ikën dëshira për të vizituar vendlindjen time.

Besian Bitri, FLORENCE, ITALY: Më bëhet shumë qejfi për një iniciativë të tillë, për të bashkuar Dibranët, dhe zgjuar nga një gjumë gati shekullore. Dibra, vendi dhe njerëzit që sakrifikuan gjithçka për Shqipërinë dhe Shqiptarët të katandisen në këtë mënyrë shumë të turpshme dhe qesharake... (Redaktuar). Nuk mendoj se kjo do jetë zgjidhja e problemeve të Dibrës dhe Shqipërisë, edhe pse e mbështes me trup dhe shpirt. Dibranet kudo që ndodhen duhet të lirohen nga frika dhe injoranca që po i shpie në shkatërrim, mizerie dhe degjenerim. Duke ua humbur gjakun dhe sakrificat gjyshërve tanë që dhanë jetën me dëshirë për SHQIPERINË.

Olsi Hoxha, PESHKOPI, ALBANIA: Unë udhëtoj në Dibër çdo vit dhe është e pamundur për të shkuar nga Dibra në Tiranë se rrugët janë plot me gropa dhe shumë të rrezikshme për të udhëtuar. Faleminderit.

Besfor Laçi, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo nuk duhet të quhet rruga e Arbërit, por rruga e Oksigjenit për një krahinë tashmë të harruar... shpresojmë prej vitesh por jemi optimiste...

Ornela Fisniku, TIRANA, ALBANIA: Është qyteti i burrit tim.

Besa Fejzo, TIRANA, ALBANIA: Është qyteti i miqve të mi.

Fiqirete Uka, TIRANA, ALBANIA: Është qyteti im.

Juliana Beqiri, TIRANA, ALBANIA: Qyteti i miqve të mi.

Xeni Tuka, DURRËS, ALBANIA: Ajo rrugë është shumë e rëndësishme për ne ju lutemi mos e leni pas dore. Faleminderit

Ermira Pashaj, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse është përgjegjësia e çdo qeverie për zhvillimin e qytetit.

Albert Alliu, STRIKCAN, ALBANIA: Sepse dibranët e meritojnë.

Veikko Anttonen, TURKU, FINLAND: Për shkak të miqve të mi shqiptarë.

Eraldo Gazidede, DIBRA, ALBANIA: Sepse jam nga Dibra.

Elson Datja, PESHKOPI, ALBANIA: Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidhë edhe Tiranën me Maqedoninë, duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Sajmir Mikli, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për të gjithë kombin.

Përgatiti për botim dhe përktheu nga anglishtja: **AFRIM KAROSHI**

SHËNIM I REDAKSISË: Komentet janë të pacensuruara. Redaksia ka ndërhyrë në komente vetëm për korrigjime drejtshkrimore. Gjithashtu, në këtë përmbledhje janë përfshira vetëm komentet e shënuara në faqen e peticionit në change.org.

intervistë

Erisa Saraçi: Zëri i vajzave dhe grave për kauzën e Rrugës së Arbërit


Erisa Saraçi

Rruga e Arbërit është një nga temat që është përfolur shumë kohët e fundit, një kauzë kjo e ndërmarrë nga Dr. Gëzim Alpion i cili edhe pse prej vitesh jeton në UK por vazhdimisht ka qenë i lidhur me vendlindjen e tij. Ajo çfarë na ka bërë përshtypje është se kjo iniciativë është ndjekur nga shumë gra e vajza të cilat me zërin e tyre kanë treguar se edhe ato mund të kenë fuqi vendimmarrëse për të sjellë ndryshime. Një prej tyre është edhe Erisa Saraçi, një vajzë dibranë që ndjek studimet e doktoraturës në Gjermani.

Jeni përfshirë së fundmi në një kauzë që Dr. Gëzim Alpion ka ndërmarrë me peticionin "Rruga e Arbrit" – çfarë do të thotë kjo për ju?

Përfshirja në këtë kauzë është vendimi më i natyrshëm që kam marrë ndonjëherë. Të mbështesësh një çështje me kaq rëndësi për vendin tënd është sa spontane aq edhe e domosdoshme. Ashtu sikurse jemi dëshmitarë të një kohe jo pikërisht të artë për vendin tonë, kemi edhe shansin të jemi pjesë aktive e ndryshimeve që do të sjellin zhvillim për të. Prandaj edhe pjesëmarrja në kauza të tilla është thjesht privilegj për këdo që do vendin e tij dhe që nuk pajtohet me ngërçin e përparimit.

Çfarë ju shtyu të përfshiheshit në këtë peticion?

Për Rrugën e Arbërit nuk është nisur të lobohet tani, për të ka vite që qytetarë të angazhuar, inxhinierë, gjeologe punojnë dhe lobojnë, të nisur nga nevoja popullit dibran dhe e të gjithë atyre që prek ky projekt. Që në vitin 1996 është marrë iniciativa e parë nga një grup qytetarësh dibranë, anëtarë të shoqatës "Nisma Dibrane" për t'i bërë një kërkesë zyrtare qeverisë së kohës për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Ndërmarrja e një hapi të tillë vinte nga domosdoshmëria e kësaj rruge për zhvillimin lokal e kombëtar, si dhe nga mungesa e një iniciative të tillë nga pushteti qendror deri në atë moment. Megjithëse gjatë këtyre viteve është folur dhe premtuar shumë për Rrugën e Arbërit, ngritja e çështjes rishtas, nëpërmjet një peticioni publik për ndërtimin e saj, dëshmon që situata nuk ka ndryshuar shumë që nga 1996-a. Punimet që janë bërë në Rrugën e Arbërit kanë qenë me hapin e breshkës, të intensifikuara herë pas here vetëm në prag fushatash elektorale. Sa është ndërtuar një segment është prishur një tjetër, duke lënë të kuptohet që cilësia e punimeve ka qenë shumë e dobët.

Ndërtimi i Rrugës së Arbërit është një projekt modest, krahasuar me projektet e shumta rrugore të realizuar nëpër të gjithë Shqipërinë. Nga statisktikat zyrtare, Rrethi i Dibrës rezulton të jetë më i varfri në Republikë. Dibranët paguajnë taksat si gjithë të tjerët, por dhe historia ka dëshmuar që nuk e kanë kursyer kurrë veten për çështjet kombëtare. Ata thjesht nuk e meritojnë këtë neglizhim total! Rëndësia e Rrugës së Arbërit nga ana tjetër është shumë larg të qënit modeste; Ajo do ndihmonte në zhvillimin e zonave nga ku kalon, duke ndihmuar ekonominë minerale, bujqësore e atë të turizmit. Përfitimet nga kjo rrugë nuk janë vetëm në shkallë rrethi, por edhe në shkallë vendi e rajoni të Ballkanit, duke qenë se ajo lidh Tiranën e Durrësin me Maqedoninë.

Rruga e Arbërit deri në Dibër është afërsisht 80 km. Ajo do u hiqte dibranëve 100 km që i mbajnë kot mbi shpinë, duke kaluar për nga rruga aktuale nacionale, Dibër-Klos-Burrel-Milot-Tiranë, e gjatë 183 km. Aksi i saj është i zgjedhur nga populli shekuj më parë dhe nuk e mban rastësisht atë emër. Hyrja në Tiranë nga Rruga e Arbërit bëhej nëpërmjet rrugës që ende sot quhet "Rruga e Dibrës". Sot dibranët nga


Rruga e Arbërit dhe rruga aktuale, sipas posterit të Shoqatës "Nisma Dibrane", punuar në vitin 1996. © B.Karoshi


Tuneli i Qafës së Tujanit, maj 2013. © B.Karoshi

lindja, bëjnë një rrotullim dhe më pas hyjnë në Tiranë nga perëndimi – Pra si të kapësh veshin e majtë me dorën e djathtë. Kjo është mungesë efektiviteti, humbje e madhe energjie dhe kohe. Durimit të dibranëve i ka ardhur fundi. Premtimet për mbarimin e Rrugës së Arbërit janë bërë aq bajate, sa ndërtimi i Rrugës së Arbërit në Dibër përdoret metaforikisht për „kurrë".

Nisja e një peticioni që bën thirrje për ndërtimin e Rrugës së Arbërit në këtë moment nga Dr.Gëzim Alpipon ishte një domosdoshmëri dhe përfshirja në të është një detyrë për këdo, që e kupton rëndësinë e çështjes dhe ka mundësinë të bëjë diçka. Nuk lodhemi së theksuari që ky nuk është peticion politik, në sensin që nuk synon të favorizojë apo godasë specifikisht asnjë nga forcat politike. Është zëri i dibranëve të thjeshtë, që kanë gjithë të drejtat të flasin në emër të nevojave të tyre minimale. Sigurisht ai do t'i dorëzohet cilësdo qeveri që do rezultojë nga zgjedhjet e 23 qershorit, pasi në fund ata janë ligjvënësit e zgjedhur nga populli për të lëvizur mekanizmat e shtetit që projekte të tilla të shkojnë përpara.

Ka qenë kjo një iniciativë e juaja për faktin se jeni nga Dibra apo do të bënit të njëjtën gjë edhe nëse nuk do të ishit përfaqësuese e këtij qyteti?

Pa dyshim fakti që jam nga Dibra më ka bërë të jem më në brendësi të problemit dhe për rrjedhojë ndjeshmëria ndaj tij ka qenë më e lartë. Kam jetuar në Peshkopi për 18 vitet e para të jetës sime, deri sa largësia artificiale nga kryeqyteti dhe përqendrimi i shërbimeve kombëtare në qendër na detyroi, si shumë shqiptarë të tjerë, të lemë vendlindjen e të migrojmë brenda vendit për një jetë më të mirë. Vështirësitë që pasuan për familjen time qenë të mëdha. Veç tjerash, të gjesh një punë në kryeqytet në moshën 50-vjeçare për prindërit e mi qe një mision gati i pamundur. Nëse rruga e Arbërit do ekzistonte që atëherë, jam e sigurt që shpërngulja e njerëzve nga Dibra në Tiranë do kish qenë në nivele shumë herë më e ulëta. Kjo është eksperienca ime, por gjithë shqiptarët që nuk kanë qenë banorë të Tiranës para 90-ës kanë patur të njëjtën përvojë. Ashtu siç njoh edhe shumë miq nga Kukësi, që me t'u konkretizuar ndërtimi i rrugës Durrës-Prishtinë, lanë kryeqytetin dhe u kthyen në vendlindje, ku jetojnë shumë mirë tashmë. Prandaj besoj se të gjithë e kuptojnë rëndësinë e kësaj rruge dhe solidarizohen në këtë rast me dibranët dhe të gjithë banorët e zonave nga ku ajo kalon, që nga Tirana deri në kufi me Maqedoninë. Dhe është fakt që peticioni ka patur mbështetje të gjerë nga të gjithë qytetet e Shqipërisë, si dhe nga miq nga vende të ndryshme të botës. Rrugët nuk garantojnë zhvillim, por janë pa dyshim një hap i qëndrueshëm në atë drejtim. Në këto raste çdokush del jashtë kutisë së vogël (vendit nga vjen) dhe krijon një këndvështrim më të gjerë për rëndësinë kombëtare të projekteve të tillë. Prandaj unë personalisht do mbështesja çdo projekt që ndihmon në zhvillimin e Shqipërisë dhe decentralizimin e investimeve.

Ndërkohë jeni duke ndjekur studimet tuaja të doktoraturës në Gjermani – si e mbani lidhjen me vendin tuaj?

Për të mbajtur lidhjet me vendin dhe miqtë pengesa nuk vjen nga mjetet, pasi sot mund të marrësh çdo informacion brenda pak sekondash, por kufizohet më shumë nga koha dhe energjitë që të mbeten në fund të ditës. Çdo student doktorature do ta kuptonte këtë shumë mirë. Aq më tepër kur fusha e studimit përfshin edhe punë eksperimentale, siç është fusha ime e Katalizës (Inxhinieri Kimike). Megjithatë në darkë vonë kam kohën kur përditësohem me lajmet dhe ngjarjet e ditës nga Shqipëria, por jo vetëm. Mundohem që informacionin ta marr nga burime të ndryshme dhe nga komunikimi direkt me njerëzit për të krijuar një ide sa më realiste të situatës në vend.

Nga përvoja e deritanishme si aktive në këtë projekt të Rrugës se Arbrit a keni parë shumë gra të tregojnë interes për t'u bërë pjesë?

Patjetër. Gratë kanë qenë po aq, ndoshta më shumë, aktive sa burrat. Nuk më pëlqen të bëj ndasi gjinore, qoftë edhe me qëllim të mirë, por e kuptoj që për shkak të historisë së mentalitetit tonë, duket sikur janë burrat ata që flasin në fund. Në fakt lobimi që kanë bërë gratë në mbështetje të çështjes së Rrugës së Arbërit, që në fillim vitet 90, ka qenë pa kursim dhe shumë efektiv. Shembull për të përmendur është gazetarja Zamira Koleci, e cila i hapi rrugë e para në Radio Tirana mediatizimit të çështjes, apo mbrojtja publike që i ka bërë Forumi i Grave në Peshkopi, me kryetare Sanie Batkun. Mund të përmendim gjithashtu edhe gazetaren Radije Hoxha në Prishtinë, si dhe gra të tjera që kanë patur një profil më pak publik, si Miranda Goleci e Mjalinda Mati-Manushi (Tirane) si dhe studentet Ersida Kojku (Bullgari), Erisa Hoxha (Milano), Erda Cami (Poloni), e shumë vajza dhe gra të tjera të nderuara.

Shpesh është supozuar se misionet e mëdha u takojnë burrave – ju si e shihni gruan shqiptare?

Unë jo vetëm nuk i mbështes të tilla „cliché", por edhe ideja e barazisë gjinore më duket penguese për femrat. Në përgjithësi mendoj që njerëzit nuk duhet të krijojnë një plan zhvillimi në bazë të krahasimit me të tjerët, aq më pak në rang gjinie, por vetëm me veten; duke shtyrë limitet e tyre. Në këtë aspekt, gratë shqiptare, të detyruara nga rrethanat, i kanë shtyrë shumë limitet e tyre. Kanë dashur gjithmonë të kenë perfeksion në familje, në kuzhinë, në profesion, në paraqitje dhe ia kanë arritur në çdo drejtim. Ato janë misionare në vetvete.

Mendoj se misionet e mëdha u takojnë njerëzve pasionantë, të cilësdo gjinie qofshin ata.

Ju vetë a jeni e kënaqur me arritjet tuaja dhe rolin që keni si grua për të sjellë ndryshime në ambientin ku jetoni qoftë edhe në drejtim të ngritjes së imazhit të gruas shqiptare në botë?

Unë jam ende në ndryshim të vazhdueshëm dhe nuk mund të dal jashtë vetes e të bëj një bilanc për arritjet e mia. Po punoj për veten dhe të ardhmen time. Nga plani personal pastaj vjen edhe ndikimi në ambientin ku jetoj. Çdokush mund të bëjë diçka për vendin e tij, por sa më shumë të kesh investuar te vetja, aq më larg mund të arrijë përpjekja jote për të ngritur imazhin e komunitetit që përfaqëson. Në një bisedë me disa kolegë gjermanë mbi emigrantët në Gjermani, njëri nga ata tha: "Nëse të gjithë emigrantët do ishin si ju (ishim 2 shqiptarë doktorantë), do i zëvendësonim me qejf me disa gjermanë që s'na duhen për asgjë." Sigurisht kjo varet në realitet nga ata që kanë vendet e punës në dorë, por ishte mirë ta dëgjoje.

Në fund dua t'ju falenderoj juve për intervistën. Kjo e ngre zërin tonë edhe më shumë dhe e sjell çështjen më pranë të gjithë shqiptarëve, veçanërisht atyre në Britani. Ju bëj edhe një herë thirrje të gjithë atyre që e kuptojnë rëndësinë e kësaj kauze, t'i bashkohen asaj, t'u bashkohen bashkëkombasve që kanë aq nevojë për këtë rrugë, duke firmosur peticionin online në change.org.

Bisedoi: **Mirela Sula**
(Marrë nga http://albanianwoman.co.uk)

Rruga e Arbërit nr. 85

vëzhgim

Dibra e Madhe me bujqësi në gjendje të vështirë



Tani ky kombinat nuk ka as vreshta, as dele, as mekanizim bujqësor, as makinë për klasifikimin e farës së jonxhës, as për tharjen e briketimin e jonxhës, as depo mallrash. Çdo gjë është shkatërruar. Kanë mbetur vetëm gërmadhat, muret dhe çatitë me pamje të shëmtuar.

Dikur furnizonte Stambollin me prodhime bujqësore, sot nuk ushqen as veten

Nga **REXHEP TORTE**

Sipas të dhënave historike në majën e zhvillimit dhe lulëzimit ekonomik, në bjeshkët e Krahinës së Dibrës kullotnin një numër i konsiderueshëm i bagëtive, që furnizonin me bylmet, kajmak, gjalp e mish edhe Selanikun e Stambollin. Asokohe për të vajtur në destinacion bylmeti ambalazhohej në tollume lëkure. Konsujt e jashtëm që vizitonin këto vise lumturoheshin nga kultivimi i perimtarisë, frutave dhe blegtorisë dibrane.

Të gjitha këto bagëti i plaçkitën ushtritë serbe, e bullgare gjatë ofensivave të njëpasnjëshme shkatërrimtare në Luftën e Parë Botërore, ndërsa popullata që shpëtoi nga hanxharët serbo-bullgarë u detyrua të shpërngulet në Tiranë, Durrës dhe Elbasan.

Sot Dibra e Madhe e zvogëluar nga aspekti territorial dhe nga numri i popullsisë ka mbetur edhe pa bujqësi dhe blegtori të zhvilluar.Doktrina e zhvillimit ekonomik gjithnjë mbështet tezën se nuk mund të ketë përparim të një vendi pa zhvillimin e prodhimtarisë.

Pamja e mjerueshme në të cilën ndodhet sot Kombinati Bujqësor i dikurshëm "Progres" në Dibër të Madhe paraqet sinonim edhe të gjendjes tejet të vështirë në të cilën ndodhet bujqësia dibrane. Nga ky kombinat dikur i përmendur për prodhimet e tij bujqësore e blegtorale nuk funksionon më asgjë. Pamjet janë trishtuese dhe duket sikur të ketë përjetuar ndonjë bombardim të fuqishëm nga ajri. Në këtë kombinat bujqësor nuk vërehet asnjë shenjë gjallese, edhe pse në lulëzimin e tij kishte 230 të punësuar.

Sipas të dhënave ekzistuese, në vitin 1957 me nismën e një grupi të bujqve individualë dibranë dhe me mbështetjen e Këshillit të komunës së Dibrës së Madhe u themelua fillimisht Kooperativa bujqësore "Progres". Kjo kooperativë veprimtari kryesore kishte zhvillimin e kooperimit me bujqit dibranë të shquar për prodhimet cilësore.

Më 1 janar të vitit 1963 kësaj kooperative i bashkohet edhe Ekonomia bujqësore "Proleter", e cila sipërfaqet e veta i kishte kryesisht në Luginën e Udovës, që tashmë është mbuluar nga uji i Liqenit të Dibrës. Nga mjetet e mara si dëmshpërblim për tokën e përmbytur u blenë disa kamionë, duke themeluar edhe repartin e transportit, që më vonë u nda dhe u themelua si ndërmarrje transportuese "Spiletrans" nga më të dëgjuarat në atë kohë.

Kjo kooperativë bujqësore në vitin 1967 u shndërrua në Kombinat bujqësor "Progres" me 400 hektarë tokë bujqësore, 2000 hektarë kullosa malore dhe 5000 kokë dele.

Si rezultat i transformimeve në vitet 1969/70 ky kombinat pëson një rënie të prodhimtarisë dhe caktohet që të udhëhiqet nga një drejtori e dhunshme. Ndërkaq në vitin 1970 me punësimin e disa kuadrove të reja arrin që të rritet prodhimtaria bujqësore. Ndërsa në vitin 1974 ky kombinat mbi bazën e ligjit të atëhershëm për transformimin bujqësisë, u shndërrua si organizatë e përbërë e punës së bashkuar me degët e bujësisë, blektorisë, tregtisë dhe shërbimet e përbashkëta. Në kuadër të këtij kombinati bujqësor ishte edhe Sistemi meliorativ i ujitjes, i cili filloi të funksionojë në vitin 1972.

Me mjetet bankare nga fonde të ndryshme dhe punë vullnetare të nxënësve të shkollave fillore,të gjimnazit e të vetë punëtorëve, në vitin 1981/2, u ngritën 50 hektarë vreshta me 150 mijë fidane hardhishë në fushën e Klobçishtit përbri kufirit me Shqipërinë. Frytet e para nga këto vreshta ishin 250 tonelata rrush i cilësisë së parë të varieteteve prestigjioze.

Me që rajoni i Dibrës së Madhe është i përmendur për cilësinë e farës së jonxhës që arrinte prodhim deri në 30 tonelata, ky kombinat bleu edhe makinën Trifolin për pastrimin dhe klasifikimin e farës së jonxhës dhe makinë për tharjen, bluarjen dhe briketimin e jonxhës.

Në Kombinatin Bujqësor "Progres" në kohën e lulëzimit të tij u ndërtua edhe një depo e madhe mallrash me kapacitet prej 2000 tonelatash.

Teposhtëza e këtij kombinati filloi në vitin 1992,në kohën e ndryshimeve organizative shoqërore, kur ekonomia e planifikuar shtetërore kaloi në ekonomi të tregut, kur edhe filloi nxjerrja e të punësuarve nga puna dhe humbja e interesimit për ta mbajtur gjallë këtë kombinat .

Si rezultat i kësaj në këtë kombinat bujqësor mbeti vetëm një numër i vogël i të punësuarve.

Kishte përpjekje dhe mendime se ky kombinat bujqësor edhe mund të shpëtonte nga shkatërrimi, po qe se shndërrohej në shoqëri aksionare,siç ndodhi me disa kombinate tjera që funksionojnë sot e kësaj dite, por kjo gjë fatkeqësisht nuk ndodhi me këtë kombinat bujqësor, të cilin askush nuk arriti ta shpëtojë nga shkatërrimi.

Tani ky kombinat nuk ka as vreshta,as dele, as mekanizim bujqësor,as makinë për klasifikimin e farës së jonxhës, as për tharjen e briketimin e jonxhës, as depo mallrash. Çdo gjë është shkatërruar. Kanë mbetur vetëm gërmadhat, muret dhe çatitë me pamje të shëmtuar.

RINGJALLJA E KËTIJ KOMBINATI NUK NDODHI

Ajo që dihet e po shihet çdo ditë, është gjendja e vështirë e bujqve të vyer dibranë, që kanë mbetur pa asfare mbështetje e stimulimi për të punuar e prodhuar.

Ata bujq dibranë që kanë tokat e tyre dhe ata që mund të marrin tokë e ta punojnë me qera, ballafaqohen me mungesën e stimulimit dhe me mungesën e ujitjes së tokës.

Siç është bërë e njohur, hajnat e papërgjegjshëm në vjedhjet para gjashte viteve të kabllove të motopompave të Stacionit të ujitjes buzë liqenit të Dibrës, shkaktuan dëme prej afër treqind mijë eurosh, që vështirë se mund të riparohen. Kjo do të thotë se edhe kësaj vere tokat e bujqve dibranë do të mbeten pa ujë.

Plagë tjetër e bujqësisë dibrane është edhe mos sistemimi i ujërave të zeza ose mos ndërtimi I kolektorëve që do ti pastronin këto ujëra dhe do të mundësonin prodhimin e perimeve të shëndosha bujqësore.

Problem tjetër i theksuar i buqëve dibranë është edhe dukuria e vjedhjes së lopëve të tyre nga stallat natën nga hajnë të ndryshëm, që thuhet se këto lopë i shesin në tregjet e Shqipërisë.


Kjo dukuri vazhdon vite me radhë dhe askush nuk është në gjendje ta ndërpret.

E tërë kjo ka ndikuar që shumë bujq dibranë, për të mos qenë pre e hajnëve, e kanë zvogëluar dukshëm numrin e gjedheve të trasha.

Kjo flet qartë se bujqësisë dibrane i duhet kushtuar kujdes dhe angazhim më i madh për zhvillimin e saj, sidomos në këtë krizë ekonomike globale dhe në këtë papunësi të madhe.



veprimtari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

I jep

ELEZ NDREU (Pas vdekjes)

Dekoratën "Nderi i Kombit"

"Si veprimtar dhe diplomat i shquar në lëvizjen kombëtare shqiptare, dhe si luftëtar e komandant i vendosur, i cili drejtoi dhe luftoi gjatë betejave të vitit 1911-1925 për mbrojtjen e tërësisë tokësore dhe çlirimit kombëtar".

Nr. Dekretit 8161
Tiranë, më 09.05.2013

PRESIDENTI
BUJAR NISHANI



Foto: ©Çezar Ndreu

Përurohet në Peshkopi busti i ri i Elez Isufit, punuar me mjeshtëri nga skulptori Sadik Spahija

Motivacioni:

"Si veprimtar dhe diplomat i shquar në lëvizjen kombëtare shqiptare, dhe si luftëtar e komandant i vendosur, i cili drejtoi dhe luftoi gjatë betejave të vitit 1911-1925 për mbrojtjen e tërësisë tokësore dhe çlirimit kombëtar".



Nderi i Kombit

për 'Gjeneralin me shajak'



Foto: © presidenca.al

Më datën 11 maj, ora 10 në qytetin e Peshkopisë u bë ceremonia e nderimit të legjendës së luftës anti serbe, patriotit dibranë Elez Isufi. Me këtë rast kishin ardhur nga të gjitha fshatrat e Dibrës si dhe nga Tirana.

Ishte i pranishëm Presidenti i Republikës zoti Bujar Nishani, deputetët Sherefedin Shehu, Igli Cara, Bedri Hoxha, Jemin Gjana, kryetari i komunës Dibër Rruzhdi Lata, kryetari i bashkisë Bulqizë Roland Keta.

Në orën 11, tek busti i Elez Isufit, i mbuluar me flamurin kombëtar përshëndeti të pranishmit kryetari i bashkisë zoti Ilir Krosi. Deputeti Sherefedin Shehu me pinjollin më të ri të familjes Ndreu, Eduard Ndreu, zbuluan bustin e Elez Isufit, punuar me mjeshtëri nga skulptori Sadik Spahia.

Në orën 11 e 30 ceremonia do të vazhdonte në pallatin e kulturës "Haki Stërmilli" ku Presidenti i Republikës zoti Bujar Nishani i akordoi patriotit dhe atdhetarit Elez Isuf Ndreu Urdhërin "Nderi i Kombit" (Pas vdekjes), me motivacionin "Si veprimtar dhe diplomat i shquar në lëvizjen kombëtare shqiptare, dhe si luftëtar e komandant i vendosur, i cili drejtoi dhe luftoi gjatë betejave të vitit 1911-1925 për mbrojtjen e tërësisë tokësore dhe çlirimit kombëtar". Presidenti ia dorëzoi medaljen nipit të Elez Isufit, Jonuz Ndreut.

Kreu i Shtetit e cilësoi këtë takim një rast fatlum dhe një detyrim për të si President i Republikës, për të nderuar me mirënjohje të thellë kontributin patriotik dhe liridashës të njërit prej bijve të kësaj treve.

Në fjalën e tij, Presidenti Nishani nënvizoi domosdoshmërinë e rikthimit tek etrit themelues në mënyrë që anija e identitetit kombëtar të mos e humbasë busullën dhe të ecë përpara. Kreu i Shtetit theksoi se vetëm në këtë mënyrë shpirti i frymëzimit të gjithsecilit do të jetë kurdoherë i gjallë, do të gjejë dritë dhe eksperiencë, forcë dhe besim për të punuar për atdheun me atë përkushtim ashtu siç bënë edhe patriotët e rilindjes kombëtare.

Duke iu drejtuar qytetarëve dibranë, Presidenti Nishani vlerësoi gjithashtu se mirënjohja shqiptare do të flasë përjetësisht për figura të tilla heroike, si Elez Ndreu, të cilët u vetësakrifikuan për të ruajtur trojet shqipare. Veprimtaria kushtuar patriotit Elez Isuf Ndreu vijoi me një dokumentar kushtuar kontributit të tij në lëvizjen kombëtare shqiptare dhe një program të pasur me këngë patriotike dibrane.

Sh. Skarra

Shënime nga takimi me këngëtarin, krijuesin dhe instrumentistin në çifteli e fyell Sadik Maha

Nga Limjani në Athinë me çifteli e këngë



Çiftelinë e fyellin i mësova që në moshë të vogël. I vogël isha kur mora pjesë për herë të parë në veprimtaritë e shkollës tetëvjeçare. Më vonë isha pjesë e grupit artistik të shkollës së mesme të Kastriotit. Shtëpia e kulturës në Limjan ishte vendi im më i dashur...

Ai më tha se i ka rrënjët në Limjan e unë nuk mund të rrija i ngujuar në Athinë pa u ngjitur shpatullës së malit të Korabit që i mbledh e i shpërndan katundet e shtëpitë si kokrrat në një vile rrushi mbi pjergullën varur në lis.

Ai më tha jam nga Limjani dhe unë nuk mund të rrija pa shfletuar doracakun monografik "Thatina e Dibrës dhe shpirtëra në qiell" të stukuesit plot pasion nga Sohodolli Qeram Cibaku i cili shkruan:

"Fillimisht Limjani kishte tre fise: Miha (ose fisi Maha i sotëm) Duraku dhe Roçi (këtody fise nuk kan lënë trashëgimtarë)"..

Lart e larg më erdhi Zimuri, më i larti katund ku as mani dhe as hardhia nuk lidhin fryt. Më erdhi si ballkoni më i lartë i katundeve të Dibrës për të më zbrit pak nga pak në ballkonet e tjerë, kateve e brezareve të gjithë mbështetur pas Korabit...

Në Bahute që fshihet mes gjelbërimit si foleja e zogut në degë thane...

Në Vranjtin që po të kishte fatin ta shihte e ta mbështillte krahë qafë politika do të ishte katundi i "floririt të bardhë", i gipseve dhe alabastrës, aq me vlerë në ndërtim e art, madje edhe në ushqim...

Në Limjanin e njohur në Dibër për Teqenë Çudibërëse e për klerikët që dinin ta ndanin "qimen" e kanunit mes për mesi...

Tej e tej Ujë e M'ujës", siç quhet nga vendasit, vijnë Dipjaka, Venishti, Sllatina, Palamani, Sllova...

Të gjithë ulur në ballkonet e Korabit, me bjeshkët e Gramës mbi supe, më të begatat dhe të bukurat, me "Bjeshkën e Zonjave kryebjeshkë e njohur për verimet e hanëmeve të sundimtarëve Osmanë, por edhe për kampingun e dy misionarëve anglo-amerikanë gjatë Luftës së Dytë Botërore, Julian Emery dhe Reginald Hibber, në shënimet e të cilëve, tash në libra, lexojmë:

"…Katër ditë në Dibër më kishin mësuar më shumë për thelbin e politikës, se sa të gjitha librat për teorinë e kushtetutës dhe ekonomisë politike që i kisha lexuar në Oksford"

Julian Emery "Kujtime që nuk shlyhen"

"…Unë kam mbaruar universitetin e Oksfordit, por mbarova edhe një universitet të dytë, atë të Dibrës"

Reginald Hibbert " Albania Life"

Më duhet të zbres poshtë, në Sohodoll e Kastriot, në Kandër, Blliçe e Fushë Çidhën, në Palaman, Rrenxë e Shumbat... t'i bije Drinit në Va e të dal të shëtis Maleve të Dibrës, Malit të Muhurrit, Cidhnës, Dardhës, Reçit, të shkoj në Sinë në vendlindjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut... madje të ngjitem në Lashkizë e Qa e të zbresë në Lurë...

Nuk kam këmbë, nuk kam fuqi, kam kujtime që i ruaj të shkruara në letër e në kujtesë...

I kërkoj ndjesë lexuesit për udhëtimin tim "kep më kep". Më ndodh sa herë takoj ndokënd nga treva ime e malli më derdhet e nuk e mbledh dot...

Po ndalem me Sadik Mahën në Limjan, po takohem me prindërit e tij ende në troje të lashta, të pi një kafe e ta pres të marrë me vete një çifteli e një fyell...

Me to, me fyell e çifteli, por edhe me këngët epike dibrane, do të ngjitem në një skenë festivali...

Por këtë më pas...

Ulur "Te kashta", një lokal në qendër të Athinës, toponim të cilën e ka marrë nga karriget e tavolinat prej kashte, po gjerb kafe me të dhe me shokun e tij të "telave të çiftelisë" Iklin nga Mati, dhe po udhëtoj rrugëve të jetës së tij...

Tridhjetë e tre herë Sadik Maha ka kaluar kufirin, maleve e valeve siç thuhet në një këngë të hershme dibrane, maleve e valeve si në legjenda. Sikur të kishte një pikë në librin Giness për ikjet e shqiptarëve nëpër kufij tokësorëve e detarë, dimër e verë, mes shiut e dëborës, mes tallazesh shkumëbardhë detesh, në shënjestra kallashnikovësh, atëherë Sadiku do të ishte kandidat i parë.

Dhe kjo nisi në kapërcyell të viteve '92-'93...

I ri ishte, vetëm 18-19 vjeç. Kishte lënë shkollën e Kastriotit prapa e kishte hedhë mbi shpinë torbën e ikanakut...

Nuk e mbante vendi e kotheren e bukës thatë i duhej ta gjente në truall të huaj, vendeve të panjohura. I duhej për të ushqyer veten, i duhej për tu dhënë vite jete babait dhe nënës që nuk donin dhe nuk duan edhe sot të luajnë nga katundi.

E pyes në se mund të mi përshkruaj udhëtimet..

Nuk kam qejf ti kujtoj, më thotë mendueshëm. Nuk i harroj por nuk dua ti kujtoj. Mund të them vetëm se ishin udhëtime natë e ditë, kalime nga Kapshtica, Leskoviku, Maqedonia... Kam pas 33 hyrje e dalje. Kam qenë shumë fatkeq. Jam zënë shumë herë nga policia...

Herën e fundit, të tridhjetë e tretën, thotë i menduar, kalova nga Maqedonia, nga Gjevgjelia, një shteg ku kanë kaluar qindra bashkëkrahinas. Kjo ka ndodhur në vitin 1998...

Pas kësaj u stabilizua. U lidh edhe me një vajzë nga Lushnja dhe ka një djalë tetë vjeç...

Ishulli i Rodosit ishte një nga qëndresat e para të punës dhe të jetës për të ardhur më pas në Athinë ku edhe sot punon e jeton me familjen e tij... Biografia e punës është e njëjtë me të gjithë...

Punë në ndërtim, njohje e marrje zanatesh, punë në lyerje, bojaxhi por edhe disa vite punë si magazinier derisa magazina do të mbyllej. "Kjo ndodhi, thotë, kur e mësova gjuhën dhe u bëra i besueshëm për çdo gjë nga greku..."

Dhe, tek njihemi, tek udhëtojmë vendeve të bukura të vendlindjes e rrugëve të ashpra të mërgimit, ulemi e bisedën e vendosim mbi dy tela çiftelie, dashuria e veçantë e jetës së tij...

"Çiftelia, më thotë është hobi im, dashuria e jetës sime. I bie çiftelisë dhe fyellit. Në gjak muzika më hyri që i vogël, në atë mjedis të odës dibrane ku pasdarke mblidheshin të mëdhenjtë e flitnin për kohë të largëta, për ngjarje historike e trimëri. Në fund të odës rrinim ne fëmijët, të rinjtë. Rrinim e dëgjonim. Merrnim pa dhënë. Atje ulej e bënte vend edhe çiftelia e fyelli, kënga epike. Idhull për mua ishte xhaxhai, Farizi. Ai ishte mjeshtër i çiftelisë por edhe një mësues i madh për mua.

Bëheshin bashkë me babanë tim dhe i binin njeri fyellit dhe tjetri çiftelisë. Babai im i ka pas gdhendë e vënë në dyzen vetë çiftelitë.

Çiftelinë e fyellin i mësova që në moshë të vogël. I vogël isha kur mora pjesë për herë të parë në veprimtaritë e shkollës tetëvjeçare. Më vonë isha pjesë e grupit artistik të shkollës së mesme të Kastriotit. Shtëpia e kulturës në Limjan ishte vendi im më i dashur...

E pyes se si e solli çiftelinë dhe si u lidh me krijimtarinë në mërgim.

Nga që ka qenë jo hob por ëndërr ime muzika, një ëndërr e madhe nuk iu ndava kurrë. Edhe kur kam qenë ushtar çiftelinë e kam pas me vete. Edhe këtu e kam me vete dhe nuk ndahem prej saj.

E pyes për këngën.

Këndoj, më thotë, shkruaj edhe tekste këngësh dhe i këndoj. Më pëlqejnë këngët epike dibrane, këngët e Qerim Sulës kur këndon për trimërinë dibrane në luftë kundër serbit. E jetoj këngën e Qerim Sulës, madje, kur e këndova në skenën e festivalit të këngës popullore shqiptare që u organizua para disa ditësh në Athinë, i shtova edhe disa lëvizje të mijat, lëvizje që më vinin nga larg e ma mbushnin shpirtin plot. Më pëlqejnë edhe këngët e Arif Vladit dhe këngët kosovare. Janë këngë që i këndoj me dëshirë, me forcën që më buron nga zemra. Këngët e mia i kam hedhur në Yoy torbe, edhe këngë orkestrale.

Tani po përgatitem për të hedhë një këngë të re.

E mbyllim bisedën me ftesën që i është bërë nga Kastriot Lekdushi dhe unë për të qenë pjesë e ansamblit në formësim "Na bashkoi Isoja dhe Çiftelia".

"Është një ftesë e bukur që më bëni. Kjo ka qenë dhe është një ëndërr për mua. E pres me dëshirë të realizohet..."

Meloditë me çifteli në shpirtin dhe zërin e Sadik Mahës shpejt do të zbresin nga Limjani i Dibrës, nga Korabi në Athinë, në ultësirën e brigjeve të Detit Egje...

Ishte një bisedë malli për vendlindjen dhe dashurie për këngën mbi telat e çiftelisë...



Abdurahim Ashiku
Athinë, 14 maj 2013

Komuna Sllovë nderon pas vdekjes me titullin "Qytetar Nderi" intelektualin nga Shumbati

Shkolla e Shumbatit merr emrin **"Hasan Leka"**



Busti i Hasan Lekes ne mjediset e brendshme të shkollës

Nga **SHAQIR SKARRA**

Rrezet e diellit të fund majit sapo kishin rënë mbi majën e Korabit e të gjitha rrugët këmbësore që bien në Shumbat kishin filluar të lëvizin shpejt. Më datë 30 maj në shkollën 9 vjeçare Shumbat do të organizohej një ceremoni disi e veçantë. Askush nuk dinte ma shumë, por lëndina para shkollës u mbush plot para orës 10. Kishin ardhur nga Dypjaka e Venishti, Sllova e Sllatina, Palamani e Trojaku, Lugjaj, Vlesha e Kalla. Të gjithë ishin mbledhur në këtë lëndinë të zhveshur para shkollës dhe ishin bërë bashkë me fëmijët që i gëzoheshin festës së bukur të 1 qershorit, e cila donte dhe dy ditë që të vinte. Pikërisht kjo shkollë, duke filluar nga sot do të ketë një emër, emrin e atij që vite më parë kishte hedhur themelet e arsimit shtatëvjeçar në Shumbat, ai që kishte nxjerrë sa e sa gjenerata, ai, universitari i parë i Shumbatit, ai që ia ngriti lart emrin edhe fshatit në qarqe intelektuale kudo nëpër vendin tonë: Hasan Leka! Po sot emri i pavdekshëm i Hasan Lekës kishte ardhur me mos ikur më nga fshati, me mos ikur më nga shkolla, kishte ardhur për të mbetur i gjallë gjithmonë mes këtyre banorëve të Shumbatit që për të gjithmonë ndjejnë mall.

Një grup intelektualësh nga Shumbati i drejtuan një kërkesë Këshillit Komunal Sllovë para pak kohës dhe kërkuan që emri i Hasan Lekës të përjetohej diku në Shumbat. Dhe më mirë se te shkolla ku mësoi vetë dhe ku nxori sa e sa intelektualë të tjerë, nuk kishte. Këshilli i komunës Sllovë jo vetëm që vendosi të vërë emrin shkollës 9-vjeçare të Shumbatit, por e nderoi Hasan Lekën edhe me titullin e lartë: "Qytetar nderi" i komunës Sllovë.

Kjo shkollë e vogël por me emër tashmë të madh, ka një emër të njohur në qarqet intelektuale dhe shkencore jo vetëm në Dibër por kudo nëpër Shqipëri. Tani ajo ka një vlerë më shumë dhe kanë të drejtë të mburren nxënësit, por edhe mësuesit se shkolla e tyre quhet "Hasan Leka". Xhafer Martini kur e mori vesh për këtë nismë dhe iniciativë u shpreh: Është pak për Hasan Lekën. Duhet një tjetër shkollë, duhet dhe shkolla pedagogjike Peshkopi ta ketë emrin e tij. Aty mësoi Hasani, aty shkëlqeu jo vetëm në mësime, por dhe në sjellje dhe ishte nxënësi model i atyre viteve".

Për të gëzuar tok me shumbatasit kishte ardhur nga Tirana nënkryetari i shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" zoti Musa Rriçku. Hasani ka qenë sekretar i kësaj shoqate deri sa mbylli sytë atë ditë marsi të vitit 2012. Kishin ardhur shumbatas të tjerë me banim në Tiranë, ish nxënës të Hasanit si Rruzhdi Skarra, Festim Rama, Islam Skarra, Ajet Skarra, Ajet Mandrri e shumë të tjerë. Nderuan me pjesëmarrjan e tyre edhe ishdeputeti Sali Shehu, Isuf Miha, Ibrahim Daci si dhe Ahmet Çaushi, Murat Koltraka e Skënder Kuta ish mësues në Shumbat. Kishte ardhur dhe tropojani i mirë Agim Doçi, i cili bëri dhe punën e moderatorit në këtë aktivitet të bukur.

Kryetari i komunës Fatos Mandrri, së bashku me drejtorin e shkollës Afrim Elezi zbuluan pllakën ku shkruhej: "Shkolla 9 vjeçare "Hasan Leka" Shumbat". Duartrokitje nga të gjithë por dhe ndonjë lot i tradhtoi fytyrat e të pranishme . Hasani, ky bir model i Shumbati sapo kishte mbushur vitin që ishte larguar nga jeta. Pastaj të pranishmit u futën të gjithë në korridoret e shkollës ku panë bustin e Hasanit, bërë posaçërisht nga vetë familjarët, dhuratë për shkollën si dhe një ekspozitë të pasur në foto dhe dokumente nga jeta dhe vepra e Hasan Lekës.

Drejtori i shkollës zoti Afrim Elezi përshëndeti të pranishmit: "Vendosja e emrit "Hasan Leka" kësaj shkolle i bën nder jo vetëm shkollës, jo vetëm Shumbatit por gjithë kësaj zone. Ai është një emër i dashur dhe respektuar për të gjithë, është një emër që la gjurmë në historinë e arsimit shqip, shëndetur dhe për t'Ju sjellë juve përshëndetjet më të ngrohta dhe të sinqerta të kryetarit të shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë, Prof.Dr. Nuri Abdiut "Mësues i Popullit" ku shpirtërisht sot edhe ai është këtu me ju si dhe gjithë kryesisë së kësaj shoqate ku sekretar i kësaj shoqate deri sa vdiq ishte bashkëfshatari dhe miku e shoku ynë më i mirë Hasan Leka. Sot në fakt nuk po përjetojmë thjeshtë një emër por po i bëjmë një nder të madh të gjithë fshatit Shumbat dhe më gjerë se Hasani ishte për të gjithë dhe mbeti i të gjithëve. Ai ishte njeriu, intelektuali, krijuesi, shkencëtari, drejtuesi, miku, prindi dhe bashkëshorti model. Tek ai ishin gërshetuar bukur të gjitha tiparet dhe virtytet më të larta njerëzore. Hasan Leka përbën shembullin e parë dhe më të shkëlqyer të intelektualit që u orientua drejt botës së diturisë me një pasion të pashembullt, por dijet e fituara ai kurrë nuk i mbajti pronë vetëm për vete por i transmetonte edhe tek të tjerët. Unë kam pasur fat ta njoh nga afër. Ishte i thjeshtë,







Nënkryetari i Shoqatës LID, Musa Riçku, duke përshëndetur në ceremoninë e vendosjes së emrit të Hasan Lekës shkollës 9-vjeçare të Shumbatit.

jo vetëm në Shumbat, por edhe në shkollën e Sllovës.

Në emrin e kryesisë së shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" përshëndeti nënkryetari i shoqatës zoti Musa Riçku, i cili ndër të tjera tha: "Erdha nga Tirana për t'Ju përi pa përtuar. Dinte të komunikonte mirë dhe bukur me të gjithë dhe i bënte shpejt njerëzit për vete. Sot që është ndarë fizikisht nga ne e them me bindje të plotë se përsëri jeton e do të jetojë në kujtimet tona. Kjo që bëtë sot ju duke i vënë emrin shkolla 9 vjeçare "Hasan Leka" Shumbat nuk i bëni nder vetëm emrit të tij se me emrin dhe veprën e tij duhet të krenohemi të gjithë, por në radhë të parë nderoni gjithë fshatin tuaj"

Nxënësja e klasës së nëntë Dalina Kraj recitoi një poezi kushtuar Hasan Lekës, shkruar posaçërisht nga Naim Plaku: Në letra e shkrime flet e vërteta/ "Në rrjedhë të jetës" / Shkëlqen talenti si diell mbi shkrepa / I Hasan Lekës. / Ti erdhe dhe ike, sikur pranvera / Sjell dallëndyshet, / Ndaj do të mbetesh ti për ngaherë / Lule që s'vyshket. / Ja sot ka ardhur tek shkolla e dashur / Emri i tij, / Ai do të mbetet për herë mësues / Për çdo fëmijë…."

Sherif Herra, i moshuar, me një shkop në dorë e sy të përlotur më afrohet pranë e mes gjithë asaj zallamahie njerëzish më thotë: - Ju lumtë! Sot nuk po nderoni vetëm Hasan Lekën, sot po i bëni nder gjithë fshatit se Hasani ishte dhe mbeti bashkëfshatari ynë më i mirë.

Dhe në fakt kanë të drejtë të krenohen e të mburren gjithë shumbatasit me këtë emër që i vendosin shkollës. Është pikërisht kjo shkollë e vonë, shumë e vonë në krahasim me fshatrat e tjerë të Dibrës që nxori një armatë të tërë intelektualësh në fusha të ndryshme. Arsimi në Shumbat ka nisur vonë. Fill pas çlirimit të vendit u hap dhe e para shkollë fillore në fshat, shkollë i thënçin se një shtëpi e vogël e dhuruar nga një bashkëfshatar për fëmijët e fshatit filloi për shumë vite të plotësonte nevojat për arsim e dije në këtë fshat të madh. Mësuesit e parë ishin Ndoc Çurçia nga Shkodra, më vonë erdhën Mehdi Daci, Alush Abazi, Ivzi Shehu,Mahir Graceni, Sherefedin Beqiri, Rremzi Ndreu, Hajdar Beqiri,Fari Ramadani e Uk Bajrami. Nga kjo shtëpi-shkollë e nisi udhën arsimi në Shumbat e sot e themi me krenari se vërtet Shumbati ka bërë një revolucion në arsim.Janë me qindra e qindra kuadro të dala nga shkolla e Shumbatit, nga ajo shkollë e vogël me shtresë dërrase ku drejtori Hasan Leka i sapo diplomuar bënte punë të dyfishtë jo vetëm me mësuesit që shumica ishin të rinj në moshë por dhe me vetë nxënësit e shumë shpejt shkolla e Shumbatit do radhitej në ato vite një ndër shkollat më të mira në shkallë rrethi. Kuadrot e hershëm që kanë dalë nga shkolla e Shumbatit si Miftar Fana, Adil Leka, nuk kishin mundur të vinin në këtë ceremoni. Por kishin ardhur shumë ish nxënës e sot bërë gjyshër e dalë shumë vite ma parë në pension. Festim Rama, njëri ndër to do të shprehet:

- Pikërisht këtu në këtë shkollë i kemi marrë dijet e para dhe nuk mund ta fshijmë lehtë nga kujtesa emrin e Hasan Lekës, e atij njeriu të mirë që i papërtuar gjithmonë me të gjithë si me nxënësit e mirë ashtu edhe me të dobëtit bëri të mundur sa kohë që shërbeu në Shumbat kjo shkollë të zinte vendin e parë, jo vetëm në mësime por dhe në aktivitete kulturore. Sot shkolla është e bukur, e re, me oborr , e rrethuar por shkollën tonë, aty poshtë digës së liqenit e mbajnë mend të gjithë moshatarët e mi. Ajo ishte e vjetër, me çati që në shumë vende pikonte. Në klasa mësimi bëhej rregullisht e nxënësit nuk bënin zhurmë. Zhurmë po, bënin minjtë poshtë nesh në bodrum të cilët ishin me shumicë. E ne nxënësit ecnim me kujdes mbi dërrasat e kalbura të dyshemesë se rrezik dërrasat thyheshin e binim poshtë.

Kjo ishte shkolla atëherë por niveli i nxënësve ishte vërtet i kënaqshëm dhe po nga ajo shkollë karakatinë e kohës, sot kanë dalë sa e sa kuadro të lartë.

Të pranishmit, në emër të familjes i përshëndeti, vajza e madhe e Hasanit, Dhurata. Në fund në lokalin e madh aty pranë shkollës, pronë e Dritan Herrës dhe e Shemsi Sulejmani familja Leka shtroi një koktej për të gjithë të pranishmit.

(Vijon në faqen 14)

Rruga e Arbërit nr. 85

Bisedë me gazetarin në mërgim Abdurahim Ashiku, në 72 vjetorin e lindjes

intervistë

Kryengritja e shtatorit 1913,

Abdurrahim Ashiku është njëri nga gazetarët e angazhuar në emigracion, që çdo ditë shkruan për problemet e ditës. Jo vetëm problemet e portrete emigrantësh që jetojnë e punojnë në Greqi, por edhe për problemet tonë të përditshme. Ai jeton në Athinë, por me mendje dhe zemër është duke kontribuar për Dibrën dhe më gjerë. Skavica, Rruga e Arbërit, historia, problemet e zhvillimit të bujqësisë dhe turizmit, janë disa nga temat e shkrimeve të tij.

Më 11 maj mbushët 72 vjet jetë...

Zyrtarisht...

Pse zyrtarisht?

Në vëllimin e parë të serialit "Njerëz që i dua", në kopertinën e fundit, kam shkruar: "Linda pesë ditë para Ditës së Verës për tu regjistruar pesë ditë pas Shëngjergjit, më 11 maj 1941..."

Që do të thotë?

Do të thotë se linda në kohë pushtimi të Shqipërisë, në ditë kur po pushtohej Jugosllavia, në një kohë kujtese të dhimbshme për dibranët, kohë që u kujtonte atyre vitin 1913. Vjeshta e Parë e atij viti por edhe "vjeshtat" e tjera deri në vitin 1922, ishte rrënjosur në kujtesën historike si Vjeshtë e fitores së madhe, por edhe si vjeshtë dhe dimër i reprezaljeve të pashoqe, i djegies dhe shkrumbimit të Dibrës, i arratisë së dibranëve drejt Tiranës, Elbasanit etj.

Pse e lidhni këtë me ditëlindjen tuaj?

Thjesht se ato ditë Italia fashiste kishte përqendruar forca të shumta pushtuese për të hyrë në Dibër të Madhe e për të pushtuar Jugosllavinë gjë që e bëri më 6 prill 1941. Dibranët e Luginës së Drinit, ku është edhe Brezhdan-Zdojani im, sa herë kanë ndodhur luftëra me serbët kanë evakuuar në zonat malore, tek miq dhe dashamirët, familjet e tyre, gratë dhe fëmijët, ndërsa vetë janë bashkuar me "Malet" me armë në dorë. Kështu ndodhi që edhe unë, lirek, të ngjitesha në Vranjt ku edhe do të jetoja të gjashtë javët e para të jetës sime.

Mos kjo ju ka ngacmuar për tu bërë thirrje dibranëve në shkrimin tuaj: *Viti i madh i trimërisë dibrane, shtator – 1913* për ti ngritur një përmendore të madhe trimërisë dibrane në dhjetëvjeçarin e dytë të shekullit të kaluar?

Ajo që ju përshkrova është e imja e përjetuar në kohë dhe hapësirë tjetër, por ajo është edhe e jotja, edhe e jona, është djep ku është përkundë historia e trevës sonë. Unë dua që mos ta harrojmë djepin ku jemi përkundë, jo vetëm ne por breza të tërë. Sot më 11 maj 1941në Peshkopi ngrihet në këmbë Elez Isuf Ndreu. Ngrihet në këmbë pikërisht atje ku mori plagën vdekjeprurëse nga arma serbe, tash në duar të një shqiptari. Për mua kjo është domethënëse. Përulem me respekt për Eles Isufin dhe Sufë Xhelilin por po kaq përulem edhe për brezin e ri të familjes Ndreu që e ngritën në këmbë VETË, me dashuri dhe respekt të pakufishëm. Mesazhi i tyre vlen për të gjithë dibranët paraardhësit e të cilëve, siç thotë "Përlindja e Shqipëniës" e Vjeshtës së Parë 1913 ..."ranë dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruanjë emnat e tyne për një kujtim të përjetshëm".

Në "Viti i madh i trimërisë dibrane" flisni për një bllok me shënime të nxjerrë nga gazetat e kohës...

Po, është një bllok, mes ndonja njëqind blloqe shënimesh të jetës sime që i kam me vete këtu në Athinë e që ndonjë ditë do ti zbardh ashtu siç do të zbardh edhe diku tek tremijë negativa me jetë Dibre e dibranësh.

Në atë bllok me rreshta katrore kam shënime të nxjerra nga gazetat e kohës (1908-1920) për Dibrën e në veçanti për atmosferën kryengritëse që zotëronte gjatë verës dhe vjeshtës 1913 mbledhur nga shtypi i kohës. Dëshira ime është që ti kaloja edhe një herë nëpër duar ato gazeta disa shkrime të të cilave do të desha ti fotokopjoj sepse atëherë nuk ishte e mundur dhe në bllokun tim përcillen vetëm me "urdhrin – të kseroksohet". Jam larg se po të isha në Tiranë disa orë në ditë do ti kalojë në bibliotekë.

Vetëm këto...

Kam edhe kujtime të bijve dhe nipërve të të rënëve, mes të cilëve të Myslim Shehut atëherë në moshë madhore, të Haki Shehut, Musa Shehut e të tjerë.

Është interesante se si në atë kohë me mjete komunikimi tepër modeste, nga një fushëbetejë e madhe, u përhapën bëmat e trimërisë dhe qëndresës dibrane me një shpejtësi befasuese. Betejën e dibranëve kundër pushtuesit serb e ndjekin me vëmendje dhe me ankth të madh në Shqipëri dhe larg saj. Ja disa shënime nxjerrë nga "Shqypnia e re" të Hil Mosit dhe Risto Siliqit që dilte në Shkodër dy herë në javë. Elbasan 25. IX., në mbrame...

Dy sahat ma parë erdh nji njeri prej sheshit të luftës, i cili lajmon se anmiku kje shty deri në Pyll të Zezë...Elbasan, 25. IX, natën... Lufta u nis në malësi. Malësorët kryengritës, bashkë me qytetarët e Dibrës, të



dishpruem nga barbarizmat serbe i ranë anmikut dhe e shtynë në tri anë, në Gostivar, në Kurcovë e Strugë...Vlonë, 25. IX., Dibra asht marrun me një luftë të rreptë prej shqiptarëve, të cilët e kanë ndjekun anmikun deri në fushë të Ohrit... Elbasan, 27. IX., natën... Posta jonë e ardhur sonte prej Struget lajmon se në Ohër asht ngrehun qeveria shqiptare...

Përmendët emrat...

Përmenda pasardhësit e Sheh Hysejnit, të dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me rastin e 100 Vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në kujtimet e të birit, Musa Shehut pas vdekjes së babait dhe rikthimit të pushtimit serb, në ikjen apokaliptike të Vjeshtës 1913 kam shënuar: "Atë ditë që u vra, të nesërmen ikëm. Na mori Hazis Shehu me gjithë Esat Karanën me një kalë me kosha. Na vunë tre fëmijë në një kosh dhe tre tjerët në koshin tjetër. Nana në mes... Shtatë vetë hipëm në një kalë... Nana, Habibja, Zyraka, Musai, Hakiu, Tixhja, Myrtja, Nunia..."

Pamje biblike...

Një pamje midis dhjetëramijëra pamjeve që përjetoi Dibra në Vjeshtën e dhimbshme 1913 kur fuqitë e mëdha e varën në çengel dhe e prenë siç pritet berri nga bishti tek gjuha, gjysmën e trupit, kokës dhe shpirtit e lanë nën Serbi e gjysmën në gojën e ujqërve të Shqipërisë . Është i vetmi vend në botë ku qendra gjeografike e një kombi pritet për t'ia dhënë një vendi tjetër...



Qendra gjeografike Kombit!?

Po, Qendra Gjeografike e Kombit, Qendra Gjeografike Shqiptare. Franca, kam lexuar diku se qendër gjeografike të saj ka Verdunin, Shqipëria ka Dibrën. Provoni të hiqni vektorë nga të gjitha skajet e vendeve ku jetojnë shqiptarët në truallin e të parëve. Takimi i tyre bëhet në hapësirën gjeografike të Dibrës, madje, nga matjet e mia modeste, diku midis Dibrës dhe Strugës. Ne na kanë prerë në mënyrën më monstruoze dhe barbare të mundshme.

Mund të vazhdoni me emrat? ...

Po. Mora një emër, emrin e Sheh Hysenit, klerik i teqesë së Vxhenit në Dibër të Madhe, i njohur edhe si Sheh Hysen Kuqi. E mora nga "Përlindja e Shqipëniës" dhe nga shumë gazeta të kohës, madje edhe nga "Historia e Dibrës" e Kristo Frashërit.

Keni të bëni me të?

Unë jo, por gruaja dhe fëmijët e mi po. Natasha- shoqja ime e jetës, e ka gjysh, kurse fëmijët e mi e kanë stërgjysh, ashtu siç e kanë një degëzim i gjerë në familjen e Musa, Haki dhe Myrteza Shehut, ashtu siç e kanë një degëzim i madh i familjeve të Habibes, Zyrakës dhe Nunes, Zeralinjtë e Tiranës dhe Begetë e Durrësit.

***Në thirrjen tuaj "Në vend të një letre të hapur për drejtuesit e bashkive dhe komunave, këtej dhe andej kufirit shqiptaro-shqiptar, DY DIBRAVE..." theksoni:* "Dëshiroj që këto radhë ti lexojnë drejtuesit vendorë në Dibër të Madhe, Strugë, Gostivar etj. ku është shkruar në kujtesën njerëzore historia e kohës, dëshiroj që drejtuesit e bashkisë së Peshkopisë dhe Bulqizës dhe drejtuesit e komunave nga Golloborda në Luzni, Reç, Dardhë, Lurë, Sllovë, Kala të Dodës etj. të ulen e të programojnë përkujtimin e 100 Vjetorit të fitores së Dibrës me një madhështi që nuk është parë kurrë." ...Pse kjo thirrje?**

Nuk thërras, megjithëse do të desha të bërtas sa kam në kokë dhe në shpirt. Sot mbush ditët e vitit të 72-të të jetës time. Nga këto 17 vjet po i kaloj larg Dibrës dhe vendeve të mija të dashura. Prej korrikut 1976 jam në Athinë, mërgimtar në kuptimin e plotë të jetës sime. Më mungon Dibra dhe mungesën mundohem ta plotësoj duke rrëmuar në kujtime, në "blloqet" e shkruara, në librat me autorë dibranë që zënë dy rafte të bibliotekës time ikanake. Malli si mengene më kap aortat e zemrës sikur donë të më ndalojë rrjedhën e gjakut. Shkruaj për Dibrën dhe dibranët dhe çlirohem paksa nga mengeneja e mallit. Kam shkruar një libër për Dibrën, "Po Dibrës! Jo Skavicës". Kam në zarf gati një libër të ri me jetë dibranësh në mërgim. Takoj dibranë në rrugët e Athinës, në qytete e ishuj të Greqisë dhe kënaqem pa masë kur zërat e tyre hynë në diktofonin tim e zbardhen në shkrime për "Plus Gazeta Athina" , "Rruga e Arbërit dhe gazeta në internet ndër të cilat "Kritika" e dibranit përtej oqeanit Atlantik Agron Cami dhe "Fjala e lirë" e "dibranit në shpirt" Fatmir Terziut në Londër. Të shkruarit, të komunikuarit me dibranët më mban gjallë.

Kthehemi tek "thirrja" ime. Këtu ku tash jetoj më bën përshtypje të shkruarit e ngjarjeve historike kudo që shkon, kudo që hedh sytë. Të shkruara në tabela rrugore, në komplekse skulpturore, në buste e monumente, ato u flasin kalimtarëve me një lloj libri të veçantë historie, libër i shkruar në natyrë . Është një histori e tërë e shkruar "in memorium" siç thotë latini apo "mnimonio" siç thotë greku. Më pëlqen.

Le të vijmë në Dibër. Nuk them se Dibrës i mungojnë lapidarët dhe përmendoret historike. Ka për Skënderbeun, për ngjarje historike, për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ka edhe për kohën e re që erdhi pas diktaturës.

Unë në 100 vjetorin e Kryengritjes Popullore të Dibrës kundër pushtimit serb dua që historia e kësaj ngjarjeje të madhe të shkruhet me një sërë "kumtesash " në gurë, mermer, beton, me buste dhe monumente por edhe thjesht me një tabelë rrugore. Le të udhëtojmë nga Peshkopia në Kala të Dodës ku, siç kam lexuar, rruga është asfaltuar deri në Kukës.

Në 100 vjetorin e Kryengritjes Popullore të Dibrës kundër pushtimit serb dua që historia e kësaj ngjarjeje të madhe të shkruhet me një sërë "kumtesash " në gurë, mermer, beton, me buste dhe monumente por edhe thjesht me një tabelë rrugore.

cyan magenta yellow black

aktualitet

Të përmbytësh Dibrën për hir të disa mijëra kilovat - orë energji, kur ata i ke disa herë më shumë në burimet e saj malore nga Stebleva në Reç e nga Qafë Murra në Korab, është krim.

djepi ku u përkund trimëria dibrane

Kur ngjitesh të përpjetës së Rrenxit do të ishte bukur të shkruhej se pas një kilometri do të shikoni një përkujtimore për "Luftën e Kaushit" kundër serbëve dhe majë asaj kodre që hap një hapësirë të jashtëzakonshme bukurie që të fton në meditime trimërie të shikoje një kompleks përkujtimor që të shkruan me hieroglefet e veta kuptimplote kohën...

Para se të hyjsh në Sllovë, një tabelë rrugore do të na ftonte të luanim vendit, siç luajnë njerëzit kur kalojnë përpara një teqeje, në nderim të Eles Isufit, Sufë Xhelilit dhe trimave të fisit të Ndreve të përkujtuar në një varrezë të bardhë nga pasardhësit e tyre. Më poshtë, në Vleshë, të paralajmërohej se pas njëqind metrash do të kishte një bust të Sheh Shazumanit dhe të Abdyl Frashërit në udhëtimin e tij historik drejt asaj ngjarjeje të madhe që në histori ka hyrë si "Lidhja Shqiptare e Prizrenit". Pak më tej, kur pasagjerit ti hapet lugina e Veleshicës dhe Korabi madhështor, të paralajmërohet se pas dy kilometrash, në Ceren, ka obelisk të madh që në perëndim i zë diellin Korabit, obelisk ku janë gdhendur 36 cerenas të masakruar nga serbi në Vjeshtë 1913 dhe të varrosur në kodër, në atë që populli e quan "Vorret e shahitëve", e ku kalorësit u zbresin kuajve në shenjë respekti tash e 100 vjet, ku njerëzit si në paradë kthejnë kokën në "nderim majtas" apo në "nderim djathtas" e dasmorët ndalojnë këngën e gjëmimin e daulleve.

Nuk e di por kur i shkruaj këto radhë dhe ëndërroj kompleksin përkujtimor me varre të rindërtuara e me emra të njerëzve që dhanë jetën në një , kur i shoh me mendje njerëzit të ngrihen nga ndenjësja e autobusit në shenjë nderimi dhe respekti, më ngjethen mishtë.

Këto do të thosha për udhëtarët nesër rrugës së re nëpër Steblevë të udhëtojnë me dëshmitë e Z. Kenedi që ka shkuar për të ndarë ndihma në Gollobordë e ku është përballur me krime serbe nga më të pabesueshmet e që i kanë marrë mendjen. (Shih nr.4 dhe nr.5 të "Përlindjes së Shqipëniës" të 11/24 dhe 15/28 kallnuerit 1914)... Këto do të thosha edhe në qoftë se hyn në Dibër nga ana e Qafë Murrës, mbi kreshtat e maleve të të cilave janë edhe sot gjurmët e istikameve të qëndresës shqiptare kundër serbit....

Këto do të thosha edhe në Lurë kur përpara meje do të dilte silueta e Xhemile Gegës varrosur e gjallë... Këtë do të thosha edhe në qoftë se do të udhëtoja "Rrugës së Rinisë" e do të ndaloja në Sukë të Arrasit ku të pushoja për ndonjë orë në kompleksin e madh historik që lidh Besëlidhjen e dibranëve me Skënderbeun kundër pushtuesit Osman dhe besëlidhjen e dibranëve kundër pushtuesit serb, "Qeverinë e Arrasit"... Këtë do të thosha edhe po të ngjitesha mbi qytetin e Dibrës së Madhe dhe në sfondin e një kujtese historike për kryengritjen e

> "Rruga e Dibrës është rruga e lotit të rrjedhur krua, e dhimbjes më të madhe historike të shqiptarëve. Ajo duhet të ishte hapur e para dhe mbi të gjitha për të tharë paksa lotët e dy Dibrave, e tej e tej lotët e kombit."



shtatorit 1913, përpara lapidarit të "Të Pestëve" – Hysenit, Sadullahit, Ramizit, Karafilit dhe Numanit" të meditoja se sa e madhe është qëndresa e dibranëve në histori dhe çfarë borxhesh i ka brezi im që ta shkruajë jo vetëm në libra por edhe në natyrë këtë që trimëri të veçantë shqiptare.

Pse thoni e veçantë?

Sepse është e veçantë, unike në historinë e vet. Kryengritja dhe fitorja e dibranëve në vjeshtën e vitit 1913, por edhe në vitet pasardhëse u organizua nga vetë dibranët dhe luftëtarë me armë në dorë ishin vetëm dibranët. Dhe ndodhte kjo kur një batalion dibranësh ishte mbërthyer në një betejë për jetë apo vdekje me shkodranët në qëndresën e njohur për të mos ia dhënë Shkodrën Malit të Zi.

Dibranët kanë varre në të gjitha betejat e mëdha historike shqiptare kundër pushtuesve, në betejën e Lumës, betejën e Shkodrës, Luftën e Vlorës... Në Shkodër kam dëgjuar se ka një varrezë dibranësh që ranë në luftë për mbrojtjen e saj nga sllavo-malazestë. Më vjen keq që atje nuk ka një monument, një përkujtimore për ata që ranë për mbrojtjen e kufijve të asaj cope Shqipërie të prerë nga Londra '13 e që ishte vënë në dhëmbë ujqërish nga toka dhe deti për të rrëmbyer të tjera copa e për ta shqyer nga harta e historisë. Qëndresa dibrane është për tu shkruar me germa të arta.

Po për "Rrugën e Arbërit" çfarë do të shtonit?

Më vjen mirë që për të është hartuar një peticion dhe u bëhet thirrje dibranëve dhe shqiptarëve që ta nënshkruajnë atë. Rrugën e Arbërit e kam në kujtesën më të hershme të jetës sime. E kam në përshkrimet e babait tim që si shumë dibranë, edhe në fund të viteve '40-të, shkonin në Tiranë për një thes kripë e për ndonjë plaçkë për ne fëmijët. Në fotografinë e parë të jetës sime jam i veshur me një pallto të shkurtë sjellë nga ato udhëtime. Në kujtesë më ka mbetur gozhdë Shkalla e Tujanit, shkallë ku kanë humbur jetë njerëzish dhe kuaj e mushka të ngarkuara me mall kanë rënë në lumë për shkak të vështirësive të kalimit. I kam kërkuar pamjet e mbjella në kujtesë kur kam kaluar nëpër të në verë të vitit 1961, atëherë e hapur për kalimin e makinave deri në lokalitetin e Shupalit. Dua të kaloj asaj rruge (mbase jeta ime e arrin atë ditë) me dëshirën që gjatë saj të jetë shkruar me "hieroglifët" e artit skulptural, drama dhe tragjedia e udhëtimit apokaliptik të dibranëve të dëbuar nga serbi në vjeshtën dhe dimrin më të egër të jetës së tyre, atë të viteve 1913 - 1914, kur u krijua në Tiranë ajo që u quajt, dhe quhet edhe sot, "Lagjja Dibrane" e ku ka një rrugë që quhet "Rruga e Dibrës", rrugë që në ndryshim me rrugët tjera të Tiranës (Rruga e Durrësit, Rruga e Kavajës, Rruga e Elbasanit) të çon vetëm deri te ish Kinostudjoja.

Rruga e Dibrës është rruga e lotit të rrjedhur krua, e dhimbjes më të madhe historike të shqiptarëve. Ajo duhet të ishte hapur e para dhe mbi të gjitha për të tharë paksa lotët e Dy Dibrave, e tej e tej lotët e kombit.

Përmendët më lart librin "Po Dibrës! Jo Skavicës"...

Po. E kam shkruar atë libër me dëshirë dhe me mall, me protestën e një qytetari të thjeshtë.

Të përmbytësh Dibrën për hir të disa mijëra kilovat - orë energji, kur ata i ke disa herë më shumë në burimet e saj malore nga Stebleva në Reç e nga Qafë Murra në Korab, është krim. Është dhuna më e egër që mund ti bëhet një treve, dhunë ekonomike, një shpërngulje disa herë më e madhe se ajo e vjeshtë-dimrit 1913-1914 e dibranëve të Dibrës së Madhe dhe rrethinave, një ikje biblike në kohë moderne, jo pak por mbi 40 mijë banorë autoktonë historikë, ikje pa kthim, një mbytje e historisë së lavdishme të birit të Dibrës Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, të 18 betejave fitimtare të tij në teatrin natyror dibran, një fshirje e trimërisë dibrane që lidhet me mbrojtjen e Dibrës nga serbi.

Një mbytje e Luginës më të bukur të vendit, luginës së Drinit të zi, si me një, dy apo tri diga, i shkon për shtat vetëm Serbisë, "fazlliçëve" të kohës sonë. Të mbytësh Dibrën është ti marrësh frymën për së gjalli historisë dhe trimërisë në shekuj, ta "mbytësh atë në Dri", siç thuhet kur bëhet fjalë për kob. Unë kështu e kuptoj dhe kështu do ta jetoj. Unë e dua Dibrën ashtu siç e ka krijuar Zoti.

Flisni me kompetenca historiani...

Jo, flas me dëshirën shpirtërore të një dibrani të thjeshtë. Unë nuk jam historian dhe kultura ime historike ka përfunduar në vitin 1955 me mbarimin e shkollës shtatëvjeçare.

Kësaj kulture unë me vullnet e dëshirë i kam kushtuar dhe i kushtoj leximet e përditshme edhe në mërgim. Ju thash më sipër se në bibliotekën time në mërgim kam dy rafte të plota me libra historikë të autorëve dibranë dhe autorëve të tjerë dashamirës të Dibrës. Më vjen keq që nuk e sjell dot bibliotekën, të vetmen pasuri të jetës tash mbetur në Tiranë.

Ka ndonjë gjë që veçoni në mallin tuaj për vendlindjen?

Ka shumë, aq shumë sa nuk i radhis dot por midis tyre do të radhis mallin për "Gështenjat e Nanës", zabelin e familjes sime gështenjat e të cilit na e kanë mbajtur jetën gjallë ne, shtatë fëmijëve të Hajredin dhe Defe Ashikut, në vitet më të vështira, kur edhe 120 lekë nuk e gjeje kilen e misrit. "Gështenjat e Nanës" ishin edhe frutë, edhe bukë, edhe lekë për të blerë kripë e vajguri...

Pse "Gështenjat e Nanës"?

Ka një histori që sa herë e kujtoj më shkakton dënesë, lot krua i uji i kroit të ftohtë të Sulnarit në kufirin lindor të Zabelit. Atë Zabel Nana jonë e mirë e bleu duke hequr vathët e nusërisë, e bleu kur unë isha 2-3 vjeç dhe vendi ishte nën zinë e pushtimit fashist, e bleu për të na mbajtur në këmbë. Mos e vazhdojmë më tej...

Cili është mesazhi juaj në ditëlindjen zyrtare siç e quani 11 majin?

Moshatarëve të mi u bëj thirrje të shkruajnë kujtimet e tyre, ti shkruajnë në fletore, blloqe shënimesh, faqesh kompjuterike, ku të munden. Jemi një brez që u arsimuam përmes vështirësish, në një mjedis kur nëntëdhjetë për qind e popullit ishte analfabet. Brezhdan - Zdojani im shquhet në histori si Oxhak, si vendlindja me bëmat e Isuf Karasanit, Bedrije Karasanit e të tjerë. Më vjen keq që nuk shquhet për hapjen e shkollës shqipe, shkollë që u hap vetëm në vitet tridhjetë e që pak dritë shpërndau. Në vitin 1954 unë mora rrugën për të mësuar në shkollën shtatëvjeçare të Peshkopisë.

Atë vit nga fshati ynë prej 300 shtëpish vazhdonim shkollën tre vetë, Abdulla Hakorja në klasë të gjashtë dhe unë e Islam Sefullai në klasë të pestë. Më vonë erdhën edhe të tjerë, një nga një si rruazat në tespihe për të vërshuar masivisht në vitet tetëdhjetë. Unë, nga vëzhgimet e mia, i bie që të jem i pari njeri me arsim universitar të rregullt në fshatin tim të lindjes....

Ne në historinë tonë të kaluar, ndonëse trashëguam shumë njerëz të shpatës e të pushkës trashëguam shumë pak njerëz të penës. Moshatarët e mi, brezi i ri që po rritet i shkolluar dhe me dije shumëgjuhësore, duhet të shkruaj për Dibrën dhe dibranët në të gjitha kohët, të rrëmojë e kërkojë në arkiva, në vend e kudo ku ndodhet në botë. Të shkruajnë sepse vetëm nga të shkruarat bëhet historia. Të shkruajmë që historianët ta bëjnë saktë dhe me një pjesëmarrje të gjerë historinë e lavdishme të Dibrës dhe dibranëve.

Meraku juaj i ditës?

Të kërkoj në raftet e bibliotekave të Athinës Dibrën, zërin e saj, veçanërisht në vitet e dekadës së dytë të shekullit XX.

Faleminderit dhe ju urojmë jetë të gjatë e penë të mprehtë në njëqind vitet e ardhshme të jetës suaj!

Nderi është i Dibrës dhe i dibranëve me penë në dorë jo në njëqind por në qindrat e viteve që ata do të jetojnë me historinë dhe bëmat e të parëve të tyre në kujtesën historike të shkruar dhe të skalitur mbi male fizikë.

Bisedoi me email: **B.Karoshi**

cyan magenta yellow black

Baba Jashar Krena ishte një këshillues shumë i mirë, një pajtues shumë i mirë i gjaqeve, një gjykatës hyjnor shumë i mirë, një vënës i zakoneve të mira, një luftëtar i paepur kundër së keqes.

portret



Baba Jashar Krena (Shëngjergji), një jetë në shërbim të Fesë dhe Atdheut

Nga **DESTAN RAMA**

VENDLINDJA

Sopoti është një fshat i bukur i vendosur në një cep të Penestias në Grykën e Madhe, Komuna Zerqan, rrethi Bulqizë. Relievi i fshatit vjen si me kodra – kodra të veshura me gjelbërim e pemë frutore, të cilat i japin atij një bukuri të rrallë, që kur e sheh me syrin e pushkës në vijë horizontale të duket si valët e grurit në flladin pranveror. Ky fshat njihet disa shekuj me parë, biles edhe përpara defterit emëror turk të vitit 1467. Ka qenë fqinji verior i fshatit "Gropa", fshati i lindjes së Pal Gropës. Sopoti ka qenë dhe mbetet vendi i mikpritjes dhe i bujarisë së pashteruar. Këtu kanë pushuar dhe janë ofruar shumë burra me emër e shenjtore me fuqi hyjnore. Pikërisht në këtë fshat, në një familje bektashiane lindi në vitin 1853 Baba Jashar Krena.

DJALI QË LINDI ME EMËR

I ati i tij, Selim Krena, nuk kishte fëmijë. Një natë Babë Sufa i vjetër i Bllacës, vajti për darkë tek Selim Krena në Sopot. Në muhabet e sipër iu lutën disa njerëz që ndodheshin aty që Babë Sufa të jepte një nafëz Selimit. Baba Sufa tha: "Do t'i lutemi Zotit që t'i japë një djalë këtij". Aty ndodhej edhe një baba tjetër. Të gjithë së bashku iu luten Zotit dhe emrin ia vunë Jashar dhe i thanë Selimit: "Ty Zoti do të të falë një djalë, por nuk do të jetë për ty, por për xhihanin (njerëzimin)".

Me të vërtetë, pas 9 muajve lindi Jashar Krena.Qysh në fëmijëri, ai ndiqte me kureshtje klerikë e myhybe, që vinin herë pas here në shtëpinë e tij. Gëzohej shumë kur e linin të hynte në odën e miqve. Ulej në gjunjë si burrat dhe dëgjonte me kënaqësi nefeset bektashiane. I edukuar me këtë frymë, nisi të ëndërronte për të vajtur në një teqe.

Në moshën 12-13 vjeçare shkoi në Stamboll tek kushëriri i vet Qazim Zhama si emigrant (kurbetçi). Aty punoi dhe mori mësime fetare për tre vjet. Mbas tre viteve u kthye në shtëpi, në Sopot. Aty gjeti nënën dhe dy motrat, ndërsa i ati kishte ndërruar jetë. Ndenji në shtëpi 5-6 muaj.

NË TEQEN E KRUJËS

La nënën dhe dy motrat dhe shkoi në Teqenë e Krujës për të bërë shërbim si hyzmeqar. Atëherë ishte në moshën 16-17 vjeçare. Mbas disa muajsh bëri lutjen për dervish. Haxhi Hysen, Babai i Krujës ia pranoi lutjen. E tërhoqi nga hyzmeqaret dhe i caktoi shërbimin e ndihmës furxhiut në teqe. Rregullat e bektashizmit ishin që Dervishët të punojnë. Jashar Krena shkonte me të parin e vet për dru, sepse do të sigurohej teqja për drutë e furrës. Ky ishte djalë i palodhur, kishte dashuri të madhe për bektashizmin, i dhimbsej shumë malli i teqes. Shpejt ai e kuptoi se teqja është shtëpia e tij. Nga të gjitha këta Haxhi Hysen Babai u kënaq. Sipas rregullave të bektashizmit e bëri myhyb. Mbas tri vitesh e bëri Dervish dhe meqë ky ishte djalë i sjellshëm, e caktoi shërbyes pranë vetes. Ishte i etur për dituri prandaj shpesh i afrohej babait dhe, pak si me turp i drejtonte ndonjë pyetje. Babai i shpjegonte plot gjëra dhe ai i thithte me endje.

Në Teqen e Krujës Dervish Jashar Krena fitoi shume dije, fitoi edhe një përvojë shumë të vyer dhe të dyja së bashku e nxorën atë faqebardhe.

BABA NË TEQEN E MARTANESHIT

Populli i Dibrës, Martaneshit e Kostenjës, dërguan një komision në teqen e Krujës për të kërkuar një Baba për në teqen e Martaneshit. Baba Hyseni e priti komisionin shumë mirë. Mbas disa orëve ata i shfaqën kërkesën se përse kishin ardhur. Babai u tha: dilni jashtë e diskutoni se cilin dervish doni, se unë kam këtu shumë dervishë. Ata dolën jashtë dhe nisën të bisedonin. Pati kundërshtime në mes të komisionit. Martaneshi e Kostenja kërkonin të merrnin Dervish Sulejmanin, ndërsa Dibra kërkonin Dervish Jashar Krenen.

Kështu vazhduan diskutimet për tri ditë. Në krye të tri ditëve u bashkuan dhe ia lanë në dorë Haxhi Hysen Babait. Babai mendoi që të dy palët të dalin të kënaqur nga teqja. Dervishët aty bënin shërbim, mësonin mësimet fetare, por edhe punonin: në duhan, kopshtije, lule, shkonin për dru për teqenë.

Për këtë Babai u tha dervishëve: "Nesër në mëngjes ejani në dhomën time". Ai e dinte se dervishët në mëngjes shkonin për dru e kur vinin nga drutë vazhdonin shërbimet e tjera të caktuara.

Komisioni u ngrit herët. Vajtën në dhomën e Babait, të cilin e gjeten të ngritur. Babai filloi muhabetin pa u treguar qëllimin. Mbas disa minutash në oborrin e teqes u dëgjua një krismë drush. Babai u tha anëtarëve të komisionit: - Ky dervish qe ka ardhë i pari këtu në teqe, duhet të jetë Babai i juaj nga çdo krah qofte.

Komisioni e pranoi këtë propozim të Babait. Ai doli jashtë dhe panë se ishte Jashar Krena. Babai i tha Dervish Jasharit: "Bëhu gati se do të shkosh Baba në Teqenë e Martaneshit".

Dervishi filloi të qante dhe iu lut babait: "Të lutem shumë or Baba, se unë nuk jam i zoti ta kryej një detyrë aq të rëndë, mbasi unë jam i ri në moshë dhe akoma nuk kam mësuar ashtu si duhet. Nuk mund të ndahem nga dashuria jote dhe nuk kam asnjë grosh për çështje muhabeti".

Babai iu përgjigj: "Kjo është puna ime e ti duhet të shkosh se Haxhi Bektashi nuk të lë të turpërohesh".

Kështu, me 17 prill 1877, iu dhe dekreti dhe u nis për në Martanesh. Teqen e gjeti në gjendje të kënaqshme. Në fillim u mor me disa çështje të karakterit organizativ, brenda e jashtë Teqes, duke vëne theksin tek marrëdhëniet e saj me njerëzit myhybe e dashamirës. Më pas u interesua për të njohur fshatrat, krahinat, gjendjen ekonomike të banoreve, problemet shoqërore me të mirat dhe vështirësitë e tyre, zakonet, e doket, traditat, etj.

Baba Jashari u dha rëndësi lidhjeve me Teqet e tjera. Përveç Krujës dhe Elbasanit, i shtriu marrëdhëniet edhe me Teqet e Kërçovës, e të Tetovës, po edhe të Shqipërisë së jugut; me atë të Frashërit, Gjirokastrës, Skraparit, Korçës etj.

VEPRIMTARIA ATDHETARE

Baba Jashari synonte të përfshihej me gjerë edhe në veprimtaritë për çështjen kombëtare. U njoh me personalitete të shquara: Aqif Pashë Elbasnin, Abdyl Frashërin, Baba Meleq Shemberdhenjin, Hasan Prishtinën, Bajram Currin e shumë të tjerë. Ai ishte për bashkimin e kombit. Vetëm një komb i bashkuar, do të dijë të përballoje furinë e egër të armiqve.

Siç dihet, në vitin 1878 atdhetarizmi shënoi një kulm zhvillimi, që u kurorëzua me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Në këtë ngjarje u përfshi edhe teqja nën udhëheqjen e Baba Jasharit. Nuk qe e rastit që figura kryesore e lidhjes, Abdyl Frashëri, qëndroi edhe në Teqen e Martaneshit.

Duke iu drejtuar bektashinjve të Martaneshit Abdyl Frashëri tha: "O burra të urtë dhe bujarë të Martaneshit. Në këtë vend të bukur e të bekuem nga Ballem Sulltani, po shoh një copë të ndezum të Shqipnisë për liri e mbarësi kombëtare. Dëshira ma thotë, të rri ca ditë këtu e të kënaqem me ju, por koha na thërret të ecim, të punojmë e te luftojmë për fatet e kombit. Nesër unë dhe Babai do të nisemi për në Prizren. Atje do të bëhet një Kuvend i Madh mbarëkombëtarë për hallet e vendit. Turqit na kanë pushtuar, por kanë dalë edhe ca ujqër të tjerë përreth që duen të marrin nga një copë prej Trojeve tona; prandaj duhet t'i dalim zot vatanit".*

Një kapitull të shkëlqyer për punën e Baba Jasharit dhe të tjerëve përbën hapja e shkollave shqipe në Gryken e Madhe dhe Martanesh. Në këtë vazhde ai mbante lidhje me Hoxhë Muglicën nga Okshtuni, Sheh Sulën e Mehmet Hankun nga Zerqani, Hoxhë Vokën, Dervish Himën e të tjerë nga Dibra, që përfshiheshin për të sjellë libra në gjuhën shqipe. Në vitin 1895 Baba Meleq Shemberdhenji solli abetaren e shoqërisë "Drita" në Zerqan, Martanesh e Krahina të tjera me të cilat njerëzit filluan të mësonin fshehurazi. Baba Jashari zgjidhte pjesë nga këto libra dhe ua lexonte dëgjuesve, ndërsa vargjet e Naimit këndoheshin në festë.

Baba Jashar Krena ishte një këshillues shumë i mirë, një pajtues shumë i mirë i gjaqeve, një gjykatës hyjnor shumë i mirë, një vënës i zakoneve të mira, një luftëtar i paepur kundër së keqes.

Baba Jashar Krena ndërroi jetë ditën e shtunë më 6 Maj 1910, ditën e shëngjergjit, ndaj u quajt edhe Baba Shëngjergji. Vepra e tij do të mbetet e paharruar në breza, veçanërisht në Gryken e Madhe dhe Martanesh.

REFERENCAT:

- Histori e baballarëve të Teqesë së Martaneshit - Baba Selim R.Kaliçani

- Drita e bekuar rrezaton... Besim vëllazërim, urtësi, mirësi. - Z. Sula, Q. Lila, A. Biçaku

- Folës popullorë: Baba Ismail Jangulli, Isa Kola, Ibrahim Kika, Mexhit Kola, Seit Zogu etj.

Shkolla e Shumbatit merr emrin **"Hasan Leka"**

(Vijon nga faqja 11)

Në sfond ishte vendosur një monitor i madh ku të pranishmit shikonin një montazh të bukur nga jeta dhe aktivitetet e Hasanit ku pasqyroheshin botimet e tij, promovimi i librit "Në rrjedhë të jetës", promovimi i librit "Shumbati, histori dhe tradita" si dhe aktiviteti që u zhvillua nga shumbatasit tek liqeni artificial me iniciativë të Hasanit.

Orët kalonin e njerëzit nuk po shkëputeshin me njëri tjetrin. Një ditë kjo vërtet që i bëri bashkë të gjithë shumbatasit, një ditë kjo që ishte pikërisht ideator Hasan Leka që të njihej si ditë e Shumbatit, e kështu filloi vetëm disa vite në Tiranë të praktikohej çdo




Nxënës të shkollës 9-vjeçare "Hasan Leka", Shumbat

të dielë të parë të muajt maj:

- Le ta quajmë sot ditë e Shumbatit - thotë Nuhi Murati - le të mbetet në histori për ne. Është Hasan leka ai që e ideoi një ditë të tillë dhe ja prapë emri i Hasan Lekës na bëri bashkë. Vonë, tepër vonë, kur dielli filloi të humbasë në horizont njerëzit filluan të largohen. Në fillim fëmijët të gëzuar për emrin që mbart shkolla e tyre.

Më në fund realizuam një dëshirë të gjithë intelektualëve shumbatas. Emrin e universitarit të parë të fshatit e përjetuam gjithmonë. Ai emër do t'i shërbejë jo vetëm shkollës, jo vetëm nxënësve, që mësojnë aty por gjithë fshatit, brezave të sotëm dhe atyre që do të vijnë.

portret



Qazim Përnezha.
Foto arkiv Pajtim Përnezha

Qazim Përnezha, "dizeni" i Çidhnës

"Kur nuk di se nga vjen, nuk di se kush je dhe nuk mund ta gjesh se kush mund të bëhesh" - Qazim Përnezha.

Nga **RRUZHDI BITRI**

Brezit të ri do t'i mungonte Lala Qazim me këshillat me vlerë dhe fjalën e mençur, fshatit do t'i mungonte njeriu i zgjidhjeve, Çidhnës do t'i mungonte alegoria e fjala e tij e goditur në mexhelise me peshë...

Një emër i njohur jo vetëm në Çidhën, por dhe jashtë saj, një emër që më ka ngacmuar herët për të shkruar diçka, se në fakt nuk është shkruar e folur kurrë më parë, por jo se është i harruar në popull. Qazim Përnezha ose "dizeni" i Çidhnës, siç e kanë quajtur, me fjalën e tij të mençur për më shumë se gjysmë shekulli u bë njeriu më i ditur jo vetëm në Çidhën, por me plot gojën mund ta quajmë si "Sokrati i Dibrës", "filozofi i Odës dibrane". Qazimi u lind në Fushë-Alie, në vitin 1912, në një familje të varfër, por që puna, fjala dhe pushka, ishin krenaria e familjes, fisit dhe gjithë zonës. Mbetet jetim bashkë me vë-llanë e tij më të vogël, Dikën, pasi babai u vdiq në Anadollin e largët. Përballja me hallet e mëdha të jetës dhe vështirësitë e përgjegjësitë që i ranë mbi supe në moshë të re bënë që karakteri i fortë burrëror i Qazim Përnezhës të forcohej para kohe.

Një ndihmë të madhe dhe një mbështetje, pa dyshim, do ta kishte tek dajat dhe fisi i njohur i tij. Duke qenë shpesh i pranishëm në odat dibrane, i dhanë atij edhe nivelin e parë të formimit nga "shkolla e Dibrës". Rininë e kaloi në punët e përditshme të fshatit. Pavarësisht kushteve të tij familjare, arriti të kuptojë se shkollimi minimal ishte domosdoshmëri. Fatin, që shkolla e Kastriotit ishte vatra e parë e dijeve, ai e shfrytëzoi si mundësi. Kështu, ndoqi klasën e parë dhe të dytë në vitet 1928-1929 dhe për arsye familjare e ndërpreu shkollën, por së fundi dhe me kaq pak shkollë ai futej tek njerëzit e arsimuar të fshatit.

Në vitin 1937 Qazimi fillon punë si xhandar, punë kjo që në ato vite për shumë malësor ishte e vetmja që mund të kishin të bënin me mbretin. Në vitet 1938-1939 Qazimi ndjek mësimet në shkollën e Kavajës.

Në vitin 1940 ndjek një kurs të përshpejtuar xhandarmërie. Si xhandar dhe oficer poste punoi në zonat e Librazhdit dhe Elbasanit. Pikërisht në këtë periudhë njohu dhe bashkëpunoi ngushtë me Baba Faja Martaneshin. Miqësia me të do të shërbente vite më vonë.

Në vitin 1943 përfundimisht e braktisi shërbimin dhe kthehet në vendlindje. Tashmë, i pjekur dhe formuar do të ishte shumë i vetëdijshëm për ato që do të bënte në vitet e mëvonshme.

Zjarri i luftës në vitin 1944 e gjen Qazim Përnezhën të përfshirë në rezistencën nacionaliste. Nuk e shohim të jetë në fakt palë me luftën e madhe që u bë midis forcave partizane dhe antikomuniste të drejtuara nga Halil Alia. Ai e dinte fare mirë se kjo ishte një luftë e mirëfilltë civile. Në këto vite, një masakër e vërtetë përfshiu veçanërisht fshatrat Fushë-Alie, Blliçe dhe Laçes. Qazim Përnezha e dinte fare mirë se kjo luftë ishte si pasojë e marrëdhënieve midis dyerve të para të Dibrës së Poshtme, Alisë, Ndreut dhe Kaloshit, aleanca këto që, në fakt, sollën persekutimin e gjatë komunist, veçanërisht në këto fshatra. Për herë të parë, si luftë civile në lëmin e historisë e ka trajtuar poeti dhe shkrimtari disident çidhnak Bajram Hyseni (Kovaçi). Në mbarim të kësaj lufte Qazim Përnezhën e gjejmë me këshilltarët e parë të fshatit Fushë-Alie. Kur forcat partizane do të vinin me lista të gatshme për pushkatime e burgosje, ai do të shpëtonte falë lidhjes së tij të mëparshme me Baba Faja Martaneshin. Në vitet më vonë Qazimi punon në zona të ndryshme si agjent grumbullimi.

Duke qenë vazhdimisht në marrëdhënie me njerëz e shkresa të shumta, ai mësoi shumë mirë të dëgjonte, të fliste dhe heshtte kur ishte nevoja. Kjo punë dhe këto marrëdhënie, sidomos me njerëzit, ia rritën edhe më shumë vlerat dhe ia mprehën më shumë gjykimin. Tashmë ai kuptoi mirë se kodi i bisedës është pronë e njerëzve të zgjuar.

Dita-ditës fjala e tij në odat e Çidhnës po zinte peshë. Qazimi nuk pati fëmijë nga martesa e tij, por, në fakt, asnjëherë nuk u ndje i vetmuar në mjediset e fisit apo dhe fshatit. "I kam sytë plot" - ishin fjalët e tij. Këtë boshllëk do ta plotësonte në mënyrën më të mirë, Dika, vëllai i tij, i cili bashkë me djemtë dhe vajzat e tij plotësonte më mirë jetën e Qazimit. Dika, me urtësinë, me punën dhe ndershmërinë e tij të spikatur bëri atë që shumë rrallë mund të gjenden vëllezër që të krijojnë një marrëdhënie të tillë, siç kishte ky me Qazimin. Jo vetëm fëmijët e Dikës, duke filluar që tek Hakiu e deri tek më i vogli, por dhe më të rinjtë e fisit dhe më gjerë i thoshin Lala Qazim.

Dhe, vërtet, Qazim Përnezha do të bëhej modeli i komunikimit me të gjitha moshat. Ai kurrë nuk mërzitej të dëgjonte dhe nuk lodhej as të këshillonte kur ishte nevoja. Ndaj, për këtë mënyrë komunikimi që përdorte me të gjitha moshat, fitoi simpatinë e të gjithëve jo vetëm në Çidhën, por dhe jashtë saj.

Odat çidhnake dhe ato të Dibrës ishin tribuna të thjeshta, ishin kuvende ku shoshiteshin e siteshin mendjet, ngjarjet e mëdha, punët e mira dhe të këqija. Aty vendoseshin e prisheshin ekuilibrat e shoqërisë, aty përdorej alegoria apo "llafi nën mutaf", aty fjala e mençur domosdo që ishte pronë e njerëzve të mençur.

Dhe Qazim Përnezha kishte kohë që ishte rreshtuar me ajkën e kohës si: Faslli Sulin, Abaz Tërshanën, Sadin Tolën, Tahir Zogun, Halil Pashnjarin, Lilë Dacin, Destan Xhikën, Ramadan Hoxhën, Mudë Hasin e plot emra të nderuar të Çidhnës. Do të mjaftonte që në një odë çidhnake të ishte i pranishëm me Qazimin qoftë edhe njëri prej këtyre emrave, konaku do të kthehej në një shkollë të vërtetë.

Një nga komunikimet më të vështira gjatë gjithë jetës së tij ka qenë takimi me Haxhi Lleshin në vitin 1960 në fshatin Fushë-Alie. Duke qenë i mirëinformuar Haxhi Lleshi në zgjuarsinë natyrale të Qazim Përnezhës, i kërkohej që në këtë takim të mbahej qëndrim për arratisjen e vajzave të Halil Alisë. Dhe Qazimi, si i zgjuar që ishte, edhe në këtë situatë të vështirë të krijuar ia doli mbanë dhe e kaloi "klasën". "Tufa është e vjetër e çobanët janë të rinj, dhe se çobanët nuk përdorin shkopin, por xhupën për të kthyer tufën". Kjo alegori e çastit e Qazim Përnezhës bëri që Haxhi Lleshi të mbetej me gojë hapur nga zgjuarsia e këtij çidhnaku, ku vetëm nëpërmjet kësaj alegorie e mori farë mirë mesazhin se çfarë deshi t'i thoshte plaku i zgjuar i Çidhnës.

Kështu, fill pas 2-3 vite ma vonë, falë zgjuarsisë së Qazim Përnezhës, represioni komunist që bëhej vazhdimisht në Çidhën u zbut disi.

Oda e tij e vogël kishte vend për të gjithë. Tavanet e drunjta, muret e lyera me botën e bardhë, që në fakt i nxinte shpesh cigarishtja e sermit, ishin dëshmitaret e bisedave miqësore e vëllazërore që bëheshin aty.

Ndaj kjo odë priti shumë njerëz, priti miq, por dhe intelektualë e studiues që, në fakt, merreshin me historinë e Dibrës dhe etnokulturën e saj. Vizitorë të saj u bënë shpesh në ato vite Ilmi Sadiku, Haziz Ndreu, Munir Shehu, Zija Shkodra e Izet Alku. Kur Ilmi Sadiku në një takim me Qazim Përnezhën dhe një person tjetër nga fshati që kishte shumë informacion për një ngjarje historike të zonës, por që në fakt nuk po e tregonte, Qazimi e zbuti situatën e krijuar me një fjalë të urtë nga zona e Lurës: "Kur po e ze, t'kam lakme, kur po e le, kraje s'po ve".

Haziz Ndreu si njohës i historisë dhe veçanërisht i pasurisë së folklorit dibranë e vizitonte shpesh Qazimin. Bisedat ishin të fushave të ndryshme. Si një njohës i etnokulturës, ai do të shprehej: "Dizeni i Çidhnës është Qazim Përnezha". Konsiderata të mëdha patën për të edhe Zija Shkodra e Izet Alku. Ata, në fakt, morën shumë nga thesari i këtij burri të mençur.

Vitet e fundit ai do të punonte si punëtor në ndërmarrjen bujqësore, sektori i Shumbatit. Ai vlerësonte shumë Xhetan Xhikën jo vetëm si drejtues, por edhe si njeri si dhe Nazmi Çoren e Dali Çerën si kuadro të këtij sektori, që u kujdesën për t'ia lehtësuar lodhjen.

Vdiq në janar të vitit 1981. Humbja para kohe e Qazim Përnezhës ishte një humbje e madhe jo vetëm për familjen, por për gjithë Çidhnën dhe më gjerë. Brezit të ri do t'i mungonte Lala Qazim me këshillat me vlerë dhe fjalën e mençur, fshatit do t'i mungonte njeriu i zgjidhjeve, Çidhnës do t'i mungonte alegoria e fjala e tij e goditur në mexhelise me peshë.

Po e mbyllim këtë shkrim homazh me fjalët e mençura të Qazim Përnezhës: "Kur nuk di se nga vjen, nuk di se kush je dhe nuk mund ta gjesh se kush mund të bëhesh".

Botim i ri



Bashkim Rama
BALLKANI PAS RËNIES SË MURIT TË BERLINIT – VETËVENDOSJA "VERSUS" TËRËSIA TERRITORIALE

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-03-7
Çmimi: 1250 lekë

Botimet e Shtëpisë Botuese M&B, mund t'i gjeni pranë librarisë në Rrugën e Dibrës, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.

Rruga e Arbërit nr. 85
kulturë



Pamje nga Lura, Prill 2013 - Foto Ermal Lushi

Kararet e Lurës

Një vlerë e shtuar për historiografinë dhe drejtësinë

Nga **MEVLUD BUCI**

Sot, kur më fortë se kurrë shoqëria shqiptare dhe secili prej nesh ka nevojë për drejtësi, është e arsyeshme dhe e domosdoshme që shteti, udhëheqësit e votëbesuar, e në radhë të parë drejtësia shqiptare të kthejë kokën të rinjohë dhe të përzgjedhë sadopak nga "kararet e dheut" të Lurës së Dibrës. Aty çdo gjë e çmuar, e drejtë, e vërtetë sado e vjetër të jetë, mbetet gjithmonë e re, e çmuar, rrezatuese, konkrete, e vlefshme dhe ndihmuese.

Lura është vendi i vëllazërimit e paqëtimit, ku në shumë shtëpi janë e bashkëjetojnë në harmoni tri fe. Dëshmi kjo e vlerës së karakterit, e fjalës, e besës dhe e nderimit për njëri-tjetrin. Sokrati thotë: "Nderi, prindërit, miqtë". Kjo urti e ndritur është sa e lashtë aq edhe e re, aktuale, domethënëse. E vlefshme dhe e domosdoshme, veçanërisht për Shqipërinë, që në të shumtët e rasteve sot, nën "petkun" e demokracisë, ka fituar një liri të shfrenuar, që nëpërkëmb ligjin.

"Kararet e Dheut" të Lurës përbëjnë një thesar të çmuar për historiografinë dhe drejtësinë shqiptare. Një fakt i hidhur është se në praktikën e përditshme çalon drejtësia, çalon zbatimi konkret i ligjeve, çalon zgjidhja në kohë e me drejtësi i asaj çka të takon, çka meriton. Përse ndodh kjo? Sigurisht nga fakti se votëbesuari, apo të emëruarit në postet më të larta, harrojnë betimin, turren pas pasurisë, pas tarafeve, pas interesave personale. Fjala "ministër" vjen nga latinishtja, që në shqip do të thotë "shërbëtor". Atëherë, po ne të tjerët, po intelektualët apo zyrtarët e lartë të qeverisë së shërbesave?! Këto e të gjithë ne jemi e duhet të jemi shtatë herë shërbëtorë të drejtë, të duruar, të përkushtuar e mbi të gjitha të drejtë. Ajo çka vërejmë çdo ditë fakton se ne kemi ligje të forta, kemi titullarë me dy-tri grada, me pushtet etj., por drejtësia është larg, është si nata me ditën me praktikën e përditshme për zgjedhjen e konflikteve, për shuarjen e krimeve, për shmangien e gjakmarrjes e të padrejtësive në mjedisin tonë shoqëror.

Të njohësh popullin, të studiosh kulturën e tij secili prej nesh befasohet, mediton dhe ndjen peshë të rëndë, për të shëmbëllyer, për të zbatuar sadopak drejtësinë në praktikë. Vërtet dëgjojmë udhëheqësit, deputetët, zyrtarët e lartë që çdo ditë flasin kundër korrupsionit, kundër krimeve, kundër vjedhjeve, kundër tarafeve, pra bëjnë mirë, por realiteti, vendosja e vlerave në vendin ku u takon, tregojnë të kundërtën. Por, sipas Skoratit, "E thëna me të bërë, ka në mes një mal të tërë".

Të flasësh drejt është a-ja, të zbatosh drejt e të vlerësosh të vërtetën, kjo është e mbetet prova më e çmuar, kjo si i thonë është "thembra" e Akilit. Nga puna ime si mësues e drejtor shkolle për gati 44 vjet kam parë, shoh dhe provoj çdo ditë se drejtësia është larg e shumë larg realitetit. Populli ynë filozof, i urtë e i duruar ka parë e shikon se si votëbesuesi, i emëruesi në postet më të larta, shndërrohet në biznesmen, në mendjemadh, në tarafexhi, në thashethemexhi, në vrastarë të vlerave të intelektualëve që kanë merita etj. Por, nëse një avokat, një jurist, një shtetar i lartë do të njihte drejtësisht "kararet e dheut" të Lurës ai do të çmonte, vlerësonte e vepronte shpejt, drejtësisht e realisht, sepse ky popull s'ka patur parti e partiçka në shekuj, por ka pasur fjalën, kararet, mirëkuptimin, mirënjohjen e mbi të gjitha rreptësinë e prerë ndaj zbatimit të kërareve.

Pyetja sot për juristët e shtetarët është: Sa dhe e si i njohin "Kararet e dheut" të Lurës? Kjo jo për t'u kthyer te ato vlera, por për të vlerësuar e zbatuar drejtësinë e ligjeve, drejtësinë që ka nevojë çdo njëri prej nesh.

Është një mangësi e theksuar, një boshllëk nëse një jurist, nuk është i njohur Karaket e Lurës dhe Kanunin e Dibrës. Xhafer Martini me librin e tij, i ka bërë një shërbim të madh kulturës shqiptare. Të ai libër është drejtësia, tradita, udhërrëfyesi i ecurisë për të zbatuar konkretisht drejtësinë, sigurisht duke iu përgjigjur popullit me ligjet e kohës, me sinqeritetin e veprimit me gjuhën e mirësisë e të realitetit objektiv.

Po ashtu, studiuesi Xheladin Tollja, në monografinë: "Lura, trashëgimi historike dhe etnokulturore", botuar më 2006, flet në një kapitull "Mbi karakterin shoqëror të kërareve të dheut" të Lurës. Flet për të veçanta e drejtësisë popullore, vlera brilante këto, të cilat në çdo kohë e brez mbetën aktuale, të ndritshme, të çmuara. Autori jep kararet e besës, kararet e barazimit, kararet mbi shamatën (grindjet) kararet për bimët e gjënë e gjallë, kararet për trojet. Vërtet thesare të vyera të kulturës shqiptare, të cilat jo vetëm kombi ynë, por edhe Evropa e më gjerë, i kanë e duhet t'i kenë zili. "Shtëpia, kasollja apo vatha e thyer dënohet me gjobë një pendë (dy qe) për vegjëlinë. Keqbërësi gjobitej edhe kur digjte kosharet e misrit, kotarin e bulmetit, ushqimin e gjësë së gjallë etj. Këto i kërkonte "Dheu" dhe ishin si norma e pabëra (sipas itifakut).

Zjarri ishte bidat (diçka e shëmtuar) e i pabesë. Qeni të fuste në gjak në qoftëse kafshonte ndokënd që kur lindte dielli e deri kur perëndonte... (Xheladin Tollja, "Lura trashëgimi historike dhe etnokulturore, faqe 41).

"Kararet e Dheut", ose më mirë ligjet e rregullat e popullit të shoqërisë të Lurës së Dibrës përbëjnë kode të rralla të cilat kanë çuar historikisht në lartësimin e unitetit, vlerave, paqtimit, marrëdhënieve, të shmangies së gjakmarrjes, të forcimit të rrezatimit të virtyteve. S'është aspak arkaizëm, por një vlerë e shtuar në drejtësinë e sotme njohja me kararet e Lurës, sepse kuptohet, se ligjet e sotme janë parësore, konkrete, por ecuria e kërareve ndryshon si nata me ditën me ligjet e sotme, se ata gjenin Zhatin, ata bëheshin moto e udhërrëfyes i secilit. Kararet e fjalës, besës, mikut, tokës, gjakmarrjes, kararet e barazimit, kararet e rraxhave (grindjeve) të trojeve e plot të tjera janë një model i vyer i drejtësisë popullore, ku për këto di të kishte e duhet të ketë zili vetë Europa e sotme. Shtrojmë pyetjen: Ku duhet të mbajë njeriu?! E Lura e kërareve përgjigjet: O në respekt (ku futet korrektësia), o në karare (itifak popullor) ose në ligj (drejtësi)...

Sot jemi realist se në shumë raste ndodh e kundërta, mosnjohje e moszbatimi i ligjit. Kararet e Dheut (ligjet e drejtësisë popullore) janë një vlerë e rrallë.

Kryeplaku i Breglumit, organizatori dhe veprimtari i shquar Daut Çerpja nga Zalldardha e Dibrës krenohet me vendlindjen, sepse mbi 60 vjet nuk ka asnjë rast gjakmarrje brenda trevës. Kurse studiuesi dhe Dukagjin Hata dëshmon madhështinë e paqtimit e vëllazërimit në Shumbat të Dibrës, se mbi 200 vjet nuk ka asnjë rast gjakmarrjeje. Pra, forca e fjalës, pesha e saj, urtia e mençurisë popullore në Lurë, Zalldardhë, Shumbat, Çidhën, Katër-Grykë, Reç, Muhurr, Luzni, Bllacë, Homesh e plot treva të tjera ka dhënë frytet e saj në forumin e unitetit e të virtyteve të popullit, në rrezatimin konkret të kërareve të Dheut.

Kararet veçse rregullojnë, ndihmojnë shoqërinë, ligjet, unitetin, paqtimin, marrëdhëniet shoqërore nga përvoja shekullore e Lurës së fisnikërisë është një vlerë e shtuar për historiografinë, etnokulturën dhe drejtësinë shqiptare.

Kararet veçse rregullojnë, ndihmojnë shoqërinë, ligjet, unitetin, paqtimin, marrëdhëniet shoqërore nga përvoja shekullore e Lurës së fisnikërisë është një vlerë e shtuar për historiografinë, etnokulturën dhe drejtësinë shqiptare.

JEPET ME QIRA
mjedis **300 m2,** pranë Kombinatit të Autotraktorëve.
E përshtatshme për çdo lloj aktiviteti.
Lartësia e katit 5 m. Mjedis edhe për zyra!
Linjë trefazore elektrike në dispozicion!
Rruga e shtruar me asfalt!
Të interesuarit të komunikojnë me tel:
069 20 68 603

DJ për gëzimet tuaja familjare me repertor të zgjedhur me këngë dibrane
Jepi dasmës tënde aromë Dibre....
Tel. **066 60 12 616**

Një portret për bashkëshortët Merita e Bashkim Lala, që ngritën dhe e mbajtën në elitën e volejbollit të Shqipërisë ekipin e femrave të Korabit

Merita & Bashkim Lala:
Një jetë me volejbollin

Nga **HASAN LLESHI**

Nga të gjitha llojet e sporteve që janë aktivizuar ndër vite në rrethin e Dibrës, mbresa e kujtime të pashlyera në mendjen e zemrën e popullit të kësaj treve, asnjë mëdyshje, janë ekipet e mirënjohura të volejbollit për femra të të gjitha moshave.

Për këto ekipe e konkretisht për ekipin e Volejbollit për të rritura, ka se çfarë të flasësh e të krenohesh. Kjo sepse për afër 4 dekada, ato u kanë rezistuar me forcë e energji të pashtershme të gjitha sfidave e vështirësive, duke i përballuar ato me punë, mund, djersë e sakrifica të mëdha. Bindës për këtë sigurisht është fakti se afër 40 vjet, ky ekip qëndroi në kategorinë superior, e qëndron edhe sot e kësaj ditë po në atë vend.

Gjithsesi vlera e merita të padiskutueshme për këto arritje, kanë pasur çifti i mrekullueshëm Merita e Bashkim Lala, trajner të këtij ekipi për afër 40 vjet. Këto dy bashkëshortë trajnerë, mund të konsiderohen njëkohësisht me plot kuptimin e vërtetë të fjalës si themelues të sportit të volejbollit të femrave në Dibër, që e ngritën atë aq lart si asnjë lloj sporti tjetër në këtë rreth. Këtu nuk mund të humbasim edhe punën e shkëlqyer të trajnerëve të nderuar të ekipeve të para të rejave dhe të rejave të drejtuar nga të mirënjohurit: Esat Shehu, Ibrahim Bulku, Fehmi Bulku etj.

Unë shkruesi i këtyre radhëve, kam pasur fatin e privilegjin që të jem mjek i këtij ekipi që në vitet e para të karrierës së tyre. Si i tillë që në embrion kam ndjekur nga afër të gjithë veprimtaritë dhe aktivitete që ka zhvilluar ky ekip.Natyrisht është shumë e vështirë për të portretizuar në pak radhë, jetën dhe veprimtarinë e një ose dy trajnerëve apo të një ekipi me një aktivitet kaq të gjatë e të gjerë e me rezultate kaq të larta. Kjo sepse e gjithë veprimtaria e tyre, për afër se 4 dekada, përbëjnë një arshivë të gjallë e të pasur të sportit Dibran dhe që kristalizojnë më së miri kredon profesionale të këtyre dy trajnerëve të mëdhenj, si dhe të këtij ekipi shumë të dashur të sportit të rrethit të Dibrës.

Që në fillim mund të shprehem se meritat më të mëdha këtyre dy trajnerëve, qëndrojnë në faktin se periudha kur ato e nisën këtë karrierë, ishte krejtësisht kohë tjetër. Duhet të kujtojmë këtu Dibrën e viteve '70, që përfshihej në zonat veriore të vendit, e që akoma në atë periudhë, njerëzit nuk ishin "çliruar" mirë nga konceptet, dogmat e mentalitetet e njohura të kohës. Nga ana tjetër, numri më i madh i këtyre vajzave të reja volejbolliste, vinin nga zonat e thella të rrethit. Sigurisht, që do të drejtojë një ekip të tillë në atë kohë, ishte një sakrificë, përgjegjësi e pse jo një guxim i madh e delikat. Por këto nuk i dekurajuan bashkëshortët trajnerë të talentuar Merita e Bashkim Lala. Ato e nisën me përkushtim, me besim në vetvete, me forcë, kurajë e optimizëm të gjallë, këtë "Valle" të madhe, për të mos u "dorëzuar" kurrë, para problemeve e pengesave të mëdha e që i përballuan ato me këmbëngulje e ndershmëri.

Do të kujtoj këtu një thënie të Gëtes, ku thekson se: "Jeta është një fushë që prodhon ashtu si punojmë ne, korrje lulesh apo gjembash". Mesazhi besoj se këtu është i qartë. E gjithë jeta e veprimtaria e këtij ekipi deh e këtyre dy trajnerëve, për afër 40 vjet, ishte një "ndeshje" e një luftë e vazhdueshme për të arritur të gjitha detyrat e objektivat që i kishin vënë vetes. Deh vërtet rezultati që konkret. Ato gjithmonë korrën vetëm lule.

Mendoj se 3 janë faktorët vendimtarë që ndoqën dhe zbatuan me kompetencë e profesionalizëm këto dy trajnerë, për të kapur kuotën e duhur dhe që i dhanë jetëgjatësi kaq të madhe këtij ekipi në kategorinë superiore.

E para – ishte përzgjedhja e elementeve të rinj. Të dy këto trajner, vizionar e profesionistë të mirëfilltë, vlerësonin me seriozitet e kompetencë të plotë elementët e rinj, që do të aktivizonin në të ardhmen në këtë lloj sporti. Ato kërkonin dhe çdo individ për të garantuar në të ardhmen një sportist të aftë e me produktivitet të lartë. Ndër kriteret bazë që kërkonin me këmbëngulje të zbatonin ishin: mosha, përmasat trupore, reflekset, gjeni familjar si dhe gjendja shëndetësore e çdo individi. Në këtë të fundit puna përqendrohej kryesisht tek aftësia e organeve me rëndësi që i duhet një sportisti për të arritur rezultatet e duhura si: zemra, veshët, sytë apo evitimi i ndonjë sëmundje tjetër e lindur ose kronike që mund të zbulohej gjatë ekzaminimeve nga konsultat.

Vetë Bashkimi ishte kaq i interesuar e i përkushtuar për këto probleme, sa të çuditse me





Trajnerët Merita e Bashkim Lala, gjatë gjithë kohës që kanë drejtuar ekipin e Volejbollit të femrave "Korabi" mbetën me plot kuptimin e fjalës prindërit e dytë e të mirëfilltë...



Merita dhe Bashkim Lala me ekipin e volejbollit te femrave te Korabit. Foto arkiv: © Edmond Hasani

magjinë e sjelljes e të veprimeve të tij. Ai vet shkonte shkollë më shkollë, klasë me klasë e pse jo dhe fshat më fshat, vetëm e vetëm për t'i dhënë prioritet zgjedhjes së elementeve të këtyre kategorive. Jo vetëm kaq, por ai kudo ndodhej, në xhiro apo ndonjë ambient tjetër me shokët, sapo shikonte diku në rrugë ndonjë vajzë të moshës 10-12 vjeçare e që i mbushte syrin se i plotësonte kriteret e janë volejbolliste të ardhshme, shkëputej menjëherë, shkonte dhe e takonte atë pa e njohur e pa e ditur se kush ishte, i merrte informacione të hollësishme për të gjitha gjeneralitetet etj. Më tej ne nuk dinim se çfarë veprimesh e mekanizmash luante, por çuditeshim mbas disa kohësh kur shkonim në palestër shihnim të njëjtën fytyrë duke bërë stërvitje me ekipin e volejbollit.

Të dy këto trajnerë, ndonëse drejtonin ekipin e volejbollit të të rriturave, por vëmendjen dhe përqendrimin e tyre kryesorë e kishin drejtuar tek ekipet e para të rejave dhe të rejave të këtij lloj sporti dhe që me trajnerët e këtyre ekipeve kishin bashkëpunim të ngushtë. Gjithë shpresat dhe besimin e tyre ato e kishin hedhur pikërisht tek këto mosha si filizat e reja, sepse ato ishin e mbetën gjithmonë e ardhmja dhe e perspektiva e vërtetë e Volejbollit "Korabi". Këtë gjë atyre ua impononte vetë puna, mbasi tek ekipi i volejbollit për të rritura çdo vit ndodhte një "eksod" i vërtetë. Pra çdo vit nga ekipi largoheshin 2 ose 3 volejbolliste më të mira, të cilat ishin përgatitur në vite dhe me shumë mund e sakrifica. Në fakt ky largim ishte një detyrim i natyrshëm, mbasi tek këto vajza volejbolliste vinte koha e mbarimit të shkollave të mesme, për të vazhduar më tej shkollat e larta në Tiranë apo vend tjetër. Kështu që ato gjenin strehë e bëheshin kontingjent i ekipeve më me emër në kryeqytet si tek "Dinamo", "Partizani", "Tirana", "Studenti" etj., kurse ekipi "Korabi" varfërohej deri në atë gjendje sa të kallte frikën. Po ja që nuk ndodhte kështu. Falë punës së madhe e këmbëngulëse së këtyre dy trajnerëve të pasionuar e të palodhur, ku me forcë e moral të lartë, arrinin që në një afat kohor të shkurtër, të rikuperonin plotësisht ekipin, duke i dhënë atij përsëri performancën e mëparshme dhe që ishte i gatshëm të përballonte sfidat dhe betejat e mëtejshme.

Në faktorin e dytë dhe po aq të rëndësishëm që e ngjiti aq lart ekipin e Volejbollit "Korabi" ishte stërvitja serioze e komplekse që zhvillonte çdo ditë. Si Merita e veçanërisht Bashkimi ishin shumë kërkues e të vendosur si dhe autoritar të vërtetë për të gjitha veprimet e ekipit në stërvitje. Kritikonin ashpër çdo gabim e veprim jo të saktë që shihej, jepnin këshillat dhe rekomandimet e duhura, sepse për çdo gabim që bëhej në stërvitje, ato e konsideronin sikur kishte ndodhur direkt në fushën e lojës reale. Ana më e veçantë e pozitive e këtyre trajnerëve ishte se çdo fitore që realizonte ekipi, sidomos me skuadra kundërshtare të forta, nuk deheshin kurrë nga sukseset e as që i vinte në gjumë ky fakt. Çdo fitore ata e përdornin si "kredi" për të vazhduar me besim të plotë punën e mëtejshme.

Faktori i tretë që ishte më i rëndësishëm e më vendimtari që e mbajti kaq lart moralin dhe prestigjin e këtij ekipi të mrekullueshëm, ishte disiplina e fortë dhe e rreptë në të gjitha nivelet gjatë gjithë kohërave.

Mosha adoleshente e këtyre vajzave volejbolliste, qenia e tyre çdo ditë jashtë kontrollit e syrit familjar për një kohë të konsiderueshme, fjala vjen: paradite në shkollë, mbas dite në stërvitje, çdo 2 javë me ditë të tëra jashtë rrethit në takime që bënin ndonjë program tjetër. Kështu që përpara këtyre dy trajnerëve shtroheshin detyrime e përgjegjësi të mëdha morale. Në mënyrë të veçantë, detyrimet më të mëdha ato i kishin ndaj prindërve e familjarëve të këtyre vajzave, të cilët u kishin lënë në mirëbesim fëmijët e tyre, dritën e syve të një moshe shumë delikate edhe si femra që ishin.

Trajnerët Merita e Bashkim Lala, gjatë gjithë kohës që kanë drejtuar ekipin e Volejbollit të femrave "Korabi" mbetën jo vetëm trajnerë të tyre, por me plot kuptimin e fjalës prindërit e dytë e të mirëfilltë për to. nuk ka dyshim që "barra" më e madhe kuptohet binte mbi Meritën e cila për këto vajza ajo u bë jo vetëm mësuesja dhe edukatorja ideale, por edhe një nënë e dytë e vërtetë.

Ky besim ishte bindur dhe rrënjosur tek të gjithë prindërit e të afërmit e këtyre vajzave, ndaj ato gëzonin një respekt e mirënjohje të veçantë për këto dy trajnerë shembullorë. Midis tyre u krijuan korrespondenca e raporte shoqërore të sinqerta, shkëmbim vizitash familjare të ndërsjella për çdo problem, sa që këto raporte ruhen edhe sot e kësaj dite po me aq sinqeritet. Për 40 vjet rresht e që vazhdon akoma te ky ekip e tek këto vajza ideale, asnjëherë nuk u dëgjua as pëshpëritja më e vogël për to. sot secila prej tyre kanë krijuar familje të rregullt e të shëndoshë e që bëjnë jetë normale e të qetë me bashkëshortët e fëmijët e tyre kudo që ndodhen, e që e ka zili çdo kush.

Ndonëse në vështrimin e parë të duket sikur jam zgjatur pak në këtë material, por që jam i bindur e i ndërgjegjshëm se për vlerat dhe meritat e këtij ekipi dhe të këtyre trajnerëve të mirëfilltë, munda të nxjerr në dritë vetëm disa fakte fragmentare të shkëputura nga sfondi i jetës së tyre sportive. Kjo sepse ato kanë bërë një rrugë të gjatë, të vështirë e të lodhshme; mes dallgësh e furtunash të panumërta, me tatëpjeta e të përpjeta, por që gjithmonë i sfiduan ato ballëlart.I gjithë ky kalvar ka si emërues të përbashkët; forcën shpirtërore të njeriut, virtyt i cili përbën platformën e vërtetë si në thelb ashtu dhe në përmbajtje e që është filozofia e progresit. Fakt i cili u shërbeu atyre gjithmonë si "lokomotivë" për të ecur vetëm përpara.

Në mbyllje të këtij shkrimi, desha të përshëndes e të falënderoj me respekt të thellë, të gjitha volejbollistet e para të ekipit "Korabi" që mund të konsiderohen me bindje të plotë si themeli i sportit të volejbollit për femra në Dibër siç janë: Fllanxa Toçi, Nadire Brahilika, Nevruze Sejdini, Tare Pisaku, Edlira Shehu, Afërdita Lala, Shpresa Skarra, Manushaqe Çorja, Shefikat Xhilaga, Kujtime lazimi, Monika Shehu, Aida Shehu, Kristina Roçi, Kristina Roçi, Afrime Salkurti, Shkëlqime Spahiu, Bernereta Haxhiu, Qefsere Alku etj.

Mirënjohje e respekt të veçantë gjithashtu iu drejtohej të gjithë prindërve e të afërmve të këtyre volejbollistëve, të cilët ishin ato, që thyen konceptet e mentalitetet në dobi të shoqërisë e të përparimit.

Mirënjohje e respekt të thellë njëkohësisht gjithë dashamirësve e tifozëve të nderuar dirbanë që ndoqën nga afër lojën e këtyre volejbollisteve të mrekullueshme.

Me entuziazmin e brohoritjet e tyre, ato ngritën peshë ndjenjat dhe energjitë e këtyre vajzave, nxitje e cila u bë oksigjeni e ushqimi i rëndësishëm për to, pikërisht në atë kohë kur ato kishin shumë nevojë. Kjo sepse e çlironte ato nga ndrojtjet dhe emocionet e shumta që kishin para ekipeve të mëdha si: "Dinamo", "Partizani", "17 Nëntori", "Skënderbeu" etj., si dhe nga publiku kaq i madh që mbushte plot e përplot sallën e lojërave me dorë të qytetit tonë.

Për të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet e tyre sportive, si ekipi ashtu dhe trajnerët e këtij sporti janë vlerësuar me dekorata, urdhra e medalje të ndryshme nga dikasteret shtetërore. Ekipi i Volejbollit për femra "Korabi" nga Federata Shqiptare e Volejbollit është dekoruar me Urdhrin "Naim Frashëri", kurse Bashkia e qytetit i ka dekoruar me "Nder i qytetit", ndërsa trajnerët Merita e Bashkim Lala janë dekoruar nga Federata Shqiptare Volejbollit me "Çertifikata mirënjohje" Klubi i Sportit të Dibrës me "Nder i sportit dibran", Bashkia e qytetit "Nder i Qytetit", kurse Bashkimi nga Federata Shqiptare e Volejbollit ka marrë medaljen "Ylli i artë i punës" etj.

*** Ish mjek i ekipi të volejbollit**

Fjala e prof. Dr. Nuri Abdiu në promovimin e librit "Dibra në hulli të historisë" të autorit Xhemal Domi, 2 mars 2013

"Dibra në hulli të historisë"

Histori e arsimit dhe mendimit pedagogjik

Faleminderit Xhemal Domit për ftesën dhe kërkesën që edhe unë të kisha fjalën për librin e tij "Dibra në hulli të historisë" – Historia e shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevën e Dibrës dhe rreth saj.

Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik është një eveniment themelor me rëndësi për ne, për historinë e arsimit dhe të shkollës në Dibër e rreth saj.

Puna studimore në këtë drejtim ka nisur vonë. Megjithatë kjo punë studimore shkencore është gjallëruar sidomos pas vitit 1960 kur u hodh në dritë mbi atë traditë shumë të pasur edhe në shumë aspekte të saj.

Kjo traditë e pasur është e lidhur me tiparin themelor arsimdashës të popullit shqiptar në përgjithësi dhe sidomos të Dibrës e dibranëve në veçanti.

Vepra "Dibra në hulli të historisë" sipas meje është një vepër fondamentale më e plota dhe që jep për herë të parë dhe të argumentuar një vepër të plotë shkencore.

Pse thashë se studimi është një vepër monumentale?

Për arsimin kanë botuar edhe autorë të tjerë, por vepra e Domit është nga më të plotat. Studimi është mjaft i plotë dhe mjaft i arritur po të marrim parasysh se tema është mjaft e gjerë. Tema që trajton z. Domi është e shtrirë si në kohë edhe në tematikë që përfshihet që nga lashtësia deri në vitin 1990, e shtrirë në tre volume.

Volumi i parë shtrihet që nga lashtësia deri më 1912 në 342 faqe.

Volimi i dytë përfshin periudhën nga viti 1912 deri më 1944 në 367 faqe.

Volumi i tretë përfshin periudhën 1944-1990 me 385 faqe.

Për shtjellimin e kësaj monografie që po promovojmë sot, z. Domi ka shfrytëzuar burime dokumentare të shumta, materiale e dokumente arkivore. Ka shfrytëzuar botime të ndryshme jo vetëm shqiptare, por edhe të Shkupit, Prishtinës, Malit të Zi etj., që do të thotë se u referohet shumë burimeve gjë që e rrit më shumë vlerën e saj shkencore. Vepra përmban 1419 fusnota gjë që e rrit më tej vlerën e saj.

Me hapjen e tri shkollave të para shtetërore, ose siç i quan autori "Tri dallëndysheve të para" në Peshkopi, në Trojak (Sllovë) dhe në Trebisht në prill 1914, në Dibër fillon arsimi kombëtar i drejtuar nga shteti shqiptar.

> Vepra e Domit është nga më të plotat. Studimi është mjaft i plotë dhe mjaft i arritur, po të marrim parasysh se tema është mjaft e gjerë. Tema që trajton z. Domi është e shtrirë si në kohë, edhe në tematikë, që përfshihet që nga lashtësia deri në vitin 1990, e shtrirë në tre volume.

Ky fillim i mbarë e ka zanafillën që me fillimin e Rilindjes shqiptare. Sivjet dibra përkujton 125-vjetorin e shkollës së parë shqipe që u hap në Dibër më 1888, një vit pas hapjes së shkollës së parë shqipe të Korçës. Pas tyre janë hapur edhe disa shkolla të tjera që kanë lënë emër të mirë në historinë e arsimit e mendimit pedagogjik në Dibër, ndër to dallohet në historinë e arsimit e mendimit pedagogjik në Dibër, ndër to dallohet shkolla e Kastriotit që në popull njihet me emrin "Internati i Kastriotit". Por internati është konvikt e jo shkollë, gjë që duhet rregulluar.

Dua të përmend emrat e disa mësuesve që kanë dhënë mësim në shkollën e Kastriotit të cilët Z. Domi i ka takuar personalisht në Shkodër si Refik Shpuza, Jahja Damnari, Shaban Arra (Zerqani), Fehmi Dizdari, Abdulla Çanga etj.



Studimi i Xhemal Domit, si vepër njerëzore, nuk mëton të jetë si qielli i kthjellët si loti, se vepra pa cene ka bërë vetëm Zoti. Ka pas thënë Pjetër Mazrreku: As diell pa hije, as hanë pa mjegull nuk ka në këtë botë".

Një vepër e denjë për historinë e arsimit të Dibrës

Nga **SHEFQET HOXHA**

Është sot një ditë në shenjë, sepse po paraqitet nj vepër në tre blej, me 1200 faqe e studiuesit Xhemal Domi: "dibran në hulli të historisë – Zhvillimi i shkollave, arsimit dhe e mendimit pedagogjik në trevat dibrane" që nga zanafilla e deri në vitin 1990. Është një punë 30-vjeçare e autorit, rezultat gjurmimesh këmbëngulëse, sistematike në arkiva, në organet e shtypit dhe në një literaturë të gjerë historiko-arsimore, pra është vepra e jetës së tij. Kjo sapo ka dalë nga shtypi në kuadrin e 7 Marsit, ditës së mësuesit, por është e përfshirë në kolanën e botimeve të 100-vjetorit të pavarësisë kombëtare.

Kumtimet e shpaluara na transmetuan të dhënat e domosdoshme dhe vlerësimet përkatëse për këtë vepër, prandaj syzimi im mund të jetë si barrë mbi ligji, por u kërkoj ndjesë dhe u siguroj se nuk do të shpërdoroj durimin tuaj, ngase nuk po më rrihet pa ia thënë dy fjalë si peng nderimi në këtë shendllëk z. Xhemal Domit, mikut tim të kahershëm, kolegut të një lëmije, studiuesit fjalëpak e punëshumë, bashkëkrahinarit dhe bashkëanëtarit të devotshëm të Shoqatës Atdhetare-Kulturore "Luma". Madje, në emër të kryesisë së kësaj shoqate, para këtij auditore të nderuar e përshëndes dhe e falënderoj përzemërsisht z. Domin për këtë vepër dinjitoze kushtuar historikut të arsimit të trevave të Dibrës dhe më gjerë, për këtë dhuratë të bukur që po na sjell ne mësuesve dhe njërës prej krahinave më të njohura arsimdashëse të kombit, Dibrës. Me këtë rast i uroj shëndet dhe mend në kokë, sepse tani kripit tim dhe të Xhemal Domit u ka ra bora.

Si mësues e drejtues shkolle për disa dhjetëvjeçarë (1952-1993) Xhemal domi u ka falë nxënësve të shumë viseve, sidomos atyre të Kalasë së Dodës dhe prindërve të tyre mendjen, shpirtin dhe zemrën e tij nën shembullin e të atit, Harun Jakupit, që pat sjellë abetaren shqipe nga Bukureshti, si dhe të traditave të vyera atdhetare-kulturore të familjes dhe të mjedisit.

Është vlerësuar me Urdhrin "Naim Frashëri" dhe ka lënë fërkeme në shkollat e Lumës Jugore dhe në krahinën e Dibrës, si edukator, si aktivist shoqëror, si studiues, si atdhetar dhe si besimtar i Zotit.

Në vitet 70 vjetorin e kaluar Xhemal Domi qe përfshirë si i përzgjedhur në tubën e studiuesve të rijn për të bubërruar, ndriçuar e botuar traditat historiko-kulturore të viseve të Dibrës.

Botoi në ato vite e më pas një tubë studimesh si "*Historiku i shkurtër i Kalasë së Dodës*", "*Mbi të vërtetat historike të Shqipërisë Veri-Lindore në vitet 1918-1925*", "*Malësia e Veriut – forcë goditëse dhe prapavijë e Lidhjes së Prizrenit*" etj.

Atëherë Xhemal Domi nis e nxen brumin për veprën "*Historia e arsimit në Dibër*", qëmton në arkiva, hulumton në botime historike e arsimore-kulturore, zbulon të dhëna nga organet e hershme të shtypit dhe këto i toçit dalë e dalë në laboratorin e tji dhe pas shumë vitesh punë në heshti harton veprën stërmadhe që e kemi tani në dorë.

Kjo vepër nuk është thjesht një histori e shkollës, arsimit e mendimin pedagogjik të trevës së Dibrës, por një enciklopedi e njëmendët historiko-arsimore, një dhuratë për arsimin dhe kulturën kombëtare. Kjo ka vlera njohëse, edukuese, shkencore; është shkruar me dashuri, me përkushtim e me kompetencë në respekt të malësorëve dirbanë që trashëgojnë një histori e kulturë të lashtë. Dibranët janë sa punëtorë aq edhe atdhetarë të vërtetë, ata i kanë falë kombit figura të ndritshme në fushën e dijes dhe të arsimit.

Studimi i Xhemal Domit, si vepër njerëzore, nuk mëton të jetë *si qielli i kthjellët si loti,* se vepra pa cene ka bërë vetëm zoti. Ka pas thënë Pjetër Mazrreku: *As diell pa hije, as hanë pa mjegull nuk ka në këtë botë".*

Prandaj, të lumtë Xhemal Domi, i ke blatue Dibrës veprën tënde të jetës, por kam bindje se edhe Dibra nuk ka me të mbetë borxh, ka me ta kthyer kapicë, "E fala ka të falën" – thotë kanuni.

Ju faleminderit

recensë

"Dibra në hulli të historisë" na jep konceptin kronologjik të rrugës trajtuese dhe vlerësimin se populli i Dibrës, problemet e mësimit e edukimit i kanë pasur kërkesat më prioritare ...

Një studim me vlera e mesazhe atdhetarie

Nga **BEQIR SHEHU**

Shkrimtari dhe filozofi francez Zhan Pol Satri shkruan se ngjarjet si histori, po nuk u bënë të ditura nëpërmjet historishkruarjes, harron dhe humbasin. Historishkruarja është shkencë sepse bazohet në vërtetësinë e provuar me fakte, objekte e dokumente burimore të interpretuara me përgjegjësi nga shkencëtarët historianë. Xhemat Domi me profesion mësues, që e ushtron mbi një gjysmë shekulli, me arsim të lartë në gjuhë e histori, i pasionuar në punën studimore shkencore, studimin "Historia e shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevat dibrane, e ka kryer në një periudhë mbi dhjetë vjeçare, duke gjurmuar në arkiva e biblioteka mijëra dokumente, duke vjelur kujtime e dëshmi të dhjetëra personave të cilët i kanë përjetuar këto ngjarje dhe duke i paraqitur në materialin e shkruar me korrektesë shkencore, na ka dhuruar librin dinjitoz në tre vëllime: Dibra në hulli të historisë, libër i cili mbartë e sjellë vlera e të vërteta historike për zhvillimin e arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevat e Dibrës dhe në trevat rreth sajë.

Cilat janë disa nga veçoritë e historishkruarjes së librit "Dibra në hulli të historisë", nga studiuesi Xhemal Domi?

Së pari – libri i kalon caqet e trajtimit lokal, dhe të gjitha problemet, arritjet e vështirësitë në procesin e zhvillimit, arsimit e gjuhës shqipe, autori i trajton në përmasat mbarëkombëtare.

Së dyti – studiuesi Xhemal Domi pasqyron në këtë libër se, arritjet arsimore e kulturore në trojet shqiptare, janë vepër dhe kontribut i gjithë banorëve arsimdashës të këtyre trojeve po veçanërisht i Rilindasve mendjendritur dhe mësuesve, përkushtimi dhe puna e të cilëve ka qenë promotor i të gjitha arritjeve.

Së treti – problemet e arsimit e shkollës shqipe, në trevat e Dibrës, trajtohen lidhur me të gjitha trevat shqipfolëse rreth saj duke argumentuar se qindra fije i lidhin këto terva, si në çdo fushë të jetës edhe në rrugën historike të shkollës, arsimit e mendimit pedagogjik.

Së katërti – duke konsultuar një material të bollshëm dokumentesh, si dhe shkrime e kujtime, të kohës së zhvillimit të ngjarjeve, që trajton, bazuar në referenca, tepër korrekte, krijohet besim në shkrimet e librit, shmangen deklarimet skolastike e glorifikuese dhe jepet një informacion i vyer për historinë e dijes e arsimit...

Libri, "Dibra në hulli të historisë", që në titull na jep konceptin kronologjik të rrugës trajtuese dhe njëkohësisht vlerësimin se populli i trevave të Dibrës si i gjithë populli shqiptar problemet e mësimit e edukimit i kanë patur, kërkesat më prioritare gjatë gjithë hullisë historike të jetës...

Himn për mësuesit që i dhanë shumë arsimit

Ky libër që kemi në dorë, *"Dibra në hulli të historisë"*, i ndarë në tre vëllime, përkatësisht vëllimi i parë nga lashtësia deri në vitin 1912; vëllimi i dytë nga viti 1912 deri në vitin 1944 dhe vëllimi i tretë nga viti 1944 deri në vitin 1990, nuk është thjesht një historik i arsimit në Dibër, por është një himn për mësuesit që i dhanë shumë arsimit kombëtar.

Dibra në 100 vitet e fundit, sidomos në periudhën e Rilindjes dhe në harkun kohor 1944 - 1990, ka njohur breza mësuesish, që me sakrifica, mund e djersë, i kanë dhënë brezit të ri dije e dituri, gjë që brezat e sotëm po ia shijojnë frytet njëlloj si bashkëmoshatarët e tyre anekënd botës. Ka pasur mësues që udhëtonin 4-5 orë në ditë për t'u mësuar fëmijëve shkrim e këndim, matematikë dhe gjuhë, ka pasur prej atyre që kanë jetuar larg familjes me kujdesin dhe dashurinë për shkollën dhe nxënësit, shumë prej tyre kanë paguar nga rroga e pasuria e familjes, për të blerë libra, fletore, mjete didaktike, dhe sot jetojnë në kujtesën e nxënësve të tyre si mësues të mire, të përkushtuar e të pasionuar.

Xhemal Domi, me librin e tij u ka ngritur një përmendore, para së cilës brezat që vijnë do të përulen me respekt, njëkohësisht ka shënuar edhe emrin në historikun e arsimit në Dibër, që vazhdon edhe sot e kësaj dite, duke i dhënë Dibrës sadopak nga dashuria e tij për arsimin, ndërsa djemtë e tij kanë kursyer për ta bërë të prekshme nga çdokush, brez pas brezi një historik të vështirë, por të mbushur plot me dashuri për vendin dhe gjuhën.

Faleminderit Xhemal Domi, që më bëre edhe mua pjesë të kësaj dëshmie plot dashuri për brezat e ardhshëm!

BUJAR KAROSHI

Konceptimin kronologjik, mësues, Xhemali, e ka pasqyruar edhe në shkruarjen e materialit duke e përpjesëtuar në tre libra. Në librin e parë përshkruhet periudha nga lashtësia deri në shpalljen e pavarësisë dhe formimin e shtetit të parë shqiptar. Në këtë pjesë, autori, na jep një informacion me shumë interes, për përpjekjet shekullore të popullit shqiptar, i cili edhe nën pushtim, problemet e mësimit dhe edukimit i ka patur pjesën më të rëndësishme në udhën e historisë së tij, madje duke ndërtuar edhe infrastrukturën e transmetimit në brezni, ku edhe Dibra dallohet për arritjet dhe veçoritë e saj.

Në pjesën e parë informacion me mjaft interes, dhe të shkruar me shumë dashuri, lexojmë për vlerat vizionare të Rilindasve shqiptarë të cilët përcaktuan dhe realizuan strategjinë kombëtare të arsimit shqiptar brenda traditës kombëtare, si dhe përpjekjet e sakrificat e tyre të panumërta për realizimin praktik të kësaj strategjie.

Informacion me interes, jepet në pjesën e parë, edhe për shkollat fetare, të ngritura në vendin tonë. Në trevat e Dibrës e Pollogut, këto shkolla ishin kryesisht turke dhe dhanë një kontribut me vlerë në fushën e arsimit dhe edukimit në këto treva.

Në vëllimin e dytë të këtij studimi, i cili mbulon periudhën më të vështirë të historisë së kombit tonë, nga viti 1912 deri më 1944, përshkruhen përpjekjet mbinjerëzore të patriotëve e popullit shqiptar për mbrojtjen nga copëtimi të trojeve shqiptare, luftë e cila pati si pjesë të saj të pandarë edhe hapjen e shkollave shqipe dhe zhvillimin e arsimit kombëtar.

Me interes e hollësi është trajtuar politika arsimore e Qeverisë së Vlorës e cila përcaktoi si detyrë themelore hedhjen e bazave për zhvillimin e organizuar të arsimit kombëtar dhe luftën kundër ndërhyrjes së huaj.

Interesat është të dihet se në librin "Lindja e Shqipërisë" e historianes Nicol Guy, në kapitullin "Ambiciet kombëtare dhe nacionalizmi gjuhësor i shqiptarëve" shkruan se në dallim nga shtetet e tjera nacionaliste me bazë fetare të Ballkanit, Serbia, Greqia e Bullgaria, nacionalizmi shqiptar ishte gjuhësor, patriotik pa fobira e qëllime shoviniste ndaj fqinjëve siç isthe shovinizmi fetar, sllavo e greko kristian, të cilët kërkonin me çdo kusht copëtimin dhe pushtimin e tokave shqiptare... Në këtë luftë, për jetë a vdekje pasojat më shkatërrimtare i pati treva e dibrane. Qyteti i Dibrës me gjithë krahinat përreth si deh të gjitha trevat e banuara nga shqiptarë në pellgun e Pollogut u shkëputën nga atdheu mëmë. Qindra familje, thuhet në material, në kushte terrori të ushtruar nga pushtuesit shovinist serbë, braktisën vendlindjen dhe zbritën në Tiranë e Elbasan si refugjatë. Por edhe në këto kushte u hapën tre shkolla, të cilat autori i librit i quan tre dallëndyshet e para. Në Peshkopi me mësues Haki Sharofin, në Trojak me mësues, Hafuz Fetahun dhe në Trebisht me mësues Ramiz Qatja. Se në ç'kushte u hapën këto shkolla, autori i këtij studimi, e tregon me kujtimin e shkruar nga mësuesi atdhetar, veteran i shkollës shqipe Haki Sharofi". Në varfërinë e madhe dhe privacionet e skajshme, nxënësit kishin sjellë nga një copë postiqe për t'u ulur dhe nga një arkë dërrasë për të vendosur fletoret me pllakën e shkrimit.

Me pak libra e fletore, me mungesa të shumta mjetesh e orendish, por me shumë dashuri për dijen, mësues e nxënës u futën në rrugën e dritës për mbrojtësinë e kombit.

Në vëllimin e dytë të librit, Dibra në Hulli të Historisë, jepen informime me interes, për Kongreset Arsimore të viteve 1920, 1922, 1924, për vendimet e tyre, në konsolidimin e gjuhës dhe të shkollës kombëtare shqiptare, si dhe veprimtarinë me shumë interes të Shoqatës Kombësia Letrare e Shkodrës, për rolin e saj në drejtshkrimin e njësuar të gjuhës shqipe. Edhe fillimi i daljes së shtypit pedagogjik, në fillimet e vitit 1921, revistat "Shkolla e Re" e "Kumtari Arsimor" përbëjnë një eveniment të rëndësishëm në konsolidimin e gjuhës dhe shkollës shqipe.

Për trevat dibranë të copëtuara kaq padrejtësisht, në vitin 1913, interes paraqet veprimtaria e Internatit Dibra të cilën mësues Xhemali e ka përshkruar deri edhe në detaje, nga dita e ngritjes deri në shkatërrimin e tij nga pushtuesit fashist. Internati Dibra e Kastriotit u bë fidanishtja e djelmërisë dibrane që organizuan e drejtuan të gjithë jetën arsimore kulturore e sportive në ato vite në qytetin e Peshkopisë.

Në vëllimin e dytë të librit që po shfletojmë është trajtuar edhe ecuria e shkollave shqipe në Dibrën e përtej kufirit të 1913-ës pas pushtimit fashist (1941-1944). Në këtë trajtesë, thuhet: një realitet, pas shkatërrimit të shtetit mozaik jugosllav, në tokat shqiptare në Kosovë, Dibër të Madhe, Tetovë, Gostivar, Kërçovë e Strugë, u vendos administrata fashiste italiane, kur pushtetin civil e policor e përbënin shqiptarët Qendra e Prefekturës u vendos në Dibër të Madhe nga ku vareshin edhe Peshkopia, Zerqani, Kërçova, Struga , Gostivari e Tetova.

"Dukuria më pozitive në rrafshin kulturor kombëtar, ishte ngritja e shkollave fillore e të mesme dhe në të njëjtën kohë, ardhja e një numri të madh mësuesish të përgatitur nga atdheu mëmë".

Të nderuar pjesëmarrës! Unë duke lexuar një intervistë të Arbën Xhaferrit, intelektualit mendje ndritur shqiptar, të botuar në librin "Arbën Xhaferri rrëfen" pyetjes së gazetarit se si do ta quanin shqiptarët jashtë Shqipërisë periudhën (1941-1945); çlirim apo okupim/ Arbni përgjigjet: Shikuar nga aspekti kombëtar, pa dyshim ka qenë çlirim. Nuk e di ju zotëri! Si do t'i përgjigjeshit kësaj pyetje? Unë jam me Arbnin. Gëzuar festën të gjithëve, urime mësues Xhemali, kështu na mbledhsh gjithmonë!

Rruga e Arbërit

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 1500 fjalë (10000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearberit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearberit@gmail.com**>

Redaksia.

Vëllimi poetik "Fotografi e grisur" është vazhdim i bukur i poezisë së Ilmi Dervishit, i cili tashmë është një profil interesant në poezinë që botohet sot në Shqipëri." - Viktor Gjikola





Ilmi Dervishi
Fotografi e grisur
Poezi
Botimet Geer
Tiranë, 2013.

ISBN:978-9928-07-153-8
64 faqe
300 lekë

Nga VIKTOR GJIKOLA

Me krijmtarine e Ilmi Dervishit jam njohur heret.Ka qenë fillim vitit 1975, ku së bashku kryenim detyrimn ushtarak ne Durres...Në një repart të madh si ai i Shënavlashit mund të kalonte shumë kohë pa u njohur nga afër, por Ilmiun na njohu shpejt një poezi e botuar në gazetën lokale "Adriatiku" të Durrësit. Botimi i nje faqje letrare te gazeta "Adriatiku", 20 shkurt1975,krahas emërave te njohur si Bashkim Cuci, Petraq Risto, Demir Gjergji,Suzana Pipa e Sofie Hoxha, Stavri Mila e Taulant Shkaba ,prezantohet dhe Ilmi Dervishi me poezine "Unë ushtari", nje poezi e lexueshme edhe sot.

Ne kete faqe letrare ka dhe vizatime nga piktoret e njohur durrsak, Rruzhdi Rrakulli,Gravil Priftuli e Nikolet Vasia.Dhe ne ate vit , poeti i ardheshem s'kish mbushur akoma 20 vjet..

Me vone cikli i poezive të gazeta Zeri i Rinise, 1 qershor 1976, apo te revista "10 korriku", maj 1976, cikli me tetë poezi tek "Ushtima e Maleve", e të tjera e ben jo vetem të njohur si krijues, por dhe te vlersuar me çmime dhe me shkrime në shtypin e kohes. Te biblioteka me thanë se ishte ushtar i repartit dhe unë nxitova ta takoj e ta uroj...

Mësova se kishte botuar dhe me pare kur ishte nxenes ne shkollen e mesme mekanike Shkozet,mësova gjithashtu se vinte nga një areal që kishte nxjerr artistë me emër si Aziz Ndreun,Liri Rashën etj.

Pastaj emrin e tij e pashë poshtë shkrimeve dhe poezive që botoi dhe në "Luftetari", "Zeri i Rinise", revisten "10 korriku", gazeten "Ushtima e maleve" e Dibres e tjere...

...Ne shume rrethe filluan te botohen Almanakë me krijmet e degëve te lidhjes se shkrimtarve e artisteve, ku pervec histori e tradita, akreologji, kishte dhe krijmtari artistike ne te gjitha gjinite, e pikërisht ne "ALMANAKU DIBRA", 1976, krahas autorve te njohur dibran, ne rubriken "Zera të rinj, botojne Shaban Sinani, sot Akademik i njohur ne trevat shqiptare, Kudret Isaj, poet e autor tekstesh ne festivale,botohet poezia "vajza zboriste" e Ilmi Dervishit.

Ndonëse rralle, deri ne vitet '90 –të, ka botuar publicisikë e poezi.Libri i parë poetik "Flas me trishtimin tim", hapi siparin e një varg botimesh jo vetëm në poezi. " Nje shpirt përgjysëm', "Ngjyrat e jetes, monografia, " Dinjitet përballë intrigës", me bashkëautor, "Skoreja në vështrimin tim", flasin për angazhimin e tij për një shkrimtari cilësore dhe produktive.Vëllimi me poezi "Fotografi e grisur", është vazhdim i bukur i poetikës së Ilmi Dervishit, i cili tashmë është një profil interesant në poezinë që botohet sot në Shqipëri.

NË VEND TË NJË PORTRETI

Era e Korabit më trazoi flokët,
Para pasqyrës s'rrija çdo ditë.
I kam dashur e respektuar shokët,
Si pulbardhat brenda në shpirt.

Nëse me erën më erdhi bora me ngricë,
Veç kollën e atë, mora virus.
Nëse dashuritë, më dolën si leshterik.
Detin s'e munda dot, ishte sundues!

Degë shelgu në breg të lumit,
Që hedh rrënjë krejt rastësisht.
Në krenarinë e mashkullit, burrit,
Përkthehet: Do jetoj përjetësisht!

Jetoj pas vdekjes me pasardhës të mi,
Me burra të mirë në sofër jam ul!
Nga ç'kam shkruar, do mbetet një poezi
E jo çdokujt në jetë i jam përkul.

FLAMURI NË BALLKON

Hyj e dal, s'e e kam timen shtëpinë,
E thjeshtë, po ndjehem mirë.
Në ballkon pi kafe në tavolinë.
Ngjit e zbres shkallët krejt dëshirë.

E kam menduar për më tepër...
Se më mungon diçka, jo, kurrë!
Më e bukur u bëre dhe pse e vjetër,
Kur në ballkon vendosa një flamur.

S'më ka munguar në shpirt patriotizmi!
Mburresha me të qenurit Shqiptar.
Thjesht për një lloj indiferentizmi...
Flamuri në ballkon, më shumë krenar!

NJË PËRSHËNDETJE

Në mërzinë tënde shkruaj poezi,
Heshtjen e ktheva në këngë e muzikë.
Në mos mirnjohjen tënde rris dashuri,
Dhe në fund të fjalisë, vendos veç pikë.

Për të lëvizur një peshë nga vendi,
Për levën duhet një pikë mbështetje,
(Kështu thotë në teori Arkimedi)
Në mugesën e saj, një përshëndetje!

Nga pritja e gjatë thahen lulet,
Tik-taket e orës numërova në vetmi,
Në rrugën e jetës ti pikat i shkule,
E rëndë urrejtja që lind një dashuri!

NË SHKODËR

Me një hartë mes për mes Shkodrës,
Shënoja rrugët, emërtimet e reja
Stilolapsi i bindej ekzaktësisht dorës
Si urdhri i komandës në beteja.

Krejt gëzim po ecja në këmbë,
Detyrë çdo rrugë me e shkelë,
Mrekullia sytë m'i ka zënë,
Kur para meje një burrë më del!

"A mund t'ju ndihmoj, të lutem"?
Se në çdo rrugë, ku s'të kam gjet,
Isha te pazari, dola për bukë,
E ju në këmbë, unë në biçikletë!

Të falenderoj me zemër, sinqerisht
Po punoj për hartën e qytetit tuaj.
Te "Kafja e madhe", një kafe miqësisht
Asnjë çast nuk u ndjeva i huaj.

MOS I GRIS FOTOGRAFITË

Fotot që dolëm bashkë, mos i gris!
As ata ku jam unë si fotograf.
Në Orikum bregdetit jemi nisur,
Poezitë mos i kthe në epigraf.

Të kujtohet lokali i bukur me drita?
Sa dolëm nga rëra në asfalt,
Aty te tabela qëndrova e prita,
Të nxirrje nga çanta një aparat.

Më bëje foto e unë të fotografova.
Të dyve na bëri një plazhist,
Aq shumë më shtrëgoje e t'u afrova,
Sa aparati dy herë bëri blic!

Nga karta e memories mos i fshij,
Pak grindje kanë gjithë dashuritë.
Në memorien tonë, jemi po aty...
Pse s'i kemi në dorë fotografitë?

FOTO ME LASGUSHIN

I nderuar poet, po të lutem,
Dalim së bashku në një fotografi.
Të pret Kuteli? Ja, po ngutem,
Aparatin e ka gati çupka Sofi.

Dhe një tjetër, se me të vërtetë,
Të rri pranë teje ndjehem mirë.
Sofija më pyet: Mos jeni poet?
Të ngjaja, sadopak kisha dëshirë.

MOZAIK

Për herë të parë,
Duke shikuar bukurinë e vajzave,
Provova ndjenjën e dashurisë.
Nga ajo ditë,
Harrova lodrat e fëmijërisë.

Çdo të dielë,
Në ballkonin e shtëpisë tënde,
Rrobat e lara hedh në tel.
Unë dal e shikoj,
Po ti, për mua del?

Zbardhen flokët nga vetmia
Në zemër pak ngricë,
Në humba ditë
Nga vitet e mia...
S'kam faj unë, o shpirt.

Kur ma rrëmbeve zemrën,
Më erdhi mirë.
Gjithë natën isha me ty.
Mos isha në ëndërr?
Jo, gjumi nuk erdhi në sy!

Gryka e Drinit më rreshku fytyrën,
Puthur me erën e vesën.
O Zot sa shumë i besova femrës.
(S'di gjë për ju të tjerët)
Pa ma dhënë, jua dhashë besën.

Një grua në lagje mbjell shamatë,
Helena e Trojës a e fitoi luftën?
Eh, si është puna e femrës...
EVA gënjeu ADAMIN...
Njeriu shpiku pushkën!

Më joshi bukuria e femrës
Pastaj më braktisi një ditë.
Kur kisha më shumë nevojë.
Kështu ndodh dhe në politikë
Jo, jo nuk e provoj...

Meraku, syth që çel dëshira
Por dhe mund të thahet..
Kur mban ngricë.
Le të bëhet më e mira
Nga hiçi, lind një hiç...

Nuk të jap mend..
Po mëso nga gabimi,
Për vete gjithsesi
Çdo njeri e ka një vend.
Në ferr apo parajsë, askush s'e di!

S'ka vend në Sharrë,
Dhe Tufina në të sosur...
Ç'kronikë e marrë...
Njerëz, jetoni jetën!
S'ka mbetur njeri pa varrosur...

U ngjita në lartësi deri në Korab,
Për më lart, kam pasur dëshirë.
Nëse ngela pak poshtë,
Kaq ish shkruar në fat!
Por, më mirë në tokë, se në hapësirë.


Në livadhin e jetës kërkova një lule.
Nga cepi në cep e dola në breg.
Mua m'u duk se mbeta pa gjë?
Nuk e di, ju betohem...
Se si në dorë më kish mbetur një!

Ndarja,
Nuk është humnerë e fikjes.
Unë në rrugën time,
Ti në rrugën tënde.
Të dy,
Në rrugën e ikjes.

Ty t'u gris fustani?
I thuaj burrit, e grisi ferra.
Do të të blej një tjetër,
Me lule të bukura,
Sa të vijë Pranvera!

Në rininë tënde,
Ke pasur shumë lidhje.
Dhe asnjëherë e dashuruar.
Vëllai të martoi me një tjetër!
Nga mungesa e dashurisë,
Mësove se si me tradhëtuar.

Njeriu i dashur, që u shkri si qiriu për pesë fëmijët, u largua përgjithmonë nga kjo botë e amshuar. Por, përse vallë të ndodhë kështu me njeriun më të shtrenjtë të jetës? Përherë punëshumtë dhe e unshme për dashurinë e fëmijëve dhe të natyrës.



Aromë fshati. *Pikturë nga Zaim Elezi.*
Vaj në kanavacë. Dimensionet: 70 cm X 60 cm.

Për porosi:
Kontaktoni në email: zaimelezi@gmail.com

Nana

Nga **SELMAN MEZIU**

Fshati i lindjes ngrihesh mbi një pllajë. Mali i Kunorës qafa e Prates, Runjat e rrethonin me shpatet e tyre të pjerrëta. Përroi Artatus gjarpëronte përmes honeve të thella prej shkëmbinjve gëlqeror e ndonjë shkurreje që mbijetonte tragjikshëm. Babain mezi mbante mend. Gjaksori e vrau në Xharxhisht nën sytë e saj. Ajo qau edhe u la në lotë dhe me stërkalat e gjakut të tij. Ndërsa ai u zhduk për të mos u dukur ma kurrë.

Ishte e zgjuar sa s'ska. Shkronjat ia mësuan me një abetare që kurrë se pa. Mësuesi rrinte ulur në një shkam në odën tjetër. Ai shqiptonte secilën prej tyre dhe ato e ndiqnin me zërin e tyre pak timbrues por plotë vrull cucnie. Ishin rrezatimet e purpurta të diturisë. Këto kërkonin hapësira njerëzore, rizgjimin e tyre dhe...

Sytë i kishte të vegjël, por të ndritshme e të gjallnueme. Ashtu me plotë dëshirë e hap pas hapi ajo filloi të bashkoi shkronjat e të lexoi. Koha kalonte dhe një ditë kryetari i këshillit te fshatit, Aliu, i thotë mixhës, që kishte një pale mustaqe si kacadre:

- Cuca juaj do të filloi të jap mësim një grupi grashë e vajzash të fshatit tonë.

Ai e pa nga maja e flokut te thonjt kamëve dhe i tha duke shkundur çubukun e duhanit në shollën e këpucëve të thesit:

- Po si kështu një vajzë të mësoi të tjerat, kjo s'ka nodh kurrë këtej nga ne. Ah sa për meshkuj po!-u përgjegj Nexha, disi i shqetësuar që i shikohej në pamjen e fytyrës.

- Kohët kanë ndryshuar, dhe neve na duhet të ecim me hapin e sajë, përndryshe... Dhe u largua me hap të shpejtë drejt zyrave. Duke menduar se kalanë e mentaliteteve të vjetrueme, e kishte marrë.

Vazhdoi puna në një dhomë përdhese, ku vajzat uleshin në copa trungjesh. Vitet kaluan dhe ajo doli nuse me dullak të kuq në kokë. Nuk e shihte rrugën e mjera mësuese. Ku ta çonin krushqit dhe kali me shalë. Forca e zakonit ishte akoma e pathyeshme. Pse jo e pa shkelshme.

Edhe i shoqi ishte mësues, kishte kryer një kurs në Shkodër. Sa e gëzueshme ishte kur lindi fëmija i parë. Ajo si nanë iu kushtua familjes e tëra me mëndje, sjellje, edukim e si zonjë shtëpie. Si bareshë edhe si mësuese ajo kishte mësuar për bimët, kafshët, shpendët, në dy mënyra me të dëgjuar e diçka edhe metë lexuar. Kujtesën e kishte të plleshme.

Djalit, pa bamun gjashtë muaji i doli një lung në fyt. Ajo iu fry, më pas i skuqet. Nuk vonoi dhe filloi t'i rrjedh qelb. Fatkeqësisht i formohe një vrimë. Ai u dobësua e u ba si krande e thatë. Çfarë pinte nga sisa e sajë, rrithte si një burim, e derdhesh në kraharor e i binte në lirek. Çante pa pushue, ndoshta nga uria, ndoshta nga dhimbja. Kush e dinte?

Një natë ajo mori guximin dhe i tha të vjehrrit:

- Ma leni mua, se e shëroi vetë Albanin – i foli me një za të shqimur por disi e sigurt. Kokën e mbante të ulur e sytë përtokë.

- Ku dini gja juve, flokë gjata e mëndje shkurtra – iu përgjigj ai duke i folur me një ton të ashpër e përçmues.

Të nesërmen ajo mori gjethet e filizave të reja të fermanëve, i lau me ujë të nxehtë, iu vuri gjalpin e freskët dhe me një beze pambuku ia vuri te fyti. Albani mezi merrte frymë dhe sytë i mbante më të shumtën e ditës të mbyllur.

Kaluan ca ditë dhe vjehërri i gëzuar dhe si gjel kaposh e thërret:

- Kam takue të një mjek popullor, Dina i thonë ai më këshilloi...

Nana e priti sa mbaroi. Buzëqeshi, i hodhi sytë dhe me urtësi e delikatesë i shprehet:

- Më falni por unë kam disa ditë që ia kam bamun, dhe voci e ka marrë veten. Hajde e shikoje!

Zani i sajë tashma ishte ma i plotë dhe kumbues.

Ai u afrua, ia zgjidhi fashën e pambuktë. U befasua! Plaga po i mbyllesh, shërohesh. Ai mori mundimin dhe ia ndërroi, duke i vumun të gjitha të freskëta gjethet, gjalpin etj. Diçka murmuriste me vete, ku shikohej nga lëvizja e buzëve të holla, paksa të skuqura.

Fëmijët i erdhën të shpeshtë. Çdo dy apo tre vjet një. Ato rriteshin si bari në maji. Por çe don, jeta u vështirësua së tepërmi. I shoqi tanimë nuk punonte mësues, por si bujk. Të ardhurat për ditë pune ne shoqërinë e punës të organizuar, që quhesh, kooperativë, ishte shumë e vogël. Mezi u nginte barkun me bukë thate, ndonjëherë qumësht apo...

Krahas ditës së punës ajo dilte e mblidhte lulet, frutet, gjethet apo rrënjët e disa bimëve. Ato quheshin bimë industriale, se shkonin dhe përpunoheshin diku larg. Nxirreshin prej tyre esenca. Dalë ngadalë edhe kjo u bë një punë familjare. Ndërsa për nanën një punë me plotë pasion e burim të ardhurash. Edhe pse e lodhshme sa s'ka e mbi të gjitha pa orar.

Arbëri u rrit e do të shkonte të shkollohej në qytetin ku kishte mësuar babai. Ishin kohë te ngarkuara me orteqe vështirësish. Udhëtimet ishin me makina rasti. Në karroceri, ku ngarkohesh zhavorri, kromi, bakri etj. Kjo ndodhte në muajt Gusht apo në Janar. Ajo i bleu një shall me breza të zinj e të verdhë. Ia futi në një gjysmë gazete dhe i tha:

-Ta ka blerë nana për të mbajt ngroft qafën e fytin. Asht Janar ky, dhe në Qafën e Koxhaxhikut të pret të ftohti.

- Faleminderit nanë, jeni shpirt njeriu, ndërkohë iu hoth në qafë duke e përqafuar e puthur. Ndodhi që për të marrë makinën për Milot u desh të priste, jo pak por plotë shtatë orë. Shalli shërbeu si varka e Noes për Albanin. E kjo mendoi ai ashtë meritë e nanës sime që s'do ta shohë së paku për gjashtë muaji.

Shpesh ajo në bisedat për jetën e vështire e punë shumtë përdorte shprehjen:

Na duhet me jetue si krimbi në gurë

Apo kur prisnin dëllinjën apo shtogun, tranafilin egër etj ajo thoshte: *Mos e pre se idhimset gurit e drunit, asht qenie me shpert.*

Në bisedat e ndryshme ajo ishte bërë tanimë njohësja e shumë bimëve. Dinte kur lulëzonte, kur piqeshin frutat, kur mblidheshin si thaheshin, për sa kohë etj. Ju njhte çmimet dhe bante llogarinë si nja ma e mira.

Domosdo kishte qenë mësuese. Jeta kishte gurgulluar e furishme plote ëndrra vuajtjesh, lodhjesh, cfilitjesh. Ato kishin lanë tanima shenja në trupin e sajë, në mendime, veprime e sjelljet me njerëzit. Por në gjirin e natyrës ajo gjente qetësinë, punën të cilën e bante me kënaqësi. E mbi të gjitha të ardhurat për ti çuar fëmijët në shkollë e rritur së paku si bashkëfsharët e vetë. Pse jo për ti martuar siç na ka hije ne dibranëve.

Kohërat ndryshuan, fëmijët morën udhët e botës. Ajo e lëshonte kokrrën e lotit sa një thanë kur largoheshin për në kurbetin e zi. Gëzohesh me gjithë shpirt kur ktheheshin. Ajo shpesh iu thoshte:

- Ju po rrini shumë pak, nuk u ngopa nana nji herë me juve. Njëkohshëm, fshinte lotët me shaminë që mbante vazhdimisht në xhepin e xhaketës së zezë.

Edhe pse mosha e kishte dobësuar fizikisht, asaj nuk i zinin kamët ven. Malin e ndiçte, e kërkonte, lopën e ushqente fëmijët e fëmijëve ju përkundte djepin, i lante ne koritën e drujtë. Por atë natë ajo ndjeu një dhimbje në kraharor. Diçka e shtrënguonte dhe e lironte. Piu kafenë e mbramjes dhe u shtri mbi divan.

Arturi katër vjeçar i rrinte pranë. Askush tjetër nuk kishte mbetur në shtëpi. Kjo kohë me tajfunet e saja të egërsuara ia kishte degdisur kushedi se ku. Ajo kapi dorën e vogëlushit e shtergoi fort me të sajën. Dukesh sikur po i linte stafetën. Apo trashëgiminë e virtyteve ma të mira njerëzore. Apo...lamtumirën e fundit... Te paktën njërin djalë, apo gocë, të kishte pranë që ti vinte dorën në ballë. Më pas gjyshja ia lëshoi dorën, vogëlushit. Ai sa hap e mbyll sytë, fluturoi jashtë derës, duke thirrur:

- Nana, baba hajdeni se gjyshja ka mshel sajun. Zëri i tij mbarte dhemshuri feminore. Fytyra i kishte marrëpamje tjetër.

Kështu, njeriu i dashur, qe u shkri si qiriu për pesë fëmijët u largua përgjithmonë nga kjo botë e amshuar. Por përse vallë të ndodh kështu me njeriun më të shtrenjtë të jetës? Përherë punëshumtë dhe e unshme për dashurinë e fëmijëve dhe të natyrës.

Rruga e Arbërit nr. 85

Në kujtim të mikut të gazetës "Rruga e Arbërit", Prof. Dr. Arshi Çela

homazh

Kafeja e fundit

Nga **HYSEN UKA**

"- Hë, doli gazeta "Rruga"..., "Ka ndonjë gjë, Shaban Sinani, po Tufa ka ndonjë gjë... Agron Tufa ka poezi brilante. Më kanë pëlqyer shumë edhe alegoritë e Naim Plakut... profesori pyeste vazhdimisht, që kur unë isha bërë unë shkesi për njohjen e parë të tij me gazetën "Rruga e Arbërit".

"Ka shkrime shumë të mira gazeta juaj... "Kam dëshirë të përgatis diçka për këtë gazetë... Kam një ngasje për një sprovë sociologjike. Më ngacmon larmia origjinale e besimeve fetare në krahinën e Dibrës. Kam idenë se është unikal rasti ku në një familje, nën një çati, njëri vëlla është katolik, tjetri mysliman, festojnë edhe Pashkët, edhe Bajramin... Nga ana tjetër, ka edhe ortodoks dhe respekti i ndërsjellë ekziston dhe atje... është një harmoni që të habit, që duhet të ketë prodhuar edhe shumë vlera të tjera, që nuk mund të gjenden në mjedise tjera. Është një lëndë origjinale sociologjike... I cekte herë pas here këto fakte profesori dhe kuptohej se po mbushej për të shkruar diçka për gazetën rreth kësaj teme... Është njëri nga pengjet që profesori ka marrë me vete...

* * *

Kthehesha pas kaq kohësh, tek kafeja jonë e zakonshme "*Number One*". Zonja e lokalit, me zërin e dridhur, më pyeti:

"- Është e vërtetë që ai shoku juaj që vinit mëngjeseve për kafe, ai flokë thinjuri...

- Po, e vërtetë – ia ktheva unë me zërin që m'u drodh... Profesor Arshiu nuk do të mund të vijë kurrë më, në kafenë e këndshme "*Number One*". Ai iku, iku shpejt, krejt pa pritur, përgjithmonë...

Unë kthehesha te kjo kafe, pas shumë kohësh, që nga ajo kafe e fundit me profesorin....

Ishin ato ditët e zymta, të angështa, që përpiqesh me vështirësi t'i harrosh...

Krejt pa u ndjerë, atë mëngjes të fundshkurtit apo ditën e parë të marsit, ndryshe nga herët e tjera u hap lehtë dera e zyrës së Departamentit dhe, siç bënte zakonisht, erdhi e më qëndroi mbi kokë, profesor Arshiu... Unë kisha "marrë yryshin" mbi tastierën e kompjuterit tim, duke shtyrë përpara mizërinë e shkronjave që brazdonin në pllajën e bardhë, e "zbritur në tokë djerrë të fletës së bardhë" disa mendime të mijat... Kur të gjente të mbërthyer me tastierën, profesori nuk e përdorte asnjëherë pyetjen: "Çfarë po shkruan?" Ai i njihte dhimbjet dhe magjinë e të shkruarit, nevojën e intimitetit dhe të qetësisë që kërkon ky akt i shenjtë, i cili është ndër më të ndritshmit në gjerdanin e dhuratave që natyra i ka bërë njeriut, krahas të folurit, aftësisë për të mësuar e për të ditur, ku e shkruara është lënda me të cilën njerëzimi ka ndërtuar magazinat e dijeve dhe të përvojave që t'i shërbejnë atij për të ndriçuar e kuptuar sa më larg në të ardhmen e tij dhe për ta ndërtuar atë sa më të mirë.

Pasi kish ndjerë vibracionin pozitiv që kishte krijuar prania e tij në atë mjedis, bënte pyetjen e zakonshme: "A është koha për një kafe...?".

Ardhja e profesorit për ritualin e kafes ndodhte zakonisht, pasi u kishim hedhur një sy gazetave elektronike të ditës apo pasi ishim mbushur me ndodhi nga ato të zakonshmet që ka jeta politike shqiptare... Sigurisht, kjo për profesorin, një duhanxhi i thekur, nuk ishte kafeja e parë... Kafeja e parë i takon mikut tim të vjetër, duhanit, - thoshte profesori, - dhe kafeja e dytë është e kënaqësisë së muhabetit me shokët... Ne, shokët e tij, dyshojmë fort se ai miku i vjetër, duhani, e preu në besë mikun tonë Arshi. Duhani, duke ju shtirur si mik, iu përvodh nëpër trup dhe i mbolli të keqen, i mori frymën dhe e ndau nga ne...

Atë mëngjes, mua, tek prisja ritualin



Në foto: Nga e majta në të djathtë: Shpëtim Idrizi, Arshi Çela dhe Hysen Uka, para mjediseve të Universitetit "Illyria".

> Kam dëshirë të përgatis diçka për këtë gazetë... Kam një ngasje për një sprovë sociologjike. Më ngacmon larmia origjinale e besimeve fetare në krahinën e Dibrës. Kam idenë se është unikal rasti ku në një familje, nën një çati, njëri vëlla është katolik, tjetri mysliman, festojnë edhe Pashkët, edhe Bajramin...

e zakonshëm, më bëri përshtypje ftesa e asaj dite: "Duhet ta pimë një kafe...!" Ngrita kokën ta shoh, pasi forma imperative e tij, mekja dhe drithërima e zërit të tij, nuk më nxiti kënaqësinë në lojërave të përditshme me fjalët, nuk më la në qetësinë e reagimit të zakonshëm... me humor dhe për atmosferë... Drita e mekur e atij mëngjesi, që rrëshqiste nga kurrizi i murrmë i Dajtit të heshtur, që ende nuk kishte dalë nga mpirja e dimrit, e bënte të mpitë e të vagullt atmosferën në zyrën tonë. E thinjura e flokëve sikur i kishte rrëshqitur mbi fytyrë, i kishte hyrë nën lëkurë dhe profili i tij, ndryshe nga ç'e kisha parë prej kohësh, atë ditë më ngjalli ndjesinë e një skulpture nën shi dimri, të ngurtësuar e të murrëtyer ...

Dhe mënyra si u largua, pa më lënë të bëja lodrat e mija të fjalëve, më krijoi ndjesinë se ai ishte në një hapësirë tjetër kohe dhe se koha për atë nuk kishte të njëjtin kuptim që kishte për mua, për ne... Grija e flokëve, grija e shpatulla të mbështjellë me pallton e atij funddimri apo prag pranvere u shformuan, humbën në errësirën e korridorit... duke më lënë mua barrën ta ndiqja pas...

"Duhej pirë një kafe!" Ky ishte një detyrim, një detyrim që ndjejmë kur duam të pimë një kafe ngushëllimi... pa më lënë kohë të përgjigjesha si zakonisht:

"Me kënaqësi profesor"! Unë vërtet e kisha gjithmonë kënaqësi të pija kafe me profesor Arshiun. Shprehja e kënaqësisë nuk ishte nga ato etiketa të kortezisë që me kohë humbasin shkëlqimin nga përdorimi i rëndomtë, duke u bërë artifica, për të cilat edhe vetë nuk je i vetëdijshëm: e thashë apo nuk e kam thënë, dhe kur e kam thënë... Realisht dhe vërtet, në të gjitha herët që kishte ndodhur, kafeja me profesor Arshiun kishte qenë kënaqësi... Miqtë e tij të shumtë, që i ruajnë kujtimet e kafeve me të, mund të më gjykojnë për këtë... Kafeja me të kishte humorin, lezetin, por mbi të gjitha mendimin...

Ishte njëri nga ato mëngjeset e fundshkurtit, ku drita hyn si e përgjumur apo e ka të vështirë të shtyjë amullinë dhe plogështinë e letargjisë dimërore, rrëzohet nëpër luspat e përhimëta të sytheve ende të paçelura e tek-tuk nëpër kodrina në puhizën e mimozave trazohet me të artën e vileve të çelura për të dhënë pak drite të përzier me mall. Ishte një nga ato mëngjese kur ende mjediset e ngrohta të joshin dhe njeriut ia ka ënda të jetë njëkohësisht edhe jashtë, edhe brenda...

Dhe profesor Arshiut ato ditë nuk i rrihej askund, sidomos brenda, mjediset e mbyllura e shqetësonin, kishte një dëshirë ta mbajë kokën lart, gjë që e bënte me shumë mundim, kishte dëshirë të ecte, të ecte, vetëm të ecte... Të fliste, edhe pse heshtja i rëndonte gjithmonë e më shumë mbi shpatulla, me peshën e saj të rëndë duke ia mekur zërin... Ai kishte dëshirën të ikte, të ishte jashtë, sepse po e ndjente se kishte afër ndrymjen e madhe, përtej derës së dheut që s'të lë kurrë më të dalësh jashtë... të fliste, të fliste deri në belbëzimin e fundit, ai që fjalën e kishte të shenjtë...

Dhe krejt pa e kuptuar, atë ditë pa ngjyrë, pa fillim e pa mbarim, të papërcaktuar... kishim zënë vendin në tavolinën dyshe në kthinën e vogël të kafes "Number One"... ku vëmendja dhe respekti i zonjës së lokalit dhe kamarierëve nuk na kish munguar asnjëherë... Kishim shijuar në këtë kthinë të këndshme, në tavolinën e vogël dhe dy kolltuqet e rehatshëm, sa e sa herë në këto dy vite të punës me profesorin, kafet e mëngjesit dhe lezetin e bisedave "improvizimeve filozofike". Sa e sa herë kishim diskutuar aty për ngjarjet politike të ditës, për librat, për filozofët, Hegelin, Kantin, Rasell, Hobs e shumë e shumë të tjerë, (të folurin rreth të cilëve ai e kishte art, me të cilin ai u ka krijuar kënaqësi të pafundmë studentëve, për ngjarjet e zhvillimet ndërkombëtare... Kohët e fundit kishim folur shumë edhe për librin e Xhelal Staraveckës dhe të Arben Putos. Por, të zbukuruara këto tregime me humor e barcaletat e pashtershme të profesorit, për të cilat dukej se ishte i lindur... i tipizonte personazhet edhe me dialekte... më bënte të qesh me shpirt... kjo ishte një nga dhuntitë e prof. Arshiut... Me orë e me ditë kishim diskutuar për mësimin dhe studentët tonë të shkencave politike e të drejtësisë, me të cilët kishte ndërtuar një raport të mrekullueshëm.

Edhe atë ditë, në atë kafenë e fundit, nuk harroi të më fliste për studentët... madje që në fillim... për "Sociologjinë politike", që nuk do të kishte mundësi ta jepte më për grupin e studentëve të vitit të parë të Shkencave Politike... për Ajlën, Erindin, Fildesin... studentët që i mbushnin jetën... dhe vetvetiu i mbushej fytyra me dritë, përpiqej të buzëqeshte, por shpejt, hija e të keqes brenda tij skërmitej dhe ia mpakte buzëqeshjen e mundimshme në cep të buzës...

Ishte një kafe e mundimshme... ishte një ngricë që i vinte nga brenda... një ngricë që i kishte rrethuar shpirtin, që e cimbiste në zemër...

Atë mëngjes qenia e tij ishte shumë përtej syve, buzëve, flokëve, trupit e fjalëve të tij... Atë mëngjes ai nuk ishte më në trupin e tij, por ishte strukur diku larg, duke kundruar veten në një botë ku kishte pllakosur të ftohti, ngrica... atë ditë atë e kish marrë peng një tjetër vetvete, e cila lodronte me mundimet e tij dhe përpiqej ta mposhte, ta ligështonte, ta nënshtronte, ta përulte, t'i merrte krenarin, dinjitetin...

Profesori mundohej të mbahej ende në këmbë, ta bënte të gjallë, të hijshme e të qeshur atë veten e strukur... për respekt të ndjesisë së asaj kafeje, të një shoku, të një miku... por, me shumë mundim...

Ai kishte ditë që jetonte me dhimbjen e gjërave që rrëzoheshin, që binin e thyheshin brenda tij, (dhimbja për Lonën, djalin, grua e mbetur vetëm, vëllezërit, miqtë, shokët dhimbja shqetësimi dhe meraku në fytyrën e tyre... librat, planet kërkimore, konferencat, Habia filozofike,...) por duke u përpjekur me shumë mundim që poterja, alarmin e gjithë atij rrëmeti që ndodhte brenda tij, brenda thesit të lëkurës së tij... tashmë të sulmuar egërsisht nga të gjitha anët, nga thonjtë e sëmundjes së rëndë, e cila ish sulur mbi të fundmen gjë ku njeriu falet, ikonën e shpresës, për ta rrëzuar e thyer, copë-copë... Dhe në tërë këtë betejë ai përpiqej të mos i dilte jashtë asnjë tingull i dhimbjeve të atyre thyerjeve, në atë betejë të pabarabartë, të mbante brenda lëkurës së tij, të mbyste në honet e shpirtit të tij çdo tingull e psherëtimë...

Dhe për aq kohë ia kishte dalë të qëndronte, të mos jepej të mos mposhtej, të ruante kockën e shpirtit edhe pse trupi po i rrënohej... po i shkrihej... një ditë më parë sëmundja kishte prishur çdo urë marrëveshje me profesorin... ajo nuk kthente, nuk tërhiqej pas... kish vendosur, egërsisht, pa mëshirë, ta rrëmbente, duke e detyruar që ai duhet të pranonte prishjen e marrëdhënieve me këtë botë...

Profesori e kishte pranuar me stoicizëm këtë, pa u grindur, pa u ligështuar, pa lypur mëshirë, as lutje e falje, pa u zemëruar dhe pa e marrë as inat, por thjeshtë duke u sjellë si akulli me të ftohtin...

Tashmë luftonte të kuronte kujtimet, ato të do t'i linte mbrapa, ato që do t'u linte të gjallëve, që ata ta kujtonin me krenari dhe me dashuri për të cilën profesori dukej që mundohej ta marrë sa më shpejt me vete, të mos e lërë shumë në mes të njerëzve të tij, që të mos i mundojë shumë ata...

Atë mëngjes, domosdoja e profesorit se "duhet të pimë një kafe" kishte si shkak pikërisht njoftimin për prishjen e kësaj marrëveshje, marrëveshjes me këtë botë... dhe për të më lënë të kuptoja se ajo ishte kafeja e fundit... siç dhe qe në të vërtetë...

Unë, duke ndjerë erërat e akullta, cimbisëse që shungullonin brenda honeve të shpirtit të tij, mundohesha të mbush kohën me biseda, duke prekur nëpër të gjitha vazot e bisedave tona të dikurshme, ku mbërtheheshim e përfshiheshim në diskutime e debate pasionante, nga të cilat harronim të dilnim... duke u përpjekur të krijoja ndjesinë e të zakonshmes, të dëboja pezmin që krijonin shqetësimi dhe dyshimet... Profesori e kuptonte situatën dhe përpjekjen time të mundimshme për "asgjënë e gjësë" dhe, duke buzëqeshur, e mbërtheu veten në një qetësi solemne, foli qetë e shkurt, duke i renditur fjalët shkoqur...

Thashë të pinim këtë kafe, sepse, ndoshta... nuk do të kemi më mundësi të pimë kafe së bashku... Unë nuk do të vij më në shkollë... Im vëlla ka këmbëngulur të më marrë me vete në Itali, për të hequr merakun, për disa ekzaminime... Unë nuk dua t'ia prish, por e di kjo nuk ndryshon gjë... kjo ka marrë fund... të paktën të rrimë ditët e fundit bashkë... kemi shumë mall të patretur, e kemi gur në zemër... më shumë larg, më shumë vetëm... Ah, kjo kohë kurbeti... më mundon shumë koha që më kanë munguar njerëzit e dashur, vëllezërit, fëmijët... M'u intereso për Astritin... Ajo që lus, ajo që do të doja është që të mos më mundojnë shumë dhimbjet, të mos kem dhimbje të forta... dhe të më lënë mundësinë deri në fund të mund të lexoj... Faleminderit për të gjitha kafetë dhe orët që kemi ndenjur bashkë... Tani më duhet të iki... Jashtë më pret vajza dhe gruaja, dhe Astriti... nuk desha të ishin këtu kur të bënim këtë bisedë...

Unë nuk di ç'fjalë kam thënë, veçse kujtoj se mugëtira e asaj dite erdhi shumë shpejt dhe atë natë pothuajse nuk kam fjetur fare... Kisha një boshllëk në shpirt. Kishin lëvizur shumë gjëra brenda meje pas asaj kafeje... më dukej sikur të gjithë njerëzit ecnin të mpirë, sikur tek secili kishte pezëm, kishte dhimbje... dhe ata më dhimbseshin të gjithë... më duket se të gjithë udhëtonin në të njëjtën rrugë...

Si është njeriu... Sa pak i njeh ai skutat e tij... sa pak kujtohet të shohë brenda vetes...

Fjalët burrërore të një shoku, një miku, nuk më linin të qetë, më kumbonin në vesh ngado vërtitesha në atë trazim të pazakontë... të një miku që u kujdes të lërë tek unë imazhin e burrit të fisëm deri në fund, imazhin e atij që largohet nga kjo jetë si një njeri që e ka merituar atë... dhe ua rikthen atë në formë kujtimi të gjallëve që i ka dashur...

Profesor Arshiu erdhi pa u ndjerë dhe më kërkoi të pinim "kafenë e fundit". Hapi lehtë derën e zyrës sime atë fillim marsi... dhe sot me 23 prill, iku... duke na kërkuar shërbimin e fundit, ta përcillnim deri në pragun e derës së rëndë të tokës, e cila, pasi e futi në gjirin e saj, e mbylli përjetësisht brenda, çelësin e të cilës nuk e ka gjetur kurrë askush.

* * *

Faleminderit profesor Arshiu, që u kujdese deri në frymën e fundit të na lësh kujtim profilin e qeshur dhe fisnik, shembullin se si duhet të jetohet jeta dhe si duhet të largohemi nga kjo botë, hijshëm, dinjitozë dhe pa u ligështuar...

Të qoftë e lehtë udha e përjetësisë! U prehsh në paqe e paç vendin në parajsë...

kujtesë



Myslim Koka, miku i të gjithëve

"Në shtëpi kemi një dhomë me libra, kemi shumë dorëshkrime. Ka mjaft shkrime për historinë e Dibrës dhe në veçanti të Reçit..."

Nga **SHAQIR SKARRA**

Kisha dëgjuar shpesh herë të flitej mes miqve e shokëve për intelektualin e njohur dibranë Myslim Koka, por puna ime e gjatë jashtë rrethit të Dibrës nuk ma kishte dhënë këtë mundësi ta njihja nga afër, të pija qoftë dhe një kafe të vetme. Them nuk e kam patur fatin se ashtu siç më thonë sot është humbje të mos takoheshe e bisedoje qoftë dhe për pak minuta me Myslim Kokën. Rreth portretit të tij, për aktivitetin në qytetin e Peshkopisë si dhe në fushën e mësimdhënies mësova vonë kur erdha me banim në Tiranë.

Myslim Koka u lind në Kraj Reç të Dibrës në një nga zonat më të thella më 20 tetor 1938, në një familje të njohur për atdhedashuri dhe patriotizëm. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, por i etur për dije, vendlindja nuk mund t'ia plotësonte dëshirat Myslimit, atëherë në moshë të vogël për arsim. I mbetur jetim që në fëmijëri, dëshira e vëllait më të madh ishte që Myslimi të qëndronte pranë familjes dhe të mos vazhdonte më shkollë për më tutje ashtu siç pretendonte. Vazhdoi një kohë e gjatë që filloi të kulloste bagëtinë e me vete gjithmonë merrte librat dhe lexonte në mënyrë të pavarur. Pasi e vendosi vetë një natë më parë, Myslimi nuk i nxorri atë mëngjes bagëtinë në kullotë, por u largua i vetëm nga fshati me dëftesën e notave të shkollës fillore në xhep pa e ditur as vetë se ku do ndalonte, mjafton të ndalej në ndonjë qytet ku mund të arsimohej më tej. Duke ecur ditë e natë, duke fjetur jashtë në male por dhe lulishte qytetesh pas disa ditësh e pa veten një mëngjes në qytetin bregdetar të Durrësit.

Nuk kishte asnjë lloj baze ku të qëndronte, nuk kishte asnjë të njohur që t'i drejtohej për ndihmë. Këmbët e çuan tek e para shkollë 7 vjeçare që hasi. Drejtori i shkollës e pa djaloshin nga Dibra të lodhur nga rruga e gjatë, por të vendosur për të vazhduar shkollën njëkohësisht edhe me dhembshuri, por dhe me simpati për këtë vendosmëri që tregonte dibrani në qytetin e Durrësit të pa njohur ma parë. I mori dëftesën e notave dhe me ndërhyrjen e miqve e shokëve që kishte e ngriti në moshë me qëllim që ta regjistronte dhe në konvikt, pasi ishte i vogël. Kështu vazhdoi Myslim Koka shkollën shtatëvjeçare si dhe të mesmen ku doli me nota të shkëlqyera. Myslimi ishte një nxënës shembullor jo vetëm në mësime por dhe në sjellje, dhe në marrëdhëniet me të tjerët. Pas përfundimit të shkollës së mesme i doli e drejta e studimit në Universitetin e Tiranës, dega Histori-Gjeografi dhe më vonë do të vazhdonte për Pedagogji-Psikologji.

Tashmë ëndrra e kahershme e Myslim Kokës bëhet realitet dhe kthehet në Peshkopi i plotësuar mirë nga ana arsimore, por dhe si një intelektual me perspektivë në të ardhmen. Fill pas mbarimit të shkollës së lartë e emërojnë mësues në shkollën e Zalldardhës e vetëm pak vite ma vonë do të transferohej në shkollën e Limjanit.

Sot jo vetëm ish nxënësit e tij, por dhe fshatarët e këtyre zonave por dhe ish koleg flasin me respekt për mësuesin e atyre viteve Myslim Koka. Duke parë punën e shkëlqyer në mësimdhënie seksioni i arsimit të rrethit e trasferojnë Myslimin në fillim drejtor në shkollën tetëvjeçare "Demir Gashi" më vonë po drejtor në gjimnazin e qytetit "Said Najdeni" si dhe po drejtor në shkollën pedagogjike. Kudo Myslimi punoi me përkushtim dhe profesionalizëm dhe në të gjitha shkollat që drejtoi në ato vite ka patur rezultate të larta në fushën e mësimdhënies. Duke patur një kolektiv mësuesish të talentuar si Qani Përtafi, Mufit Trepça, Safet Zhulali, Fadil Kaca, Lavdrim Kaba, në ato vite gjimnazi i Peshkopisë radhitej ndër shkollat e mesme të përgjithshme më të njohura në shkallë vendi. Dhe ka mjaft ish nxënës që sot punojnë në sektor të ndryshëm të ekonomisë të flasin me nderim dhe respekt për Myslim Kokën jo vetëm si drejtues por në radhë të parë edhe si njeri, edhe si kuadër, edhe si mësimdhënës me një përvojë të gjatë.

Portreti i Myslim Kokës domosdo që bëhet më i plotë e merr të tjera përmasa kur punoi për gjashtë vite me radhë në ish kooperativën e Luznisë sekretar i byrosë partisë. Bajram Krashi ish kryetari i kësaj kooperative në ato vite ruan ende shumë kujtime të bukura. Për Myslim Kokën. Puna në Luzni ishte si gur prove por ai si njeri i sakrificave e kaloi bukur dhe këtë provë të vështirë. Pikërisht në këto vite në Luzni, 'lufta e klasave' ishte krejt amorfe, po thuaj nuk ndjehej fare. Për Myslim Kokën njerëzit ishin të gjithë njësoj dhe nuk kishte diferencime, zyra e tij ishte e hapur. Edhe në Peshkopi shtëpia e tij u kthye në një strehë e ngrohtë për luznakët. Nuk u kap "mat" as në Luzni Myslim Koka. Në qytetin e Peshkopisë ka qenë edhe kryetar i këshillit të qytetit por dhe këtu punoi me devotshmëri, përkushtim e ndershmëri duke u bërë model në ato vite si një drejtues shembullor dhe i paanshëm.

Vitet e vona punoi në arkivin e komitetit ekzekutiv të rrethit. Myslimi krahas shumë detyrave dhe përgjegjësive që ka marrë ndër vite ishte shumë pasionant për arkeologjinë dhe bënte vetë kërkime sporadike. Studionte dhe kishte shumë njohuri për historinë dhe gjeografinë e Dibrës. Shpeshherë në stinën e verës do ta gjeje në fshatrat e Reçit, Lurës, Selishtës duke gërmuar në popull por dhe duke hulumtuar vetë. Pas punës adresa e tij ishte biblioteka e qytetit por një bibliotekë të pasur kishte dhe në shtëpi të tij.

Gafur Zoto ish drejtor i muzeut Peshkopi do të shprehet: "Myslimi ishte njeri i urtë, fjalë pak e punë shumë. Ai në të gjitha shkollat ku punoi ka dhënë lëndën e historisë. Jo vetëm kaq, por Myslim Koka ka referuar disa herë në sesione shkencore që zhvilloheshin në Peshkopi duke e pasuruar kështu dhe vetë muzeun e Dibrës. Ndërsa Naim Plaku thotë: "Myslimi në radhë të parë ishte njeri, pastaj mësues, drejtues, kuadër me përvojë të gjatë në sektor të ndryshëm të vendit. Ai ishte dhe mbeti njeriu model në mësimdhënie por dhe në drejtim" .

Vitet e fundit e fundit transferohet mësues në Maqellarë, transferim që në fakt nuk i pëlqeu fare Myslimit, ndaj shumë shpejt do ta shikojmë të shkëputet përfundimisht nga puna, duke dalë në fillim në asistencë e më vonë në pension të parakohshëm dhe duke u përqendruar në studimet e tij.

Djali i tij i vogël Shpëtimi thotë: "Në shtëpi kemi një dhomë me libra, kemi shumë dorëshkrime. Ka mjaft shkrime për historinë e Dibrës dhe në veçanti të Reçit të cilat shumë shpejt do të shikojnë dritën e botimit. Sot duke parë gjithë këto materiale të babait them me plot bindje: U linda në Peshkopi, u rrita në emigracion në Greqi dhe kur erdhi koha të njihja babën tim, ishte tepër vonë, ai vdiq.

Në vitin 1995 shpërngulet me banim në Durrës, por dhe këtu Myslim Koka nuk rrinte në lulishte me pleqtë duke lozur domino. Ai do ta kalonte ditën në bibliotekën e qytetit i zhytur i tëri në libra. Lexonte vazhdimisht dhe mbante shënime nga më të ndryshme për historinë e Dibrës, për etnokulturën e saj, për njerëzit që i deshi dhe e deshën.


Myslim Koka pa dyshim është portreti i urtësisë, humanizmit dhe korrektësisë njerëzore. Ai ishte modeli i njeriut që u gjendet pranë, kur ata kanë nevojë, ndërkohë që, pasi i ndihmoi të gjithë ata që trokitën në portën e tij për halle të ndryshme, më së fundi iku nga kjo botë pa kërkuar asgjë për vete. Por populli i Dibrës ia konvertoi sakrificat që bëri për ta, me një ndjenjë të thellë respekti e nderimi. Sepse Myslim Koka me gatishmërinë dhe ndershmërinë e tij e kishte të hapur çdo portë shtëpie, dhe çdo zemër të njerëzve të njohur në të gjitha zonat e Dibrës.

Vdiq në nëntor të vitit 2006 duke lënë dy djem Arianin dhe Shpëtimin si dhe një vajzë Elmira. Në ceremoninë mortore të tij ishin mbi dy mijë veta, rast i veçantë që ndodhte. Kishin ardhur miq e shokë nga Reçi, Lura, Luznia e gjithë Dibra atë ditë nëntori për t'i dhënë lamtumirën e fundit Myslim Kokës. Edhe tani që kanë kaluar plot shtatë vite që ai nuk jeton më, jam i bindur se shokët, kolegët dhe ish nxënësit e tij të cilët janë të shumtë, që do të lexojnë këto rreshta, jo vetëm do të më japin të drejtë, por do të më bëjnë dhe vërejtje, që nuk i kam thënë të gjitha ato që duheshin thënë për të.

I tillë ishte Myslimi, i kujdesshëm, i vëmendshëm me njerëzit. Por vdekja që di të marrë, por që nuk di të zgjedhë, një ditë e mori dhe Myslimin, këtë njeri të thjeshtë, të mirë, me plot virtyte njerëzore që e donte dhe respektonte i madh e i vogël në Peshkopi. Myslim Koka ishte i të gjithëve dhe mbeti për të gjithë.

"Myslimi nuk i nxori atë mëngjes bagëtinë në kullotë. U largua i vetëm nga fshati me dëftesën e notave të shkollës fillore në xhep. Eci ditë e natë, fjeti jashtë në male, në lulishte qytetesh dhe pas disa ditësh e pa veten një mëngjes në qytetin bregdetar të Durrësit. Këmbët e çuan tek e para shkollë 7-vjeçare që hasi rrugës".

Libri i ri



Mevlud Buci
Qëndrestarët e Flamurit

Libër studimor-letrat për epikën e flamurit dhe figurat e ndritura të kombit

Botimet Geer.
ISBN: 978-9928-07-095-1

"Libri "Qëndrestarët e flamurit" është një vlerë në thesarin e botimeve kombëtare, është një libër-muze, një libër i çmuar studimor-letrar, një dhuratë e ndritur në 100-vjetorin e themelimit të shtetit shqiptar. - Faik Xhani


Foto ndërgjegjësimi

Kështu duket sot lumi Radika. Shikojeni dhe mbajeni mend këtë foto, se ndoshta pas disa vitesh do ta humbim këtë pasuri të rrallë...



© Foto: Bardhyl Marku. *26 Maj 2013*





Librin HISTORIA E DIBRËS
të Kristo Frashërit mund ta gjeni në Tiranë pranë
librarisë së Shtëpisë Botuese M&B,
në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva"
pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe
në pikat e shpërndarjes së librit.
Në Peshkopi:
Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Dibër të Madhe: Rexhep Torte.
e-mail <diars@t-home.mk>
Në Durrës: Libraria "Dyrrah".
Tel. 0694053353

Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603 /
068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mbbotime@gmail.com>

Thirrje për sponsorizim

Shtëpia Botuese "M&B" ka në proces botimi disa libra me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithe Shqipërinë.

Individë ose biznesmenë që dëshirojnë të bëhen bashkëkontribues në këto projekte, mund të shprehin interesin e tyre në emaili: mbbotime@gmail.com ose në tel: 069 20 68 603.

Faleminderit!

cyan magenta yellow black